



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

**RAPORT I GRUPIT PUNUES  
PËR SHQYRTIMIN E PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE  
TË ZBATUARA PËR HIDROCENTRALE DHE NDIKIMIN  
E TYRE NË UJËRA DHE MJEDIS**

30 qershor 2021

## Përmbajtja

SHKURTESAT .....	5
I.     HYRJE .....	6
II.    KONTEKSTI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL .....	9
2.1 Legjislacioni për Ujëra: Rregullimi i të drejtës për shfrytëzim të ujërave .....	10
2.1.1 E DREJTA PËR SHFRYTËZIMIN E UJËRAVE .....	10
2.2 Ligji për Rregullatorin e Energjisë: Autorizimi për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja Gjeneruese .....	14
2.3 Ligji për Partneritet Publiko Privat.....	15
2.4 Ligji për Planifikim Hapësinor .....	16
2.5 Ligji për Ndërtim .....	16
2.6 Ligji për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës Komunale .....	17
2.7 Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis .....	18
2.8 Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit.....	18
2.9 Ligji për Mbrojtjen e Natyrës .....	18
2.10 Ligji për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” dhe për Parkun Kombëtar “Sharri” .....	18
2.11 Ligji për Miniera dhe Minerale.....	19
III.   METODOLOGJIA E PUNËS .....	20
IV.    GJETJET .....	21
4.1 Hidrocentralet e kaskadës së Deçanit – “Deçani”, “Belaja” dhe “Lumbardhi 2” ..21	
4.1.1    HYRJE .....	21
4.1.2    SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE ADMINISTRATIVE .....	21
4.1.3 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË RESURSET UJORE, MJEDIS DHE BILANCET EKONOMIKE .....	26
4.1.4 KONKLuzionet dhe Rekomandimet për HC-et e Deçanit .....	27
4.1.4.1 Konkluzionet .....	27
4.1.4.2 Rekomandimet .....	28
4.2 Hidrocentralet e kaskadës së Lepencit – “Sharri”, “Shtërpca”, “Brezovica” dhe “Viça” .....	30
4.2.1 HYRJE .....	30
4.2.2 SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE ADMINISTRATIVE .....	30
4.2.3 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË RESURSET UJORE, MJEDIS DHE BILANCET EKONOMIKE .....	38
4.2.4 KONKLuzionet dhe Rekomandimet për HC-ET E KASKADËS SË LEPENCIT .....	39
4.2.4.1 Konkluzionet .....	39

4.2.4.2 Rekomandimet .....	39
<b>4.3 Hidrocentralet e Brodit dhe Restelicës – “Restelica 1&amp;2”, “Restelica 3”, “Brodi 1”, “Brodi 2”, dhe “Brodi 3” .....</b>	<b>41</b>
4.3.1 SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE ADMINISTRATIVE .....	41
4.3.2 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË RESURSET UJORE, MJEDIS DHE BILANCET EKONOMIKE .....	47
4.3.3 KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR HC-et E EUROKOS JH.....	48
4.3.3.1 Konkluzionet .....	48
4.3.3.2 Rekomandimet .....	49
<b>4.4 Hidrocentralet e Lumit Plavë dhe Lumit Radeshë – “Orçusha” dhe “Dragash” ....</b>	<b>50</b>
4.4.1 SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE ADMINISTRATIVE .....	50
4.4.2 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË RESURSET UJORE, MJEDIS DHE BILANCET EKONOMIKE .....	52
4.4.3 KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR HC-ET E KASKADËS SË LEPENCIT .....	52
4.4.3.1 Konkluzionet .....	52
4.4.3.2 Rekomandimet .....	53
<b>4.5 Hidrocentralet në Lumin Bistricë – “Albanik 2”, “Albanik 3”, dhe “Albanik 4” .....</b>	<b>54</b>
4.5.1 SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE ADMINISTRATIVE .....	54
4.5.2 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË RESURSET UJORE, MJEDIS DHE BILANCET EKONOMIKE .....	56
4.5.3 KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR HC-ET E KASKADËS SË LEPENCIT .....	57
4.5.3.1 Konkluzionet .....	57
4.5.3.2 Rekomandimet .....	57
<b>4.6 Hidrocentrali “Lepenci 3” në komunën e Kaçanikut .....</b>	<b>59</b>
4.6.1 SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE ADMINISTRATIVE .....	59
4.6.2 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË RESURSET UJORE, MJEDIS DHE BILANCET EKONOMIKE .....	61
4.6.3 KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR HC-ET E KASKADËS SË LEPENCIT .....	62
4.6.3.1 Konkluzionet .....	62
4.6.3.2 Rekomandimet .....	62
<b>4.7 Hidrocentrali “Bresanë” në komunën e Dragashit .....</b>	<b>64</b>
4.7.1 SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE ADMINISTRATIVE .....	64
4.7.2 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË RESURSET UJORE, MJEDIS DHE BILANCET EKONOMIKE .....	65

4.7.3 KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR HC-in e BRESANËS.....	65
4.7.3.1 Konkluzionet .....	65
4.7.3.2 Rekomandimet .....	65
<b>4.8 Hidrocentrali “Binça” në komunën e Vitisë .....</b>	<b>67</b>
4.8.1 SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE ADMINISTRATIVE .....	67
4.8.2 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË RESURSET UJORE, MJEDIS DHE BILANCET EKONOMIKE .....	68
4.8.3 KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR HC-in e BINÇËS .....	68
4.8.3.1 Konkluzionet .....	68
4.8.3.2 Rekomandimet .....	68
<b>V. KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET .....</b>	<b>70</b>
<b>5.1 Konkluzionet .....</b>	<b>70</b>
5.1.1 Aktet administrative.....	70
5.1.2 Aktet ujore .....	70
5.1.3 Aktet mjedisore .....	71
5.1.4 Aktet e ndërtimit.....	72
5.1.5 Pronat ujore.....	72
5.1.6 Mbikëqyrja inspektuese.....	73
5.1.7 Çështjet tjera .....	73
<b>5.2 Rekomandimet .....</b>	<b>74</b>
<b>SHTOJCAT .....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>Shtojca 1: Vendimi i Ministrit.....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>Shtojca 2: Lista e HC-ve që janë në operim dhe atyre në ndërtim ....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>Shtojca 3: Listat kontrolluese për shqyrtimin e lejeve të lëshuara ...</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Shtojca 3.1 Lista kontrolluese për akte ndërtimore.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Shtojca 3.2 Lista kontrolluese për akte ujore.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Shtojca 3.3 Lista kontrolluese për akte mjedisore .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>Shtojca 4: Shënimet dhe konkluzionet e takimeve të GP ....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>Shtojca 5: Raportet e inspektimit të Ekipit të Terrenit të GP</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>Shtojca 6: Vlerësimi i përputhshmërisë së studimit të PPE për HC-et e kaskadës së Deçanit me Rregulloren 02/2016 për Përcaktimin e PPE .....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

## SHKURTESAT

EC	Komisioni Evropian ('European Commission')
GP	Grup punues
HC	Hidrocentral
GWh	Gigavatorë
KNMU	Këshilli Ndërmintor për Ujëra
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MEA	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
MW	Megavat
UA	Udhëzim Administrativ
PPE	Prurja e Pranueshme Ekologjike
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

## I. HYRJJE

Në Kosovë, si edhe në vendet tjera të Ballkanit, në dekadën e fundit ka marrë hov<sup>1</sup> ndërtimi i hidrocentraleve (HC-eve) të vogla (deri në 10 MW). Ky trend është në masë të madhe rezultat i zotimit të Qeverisë për arritjen e caqeve të vendosura për rritjen e energjisë nga burimet e ripërtëritshme, në pajtim me direktivat përkatëse të BE-së (Direktiva 2001/77/EC dhe Direktiva 2009/28/EC). Kështu, me *Planin Veprues Kombëtar për Energji të Ripërtëritshme 2011-2020* është paraparë që 25% e energjisë që do të konsumohet në Kosovë deri në vitin 2020 të jetë nga burimet e ripërtëritshme (uji, era, energjia diellore, biomasa, energjia gjeotermale). Për arritjen e këtij synimi, janë ndërmarrë edhe veprime përkatëse ligjore me të cilat stimulohen investimet në teknologjitë e prodhimit të energjisë së ripërtëritshme, si tarifatat stimuluuese ('feed-in') për energjinë e ripërtëritshme etj. Interesimi më i madh i investitorëve privat vlerësohet të jetë në HC-et e vogla për shkak që, krahasuar me sistemet tjera që shfrytëzojnë burimet e ripërtëritshme të energjisë, këto sisteme kanë kosto më të ulët të prodhimit dhe kanë normë më të lartë të kthimit të energjisë. Në mënyrë tipike, këto HC-e të vogla kryesisht po ndërtohen në zona malore, madje në zona të mbrojtura të natyrës.

Në Kosovë, deri tash, ndërtimi i HC-eve të vogla është shoqëruar me probleme të shumta dhe konsiderohet se ky proces nuk është menaxhuar në mënyrë të duhur dhe me transparencën e kërkuar. Ankesat e shumta të publikut (qytetarëve, shoqatave të ndryshme dhe mediave) po edhe raportet e institucioneve përgjegjëse flasin për një shfrytëzim të pakontrolluar të ujit nga HC-et që për pasojë ka shterjen e kohëpaskohshme të disa prej lumenjve, ujin e të cilëve e shfrytëzojnë këto HC-e. Çka është edhe më keq, vlerësohet se ky proces është zhvilluar edhe me shkelje të ligjeve dhe të dokumenteve planifikuese.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë si dhe aspekteve procedurale dhe administrative të lejimit të këtyre HC-eve, Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) ka krijuar një grup punues<sup>2</sup> (shih **Shtojcën 1** të këtij Raporti) i cili grup në konsultim edhe me këshilltarët e Këshillit Ndërmintor për Ujëra (KNMU), Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), ministritë tjera, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe ekspertë të jashtëm, është ngarkuar që deri në fund të qershorit 2021 të trajtojë të gjitha çështjet që ndërlidhen me procesin e lejimit të HC-ve dhe ndikimet e tyre në mjedis, si dhe të hartojë një raport me analiza dhe rekomandime për Ministrin dhe Qeverinë.

Detyrat specifike të GP për HC janë përcaktuar si vijon:

- Identifikimi i të gjitha hidrocentraleve operacional ose në ndërtim;
- Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve administrative të lëshuara për hidrocentrale;
- Identifikimi i ndikimeve në resurse ujore, mjedis dhe në bilancet ekonomike të komunitetit;
- Identifikimi i kostove të secilit hidrocentral;
- Verifikimi i përputhjeve në mes të akteve administrative dhe punimeve dhe zbatimit të projekteve, në rastet kur ato tashmë janë ndërtuar ose janë në ndërtim e sipër;
- Paraqitja e analizave dhe rekomandimeve për Ministrin e MMPHI dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës.

<sup>1</sup> Sipas një raporti të hartuar në vitin 2019, <https://balkanrivers.net/sites/default/files/who-pays-who-profits.pdf>, prej vitit 2009 deri në vitin 2018 janë ndërtuar së paku 380 hidrocentrale të vogla në vendet e Ballkanit (Shqipëri, Maqedoni, Mal i Zi, Bosnje, Kosovë, Serbi).

<sup>2</sup> Vendimi i Ministrit Nr. 1818/21 i datës 14 maj 2021.

Përbërja e grupit punues ishte përcaktuar me vendim të Ministrit si vijon:

1. Shiqeri Dërmaku, DMMU, kryesues
2. Manduha Gojani, ARPL anëtare
3. Naser Afizi, ARPL, anëtar
4. Ismail Hetemaj, DMMU, anëtar
5. Xhemajl Metolli, DPHNB, anëtar
6. Ali Sefaj, AMMK, anëtar
7. Tringa Gjokolli, Inspektorati i MUNPHN, anëtare
8. Demir Hyseni, AKK, anëtar
9. Fisnike Kelmendi, Departamenti Ligjor, anëtare

Në punën e GP kanë marrë pjesë dhe kanë kontribuar edhe dy këshilltarët e KNMU, Afrim Lajçi dhe Baton Begolli.

GP ka zhvilluar punën e vet në formë të takimeve të mbajtura në hapësirat e MMPHI me ç`rast janë shqyrtuar dokumentacioni projektues, ligjet dhe aktvendimet (aktet ujore, aktet mjedisore dhe aktet ndërtimore) të lëshuara nga Ministria për secilin prej HC-eve. Në total GP i ka mbajtur 23 takime, dhe për secilin prej takimeve janë mbajtur shënime për çështjet e trajtuara dhe konkluzionet e dakorduara (shih shënime të takimeve në **Shtojcën 4** të raportit).

Përpos kësaj, një ekip i përzgjedhur i GP ka kryer vizita dhe inspektime për secilin prej HC-eve që janë në operim me qëllim të shqyrtimit të gjendjes faktike në terren. Për punën e vet, ekipi i terrenit ka mbajtur shënime dhe ka nxjerrë konkluzionet me gjetjet e inspektimeve të kryera (shih **Shtojcën 5** të raportit). Ekipi i terrenit ka qenë në përbërje:

- Tringa Gjokolli, udhëheqëse e ekipit
- Ali Sefaj, dhe
- Demir Hyseni.

Gjetjet e GP janë dhënë në kapitullin e 4-të të këtij raporti. Këto gjetje mund të përmbliidhen shkurt në sa vijon:

- a) Përkundër faktit që me ligj është rregulluar që për shfrytëzimin e ujit për qëllime afariste duhet të sigurohet koncesioni, Ministria (MMPH) si autoritet përgjegjës për dhënien e të drejtës ujore nuk e ka zbatuar dhënien e koncesionit por, dhënien e të drejtës ujore e ka bërë me leje ujore, që paraqet shkelje të Ligjit për Ujërat e Kosovës. Dallimi bazë ndërmjet lejes ujore dhe koncesionit qëndron në faktin se koncesioni jepet përmes një procesi konkurrues ndërkaq leja ujore jo.
- b) Jo vetëm që nuk është zbatuar procedura e koncesionit e përcaktuar me ligj, por lëshimi i lejeve ujore për shfrytëzim të ujit për HC-e është bërë në kundërshtim me aktin nënligjor për leje ujore sa i përket dokumentacionit që duhet t'i bashkëngjitet aplikacionit si dhe përmbajtjes së lejes ujore.
- c) Lëshimi i lejeve ujore për HC-e është bërë pa u mbështetur në një shqyrtim të detajuar dhe profesional dhe nuk është bazuar në dokumente planifikuese. Për pasojë, janë dhënë leje ujore dhe janë ndërtuar hidrocentrale edhe në zonat ku kanë qenë të planifikuara projekte kapitale hidroteknike duke rrezikuar kështu realizimin e këtyre objekteve me rëndësi strategjike për Kosovën (si në rastin e hidrosistemit Lepenci).

- d) Në mungesë të një udhëzuesi për mënyrën e hartimit dhe shqyrtimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM), që në bazë të ligjit do të duhej ta nxirrte Ministria, procesi i shqyrtimit të raportit të VNM-së dhe lëshimit të pëlqimit mjedisor nuk ka pasur një ecuri të përcaktuar saktë dhe një standard të duhur. Raportet e VNM-së janë përgjithësisht të nivelit të dobët. Aspektet më të rëndësishme për florën dhe faunën akuatike siç janë prurja e pranueshme ekologjike, regjimi i aluvioneve dhe shtigjet e peshqve, trajtohen vetëm sipërfaqësisht.
- e) Për të tria HC-et e kaskadës së Deçanit, lejet ndërtimore dhe certifikatat e përdorimit janë lëshuar nga Ministria, edhe pse të gjitha këto HC-e janë të kapacitetit nën 10 MW, dhe rrjedhimisht lëshimi i lejes ndërtimore me ligj është kompetencë e komunës. Kjo është realizuar duke i bashkuar dy HC-et (“Deçani” dhe “Belaja”) me një leje ndërtimore meqenëse kështu të bashkuara i kanë mbi 10 MW, dhe HC “Lumbardhi” me digën e cila nuk është ndërtuar fare.
- f) Praktikisht të gjitha HC-et janë ndërtuar në afërsi të drejtpërdrejt të lumenjve (ujërrjedhave) nga të cilat gjenerojnë energjinë, duke qenë kjo në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Ujërat e Kosovës me të cilin ndalohet ndërtimi në distancë më të vogël se 30 metra prej vijave të plotave (vija e ujërave maksimale 100 vjeçare).



## II. KONTEKSTI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Kuadri ligjor me të cilin trajtohet dhe rregullohet lejimi i HC-eve përfshin:

- 1) Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës (prill 2013);
- 2) Ligji Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike (korrik, 2016);
- 3) Ligji Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë (korrik, 2016);
- 4) Ligji Nr. 05/L-081 për Energjinë (korrik, 2016);
- 5) Ligji Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim Pronës së Paluajtshme të Komunës (dhjetor 2012);
- 6) Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim (korrik 2013);
- 7) Ligji Nr.03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (tetor 2010);
- 8) Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (prill 2009);
- 9) Ligji Nr. 2004/29 për Pyjet e Kosovës (gusht 2008);
- 10) Ligji Nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes (maj 2009).

Kuadri institucional përfshin institucionet vijuese me përgjegjësitë e tyre respektive si vijon:

- (i) Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
  - Lëshon lejen ujore, e drejta për shfrytëzim të ujit, është bartëse e procedurës së dhënies me koncesion për shfrytëzimin e ujit;
  - Lëshon leje mjedisore;
  - Është përgjegjëse për lëshimin e lejeve për ndërtim të hidrocentraleve me fuqi 10 e më shumë MW.
- (ii) Zyra e Rregullatorit të Energjisë:
  - Lëshon autorizimin për ndërtimin e kapaciteteve të reja të prodhimit të energjisë (autorizime preliminare, autorizime finale);
  - Përcakton sistemin tarifor për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE;
  - Është përgjegjëse për sistemin e certifikatave të origjinës.
- (iii) Komunitat
  - Përgjegjëse për dhënien e tokës për projekte të burimeve të ripërtëritshme të energjisë;
  - Lëshimi i lejeve të ndërtimit për HC-eve nën 10 MW të kapacitetit të instaluar.
- (iv) Agjencia e Pyjeve të Kosovës
  - Lëshon leje për shfrytëzimin e pyjeve.
- (v) Ministria e Financave/Departamenti për Partneritet Publiko Privat
  - Ofron ndihmë, këshilla dhe mbështetje teknike për Autoritetet Publike dhe për të gjitha çështjet që janë të lidhura me koncesionet.
- (vi) Ministria e Zhvillimit Ekonomik
  - Harton politikat e sektorit të energjisë dhe përcakton caqet e energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme, duke përfshirë edhe ujin.

## 2.1 Legjislacioni për Ujëra: Rregullimi i të drejtës për shfrytëzim të ujërave

Lëshimi i akteve ujore për shfrytëzim të ujit për HC-e është zhvilluar prej vitit 2007 deri në vitin 2021. Gjatë kësaj kohe kanë qenë në fuqi dy ligje për ujëra:

- (i) *Ligji për Ujërat e Kosovës nr. 2004/24* (nga tetori i vitit 2004 deri në prill 2013), dhe
- (ii) *Ligji për Ujërat e Kosovës nr. 04/L-147* (prej prill 2013 e tutje),

si dhe dy akte nënligjore:

- (i) *Udhëzimi Administrativ nr. 63-24/05 Mbi Përmbajtjen, Formën, Kushtet dhe Mënyrat e Lëshuarjes dhe Ruajtjes së Lejes Ujore* (në fuqi prej tetorit të vitit 2005 deri në gusht 2018), dhe
- (ii) *Udhëzimi Administrativ nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore* (në fuqi prej gusht 2018 e tutje).

### 2.1.1 E DREJTA PËR SHFRYTËZIMIN E UJËRAVE

Sa i përket dhënies së të drejtës për shfrytëzim të ujit, të dyja ligjet për ujëra – ai i vitit 2004 dhe ai i vitit 2013 – e kanë përcaktuar qartë dhe njësoj<sup>3</sup> që: e drejta për shfrytëzim të ujit fitohet me:

- (iii) leje ujore, ose
- (iv) me koncesion.

Kjo nënkupton që aktet e të drejtës ujore në bazë të cilave fitohet e drejta për shfrytëzim të ujit janë dy: **(i) leja ujore** dhe **(ii) koncesioni**.

#### a) Leja Ujore

Me të dyja ligjet, të vitit 2004 dhe atë të vitit 2013, përcaktohet që “me Lejen Ujore përcaktohet destinimi, mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të ujit, shkarkimi i ujërave të ndotura, regjimi i punës së objekteve dhe impianteve, deponimi i mbeturinave të ngurta dhe të lëngëta si dhe kushtet tjera.” Pra përpos që është akt me të cilin jepet e drejta për shfrytëzim të ujit, me leje ujore gjithashtu lejohet shkarkimi i ujërave të ndotura të kanalizimit si dhe regjimi i punës së objekteve dhe impianteve. Edhe dispozitat tjera që kanë të bëjnë me lejen ujore janë praktikisht të njëjta në këto dy ligje (rishikimi çdo 5 vjet, leja ujore për shfrytëzimin e ujërave ndërkufitare, bartja e të drejtës ujore tek personat e tretë, autoriteti për lëshimin e lejeve ujore etj.).

Me ligjin e vitit 2013, procedura për fitimin e lejes ujore është përshkruar me nenin 71, dhe ajo përfshin 3 hapa:

- (i) kushtet ujore,
- (ii) pëlqimin ujqor,
- (iii) lejen ujore.

Ndërkaq hapi i 4-të - urdhëresa ujore - edhe pse nuk është sqaruar në mënyrë eksplicite në ligj, është mekanizëm ligjor për zbatimin e kushteve dhe kërkesave të përcaktuara me leje ujore.

<sup>3</sup> Në ligjin nr. 2004/24 kjo është përcaktuar me nenin 55 ndërkaq me Ligjin nr. 04/L-147 me nenin 70.

Bazuar në dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2018 (por edhe në praktikat e vendeve tjera) funksioni i këtyre fazave të lejes ujore është si vijon:

1) **Kushtet ujore** janë akt ujqor me të cilin:

- a) vendoset se a ekzistojnë kushtet për realizimin e së drejtës ujore sipas kërkesës së paraqitur në lokacionin konkret dhe për destinimin konkret, si dhe
- b) përcaktohen kushtet të cilat duhet t'i plotësojë dokumentacioni për ndërtimin e objekteve dhe realizimin e aktiviteteve. Kështu, kushtet ujore janë hapi i parë i cili përcakton a ka kushte për shfrytëzimin e ujit për prodhimin e energjisë.

2) **Pëlqimi ujqor** është akt ujqor me të cilin verifikohet se dokumentacioni i bashkëngjitur aplikacionit për pëlqim ujqor është hartuar në përputhje me kushtet ujore, legjislacionin e ujërave dhe dokumentet planifikuese për rajonin përkatës.

3) **Leja ujore** është akt ujqor me të cilin lejohet shfrytëzimi i ujit për objektin/veprimtarinë e caktuar që është ndërtuar në pajtim me pëlqimin ujqor dhe lejen ndërtimore.

Me ligjin e vitit 2004, procesi i lëshimit të lejeve ujore nuk ka qenë i ndarë në faza. Sipas këtij ligji dhe *Udhëzimit Administrativ nr. 63-24/05 Mbi Përmbajtjen, Formën, Kushtet dhe Mënyrat e Lëshuarjes dhe Ruajtjes së Lejes Ujore* (i miratuar në tetor të vitit 2005), përcaktohet përmbajtja e aplikacionit për leje ujore si dhe përmbajtja e lejes ujore - me nenin 25 të UA - si vijon:

- Regjimi i punës i objektit ose impiantit;
- Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të ujërave dhe pasojat për ndryshimin e regjimit ujqor;
- Mënyra dhe kushtet e matjes së sasisë dhe cilësisë së ujërave të shfrytëzuar dhe mënyra e dërgimit të të dhënave të matura;
- Mënyra, procedura dhe kushtet e pagesë së kompensimit për ujin e shfrytëzuar;
- Afatet kur duhet të fillojë puna për ndërtim, mirëmbajtje, shfrytëzim dhe mbyllje të objektit.
- Autorizimet e Ministrisë për caktimin e masave plotësuese për vendosjen e ekuilibrit ekologjik të përkeqësuar të ujërave sipërfaqësor i shkaktuar nga shfrytëzuesi i ujërave në barrë të bartësit të të lejes ujore.

Sa i përket aktiviteteve për të cilat lëshohet leja ujore, në të dy ligjet janë praktikisht veprimtaritë e njëjta. Kështu, me nenin 56 të ligjit të vitit 2004 është përcaktuar që leja ujore ndahet për:

- a. nxjerrje të ujit,
- b. shkarkim të ujërave të ndotura,
- c. ndërtimin, rindërtimin ose demelimin e objekteve që ndikojnë në regjimin ujqor;
- d. aktivitetet e minierave dhe punimet gjeologjike, të cilat ndikojnë në regjimin e ujërave.
- e. shfrytëzimin e rërës, zhavorrit, gurit dhe argjilës, dhe
- f. aktivitetet e tjera që mund të ndikojnë në regjimin ujqor.

Ndërsa me ligjin e vitit 2013 (neni 72) është përcaktuar që llojet e shfrytëzimit të ujërave për të cilat lëshohet leja ujore, përfshijnë si vijon:

- nxjerrjen e ujit për konsum të përgjithshëm;
- shkarkimin e ujërave të ndotura;
- ndërtimin, rindërtimin ose demolimin e objekteve dhe pajisjeve që ndikojnë në regjimin ujqor;
- aktivitetet e minierave dhe punimet gjeologjike të cilat ndikojnë në regjimin e ujërave;
- për hulumtime hidrogjeologjike dhe grumbullimin e të dhënave;
- eksploatimin e rërës, zhavorrit, gurit dhe argjilës;
- përdorimin e ujërave me qëllim të shfrytëzimit të energjisë elektrike dhe gjeotermale;
- aktivitetet tjera që mund të ndikojnë në regjimin ujqor.

Në tabelë e mëposhtme janë paraqitur veprimtaritë për të cilat ndahet leja ujore sipas Ligjit për Ujëra të vitit 2004 dhe sipas Ligjit për Ujëra të vitit 2013.

**Tabela 1: Veprimtaritë për të cilat ndahet leja ujore me Ligjin e vitit 2004 dhe Ligjin e vitit 2013**

Ligji i vitit 2004	Ligji i vitit 2013
nxjerrje të ujit.	nxjerrjen e ujit për konsum të përgjithshëm.
shkarkim të ujërave të ndotura.	shkarkimin e ujërave të ndotura.
ndërtimin, rindërtimin ose demolimin e objekteve që ndikojnë në regjimin ujqor.	ndërtimin, rindërtimin ose demolimin e objekteve dhe pajisjeve që ndikojnë në regjimin ujqor.
aktivitetet e minierave dhe punimet gjeologjike, të cilat ndikojnë në regjimin e ujërave.	aktivitetet e minierave dhe punimet gjeologjike, të cilat ndikojnë në regjimin e ujërave.
shfrytëzimin e rërës, zhavorrit, gurit dhe argjilës.	për hulumtime hidrogjeologjike dhe grumbullimin e të dhënave. eksploatimin e rërës, zhavorrit, gurit dhe argjilës.
aktivitetet e tjera që mund të ndikojnë në regjimin ujqor.	përdorimin e ujërave me qëllim të shfrytëzimit të energjisë elektrike dhe gjeotermale. aktivitetet e tjera që mund të ndikojnë në regjimin ujqor.

Siç mund të shihet nga krahasimi i bërë në tabelën 1 më sipër, me Ligjin e vitit 2013 janë shtuar dy veprimtari për të cilat duhet të lëshohet leja ujore: (i) hulumtime hidrogjeologjike dhe grumbullimi i të dhënave, dhe (ii) përdorimi i ujërave me qëllim të shfrytëzimit të energjisë elektrike dhe gjeotermale.

Duhet të theksohet që, me të dyja ligjet, përpos si instrument<sup>4</sup> për dhënien e të drejtës për shfrytëzim të ujit, leja ujore është përcaktuar edhe si akt për lejimin e: ‘ndërtimit, rindërtimit, demolimit të objekteve që ndikojnë në regjimin uhor’; ‘aktiviteteve të minierave dhe punimet gjeologjike, të cilat ndikojnë në regjimin e ujërave; ‘shkarkimin e ujërave të ndotura’; etj.

## b) Koncesioni

Me nenin 60 (parag. 2.a) të Ligjit për Ujëra të vitit 2004 dhe me nenin 78 (parag. 3) i Ligjit për Ujëra të vitit 2013 është përcaktuar se “për shfrytëzimin e fuqisë së ujit për prodhimin e energjisë elektrike” duhet të sigurohet koncesioni.

Përpos për shfrytëzimin e ujërave për prodhimin e energjisë elektrike, sipas dispozitave të ligjit për ujëra të vitit 2004 dhe të vitit 2013, koncesioni duhet të sigurohet edhe për shfrytëzimin e ujërave për veprimtari tjera afariste si: ambalazhimi i ujit, hudhrat e peshqve, nevojat teknologjike etj.

**Tabela 2: Veprimtaritë për të cilat lëshohet koncesioni me Ligjin e vitit 2004 dhe Ligjin e vitit 2013**

Ligji i vitit 2004	Ligji i vitit 2013
shfrytëzimin e fuqisë së ujit për prodhimin e energjisë elektrike;	shfrytëzimin e ujit për sistemet e ujitjes;
shfrytëzimin e fuqisë së ujit për vënien në veprim të pajisjeve me përjashtim të prodhimit të energjisë elektrike	shfrytëzimin e fuqisë së ujit për prodhimin e energjisë elektrike;
shfrytëzimin e ujërave për nevojat teknologjike; nxjerrjen e ujërave minerale dhe termale;	shfrytëzimin e ujit për nevoja teknologjike; shfrytëzimin e ujërave minerale dhe termale;
shfrytëzimin e ujërave për sistemet e ujitjes;	mbushjen e ujit në shishe për nevoja komerciale;
rritjen e peshkut për qëllime ekonomike dhe destinime të tjera;	kultivimin e peshqve dhe shpezëve uhorë;
shfrytëzimin e pasurive ujore për ndërtimin e objekteve të përhershme përkatësisht ndërtimin e pajisjeve;	ofrimin e shërbimeve turistike, sportive dhe shërbimeve tjera rekreative me ndërtimin e objekteve dhe pajisjeve të përhershme.
shfrytëzimin e pasurive ujore për rekreacion me ndërtimin e objekteve të përhershme ndërtimin e pajisjeve;	
shfrytëzimin e materialeve inerte nga ujërrjedhat në kohëzgjatje më shumë se dy (2) vjet.	

<sup>4</sup> Me legjislacionin e vendeve të rajonit (nga i cili legjislacion është marrë modeli për Ligjin e Ujërave të vitit 2004 dhe 2013) janë dy praktika: (i) modeli i Kroacisë dhe i Sllovenisë sipas të cilit leja ujore lëshohet vetëm për shfrytëzim të ujit dhe shkarkim të ujërave të ndotura, ndërsa për ndërtime dhe veprime tjera që mund të kenë ndikim në regjimin uhor lëshohen *kushte ujore* apo *pëlqim uhor*; dhe (ii) modeli i vendeve tjera (Bosnja, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia) sipas të cilit model *leja ujore* lëshohet edhe për ndërtime dhe aktivitete tjera në regjimin uhor. Është me rëndësi të theksohet se Ligji për Ujërat e Kosovës e ka adoptuar modelin e Kroacisë dhe Sllovenisë sa i përket të drejtës ujore sipas të cilit e drejta për shfrytëzim të ujit jepet me leje ujore OSE me koncesion, përderisa legjislacioni i vendeve tjera të rajonit, për shfrytëzimin komercial të ujërave përcakton koncesionin por edhe lejen ujore – pra të dyja aktet.

Siç mund të shihet nga tabela e mësipërme, të gjitha veprimtaritë për të cilat kërkohet koncesioni me ligjin e vitit 2013 kanë qenë të përcaktuara edhe me ligj të vitit 2004. Për më tepër, me Ligjin për Ujëra të vitit 2004, koncesioni është kërkuar edhe për shfrytëzimin e inerteve nga shtretërit e lumenjve për kohëzgjatje më shumë se 2 vite.

Nga analizimi i dispozitave ligjore të Ligjit për Ujëra të vitit 2004 dhe atij të vitit 2013, mund të konkludohet se dy mjetet ligjore të së drejtës ujore, *koncesioni* dhe *leja ujore*, lëshohen për veprimtari të ndryshme: koncesioni për shfrytëzim afarist të ujërave ndërkaq leja ujore për shfrytëzim të ujit për konsum të përgjithshëm si dhe për shkarkim të ujërave të ndotura dhe për aktivitete tjera që mund të ndikojnë në regjimin ujor. Pra, veprimtaritë për të cilat lëshohet leja ujore janë të ndryshme prej atyre për të cilat lëshohet koncesioni.

Me Ligjin për Ujëra të Kosovës (të vitit 2004 dhe atë të vitit 2013) është përcaktuar se e drejta për shfrytëzim të ujërave mund të sigurohet me dy instrumente ligjore:

(i) leje ujore OSE (ii) koncesion.

Meqenëse veprimtaritë për të cilat jepet leja ujore janë të ndryshme prej atyre për të cilat jepet koncesioni, mund të konkludohet se **këto dy instrumente të së drejtës ujore janë përjashtuese** – pra ose jepet leja ujore ose koncesioni.

**Leja ujore jepet për shfrytëzim të ujërave për konsum të përgjithshëm** dhe për veprimtari që kanë ndikim në cilësinë e ujërave dhe regjimin ujor si: shkarkimi i ujërave të ndotura, eksploatimi i rërës dhe zhavorrit, hulumtimet hidrogeologjike, aktivitete minerare apo gjeologjike, ndërtimi apo demolimi i objekteve që ka ndikim në ujëra.

Në anën tjetër, **koncesioni jepet për shfrytëzimin e ujërave për veprimtari afariste**, si, bujqësi, gjenerimi i energjisë elektrike, uji i ambalazhuar, hudhurat e peshqve etj.

Ligji për Ujëra përcakton që **koncesioni ndahet përmes konkursit publik** të organizuar dhe realizuar në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, ndërsa kompensimi dhe ndërprerja e koncesionit rregullohet me Ligjin për Partneritet Publiko Privat.

## 2.2 Ligji për Rregullatorin e Energjisë: Autorizimi për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja Gjeneruese

Ligji për Rregullatorin e Energjisë (Ligji nr. 05/L-084) me nenin 43 ka paraparë që **ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë duhet të bëhet në pajtim me procedurat e autorizimit të përcaktuara me këtë Ligj**.

Neni 44 i këtij Ligji parasheh edhe mundësinë e zbatimit të procedurës së tenderit<sup>5</sup> për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese në rastet kur Rregullatori i Energjisë me vendim konstaton se procedura e autorizimit ka rezultuar si e pasuksesshme. Procedura e tenderimit e autorizuar nga Qeveria në këto raste ushtrohet nga Komisioni Drejtues Ndërmintor i Partneritetit Publiko Privat.

Me akte nënligjore të miratuara nga Rregullatori i Energjisë janë përcaktuar më hollësisht procedurat e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese. Kështu me

<sup>5</sup> Procedura e tenderimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për energji elektrike nuk duhet të ngatërrohet me procedurën e tenderimit për dhënie të koncesionit për shfrytëzimin e ujit si mjet i të drejtës ujore.

Rregullën për Procedurën e Autorizimit të Ndërtimit të Kapaciteteve të Reja nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (neni 2 paragrafi 1) përcaktohen kriteret dhe procedurat për dhënin e autorizimit për ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese.

Me këtë Rregull përcaktohet se kapacitete të vogla gjeneruese për të cilat zbatohen procedura të thjeshtuara janë ato  $\leq 100\text{kW}$ .

Sipas kësaj Rregulle, asnjë person nuk mund të ndërtojë kapacitete të reja gjeneruese në Kosovë pa pasur autorizim nga Rregullatori. Për marrjen e autorizimit duhet të plotësohet aplikacioni sipas formatit dhe udhëzimeve të dhëna në Rregull. Sipas paragrafit 4 të nenit 5 të kësaj Rregulle, kur aplikojnë më shumë se një aplikues për të njëjtin vend ku do të ndërtohet stabilimenti gjenerues, në rastin e hidrocentraleve do të këtë **përparësi aplikuesi i cili ka siguruar pëlqimin ujq** nga organi kompetent. Kjo imponon pyetjen se me çfarë kriteri do të vendoste MMPH për dhënen e pëlqimit ujq nëse i paraqiten më shumë se një aplikues. A do t'ia ndante pëlqimin vetëm njërit (nëse po, cilit, me çfarë kriteri?), apo më shumë aplikuesve?

Ndërsa me nenin 7 (paragrafi 3.9) të Rregullës përcaktohet që aplikuesi, ndër tjera, duhet të sigurojë dëshmi që konfirmojnë se ai ka plotësuar të gjitha kërkesat e aplikueshme me legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë, **përfshirë edhe të drejtën për shfrytëzim të ujit**, aty ku kërkohet.

Në shtojcën e kësaj Rregulle ku sqarohet përmbajtja e aplikacionit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese është precizuar që **“pëlqimi ujq ose leja ujqore duhet të sigurohet në kuadër të dokumentacionit që i bashkëngjitet aplikacionit për autorizim final”**.

Përcaktimi me Rregullën e ZRRE i pëlqimit ujq ose lejes ujqore si kushte për fitimin e autorizimit final, është në **kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Ujërat e Kosovës** që ka përcaktuar koncesionin si mjet për fitimin e të drejtës ujqore për shfrytëzimin e ujit për prodhimin e energjisë elektrike.

## 2.3 Ligji për Partneritet Publiko Privat

Ligji për Partneritet Publiko Privat (Ligji nr. 04/L-45) ka krijuar kornizën ligjore për partneritet publiko privat duke përfshirë procedurat për hyrje në një partneritet publiko privat, përmbajtjen dhe strukturën e marrëveshjeve për partneritet publiko privat si dhe strukturën institucionale përgjegjëse. Me këtë ligj është shfuqizuar Ligji Nr. 03/L-090 Mbi Partneritetet Publiko Private dhe Koncesionet në Infrastrukturë, që nënkupton se ky ligj rregullon edhe dhënen e koncesioneve.

Ky ligj nuk zbatohet për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese. Kjo përcaktohet qartë me paragrafin 2, nënparagrafi 2.5 të nenit 2 ku thuhet se *“ky ligj nuk zbatohet për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese energjetike, që rregullohen sipas ligjit për rregullatorit për Energji përveç nëse me Ligjin për Rregullatorin për Energji kërkohet zbatimi i dispozitave të këtij ligji”* (që i referohet nenit 44 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë).

Duhet të theksohet se me këtë ligj rregullohet dhënia e koncesioneve të (a) punëve, dhe (b) shërbimeve – por jo edhe të koncesioneve për shfrytëzimin e resurseve natyrore.



Edhe pse Ligji për Ujërat e Kosovës për dhënien e koncesioneve për shfrytëzimin e ujërave i referohet Ligjit për Partneritet Publiko Privat si ligj që rregullon koncesionet, në fakt **Ligji për Partneritet Publiko Privat nuk zbatohet për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike.**

Gjithashtu, **Ligji për Partneritet Publiko Privat nuk e rregullon dhënien e koncesioneve për shfrytëzim të resurseve natyrore.**

## 2.4 Ligji për Planifikim Hapësinor

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e Kosovës si vlerë e përgjithshme kombëtare, përmes qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore, si dhe të sigurojë qeverisje të qëndrueshme, shfrytëzim efikas të fondeve publike, parakushte për zhvillim social dhe ekonomik të baraspeshuar, rregullim të qëndrueshëm të hapësirës, duke siguruar trajtim të barabartë, lëvizje të lirë dhe qasje adekuate në shërbimet publike për qytetarët.

Udhëzimi me i rëndësishëm për këtë rast është ai i normave teknike të planifikimit hapësinor. Ligji zbatohet duke u mbështetur në dokumentet e Planifikimit hapësinor si: Plani hapësinor i Kosovës; Hartat zonale; Planet hapësinore Komunale; Planet hapësinore për zonat e veçanta; Planet rregulluese të hollësishme, etj.

## 2.5 Ligji për Ndërtim

Me Ligjin për Ndërtim (Ligji Nr. 04/L-110) rregullohet ndërtimi i të gjitha objekteve ndërtimore në Kosovë, përfshirë projektimin, ndërtimin, dhe rindërtimin e objekteve të ndërtimit.

Me këtë ligj përcaktohen përgjegjësitë për lëshimin e lejeve ndërtimore për Komunitet (kategoria e I-rë dhe II-të) dhe për MMPH (kategoria e III-të).

Me shtojcën e këtij Ligji është përcaktuar që objektet e kategorisë së III-të për të cilat lejen ndërtimore e lëshon Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përfshijnë ndër tjera:

- digat e larta dhe akumulimet e ujit, mbetjet nga minierat ose hiri për të cilat parashihet përkujdesje teknike;
- hidrocentrale dhe termocentrale me diga përkatëse me fuqi dhjetë (10) e më shumë MW,
- objektet për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme të energjisë me fuqi dhjetë (10) e më shumë MW si dhe centralet me prodhim të kombinuar.

Me udhëzimin aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria në pajtim me këtë ligj, janë përcaktuar më në hollësi procedurat e detajuara për aplikim për leje ndërtimore, dhënien e lejes ndërtimore si dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit.

Ligji për ndërtimin në fuqi ka shfuqizuar Ligjin nr. 2004/15 në korrik të vitit 2012. Pra të gjitha procedurat e filluara për marrje të lejeve urbanistike përkatësisht të lejeve të ndërtimit kanë vazhduar duke u bazuar në këtë ligj deri në fuqizimin e Udhëzimit Administrativ nr. 16/2014 për procedurat e marrjes së Kushteve të ndërtimit dhe të lejeve të ndërtimit të Kategorisë së III-të. Për objektet e kategorisë së II-të, Komunitet japin Leje ndërtimore bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 10/2013 për procedurat edhe dhënies së Kushteve të ndërtimit dhe të Lejeve të ndërtimit. Ky udhëzim administrativ në vitin 2019 është ndryshuar dhe plotësuar dhe ka marr emrin Udhëzimi Administrativ MMPH nr. 01/2019 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimin për kategorinë e III-të të ndërtimeve.



## 2.6 Ligji për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës Komunale

Me këtë ligj (nr. 04/L-144) rregullohet mënyra e dhënies në shfrytëzim dhe në këmbim personave fizik dhe juridik e pronës Komunale.

Ky ligj përcakton qartë se dhënia në shfrytëzim e pronës Komunale, qoftë afatshkurtër (1 deri 15 vite) ose afatgjatë (15 deri 99 vite) duhet të bëhet përmes konkurrencës së hapur publike.

Për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë duhet të respektohen kritere specifike të caktuara me këtë ligj si:

- 1) prona të jetë e publikuar në ueb-faqen e komunës,
- 2) prona të jetë e harmonizuar me planin zhvillimor të komunës,
- 3) të këtë arsyeshmëri të interesit publik,
- 4) të plotësohen kushtet dhe kriteret e përcaktuara mjedisore,
- 5) të plotësohen kushtet e planeve urbanistike,
- 6) dhënia e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë, bëhet përmes konkursit të hapur publik me kriteret e përcaktuara me këtë ligj.

Me nenin 10 të këtij Ligji parashihet që dhënia e pronës për qëllime të realizimit të **investimeve në sektorin e energjisë bëhet pa procedurë të konkurrimit**. Procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për këto raste do të përcaktohen me akt nënligjor.

Akti nënligjor që i përcakton këto procedura është Rregullorja e miratuar nga Qeveria e Kosovës nr. 23/2013 për *Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës*. Me këtë Rregullore përcaktohet se *‘përrjashtimi i procedurave të rregullta të konkurrimit bëhet për interes të përgjithshëm publik të dhënies së pronës së paluajtshme të komunës, si dhe subjektin i cili kërkon pronën për shfrytëzim’*.

Me nenin 20 të kësaj Rregulloreje parashihet që dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim për raste të veçanta **pa respektuar procedurat e rregullta të konkurrimit bëhet për interes të përgjithshëm publik** të dhënies së pronës së paluajtshme të komunës. Kërkesën për dhënien në shfrytëzim e bën: (i) Presidenti, (ii) Kuvendi i Kosovës, (iii) Qeveria/Ministritë, (iv) Gjykatat, dhe (v) Agjencitë Shtetërore. Me Rregullore nuk specifikohet cilat janë këto agjenci shtetërore.

Gjithashtu me këtë Rregullore (paragrafi 11 i nenit 20) përcaktohet që dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim me qëllim të realizimit të investimeve në sektorin e energjisë, **bëhet me vendim të Kuvendit të Komunës, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm**.

Rrjedhimisht, përderisa ligji përcakton që procedurat për dhënien në shfrytëzim të tokës do të përcaktohen me akt nënligjor, ky akt nënligjor (Rregullorja nr. 23/2013) **nuk ka përcaktuar asgjë sa i takon procedurave për dhënien në shfrytëzim të tokës Komunale për qëllime të realizimit të investimeve në energji**, përveçse ka përcaktuar se kjo bëhet në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm, pa iu referuar atij specifikisht.

## 2.7 Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

Me këtë ligj (nr. 03/L-214) rregullohet identifikimi projekteve që i nënshtrohen vlerësimin të ndikimit në mjedis, vlerësimin dhe raportimin e ndikimeve të projekteve të caktuara në mjedis, dhe procedurat shoqëruese administrative, gjatë procesit të vendimmarrjes nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Ky ligj ka përcaktuar (në shtojcat e ligjit) që për projektet e impianteve të prodhimit të energjisë elektrike më të vogla se 50 MW duhet të ekzaminohen rast pas rasti se a duhet apo jo të hartohet vlerësimi i ndikimit në mjedis. Kriteret për këtë ekzaminim janë dhënë në shtojcën 3.

## 2.8 Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit

Ky ligj (nr. 03/L-025) ka përkufizuar “lejen mjedisore” si dokument me shkrim i lëshuar nga Ministria i cili kërkohet me qëllim që të merret leja e punës.

Neni 10 i këtij ligji e sanksionon se **asnjë institucion nuk mund ta lëshojë lejen për shfrytëzimin e resurseve natyrore pa pëlqimin mjedisor** për projektin i cili duhet të përmban masat e mbrojtjes dhe rehabilitimit mjedisor.

Sipas këtij ligji, Ministria, me akt nënligjor, përcakton aktivitetet e nevojshme për lëshimin e lejes mjedisore, formën e aplikimit, përmbajtjen e lejes mjedisore, revokimin e lejes, vazhdimin e vlefshmërisë si dhe regjistrin e lejeve të lëshuara.

## 2.9 Ligji për Mbrojtjen e Natyrës

Me këtë Ligj (Ligji Nr. 03/L-233) rregullohen mbrojtja e natyrës, shfrytëzimi i qëndrueshëm të saj dhe veçanërisht mbrojtja, ruajtja, përtëritja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm të resurseve natyrore, në gjendje të baraspeshës natyrore.

Me nenin 135 të këtij Ligji përcaktohet që me **koncesion fitohet e drejta për shfrytëzimin ekonomik të mirave të natyrës** ose e drejta për kryerjen e veprimtarive me interes për Republikën e Kosovës, sipas dispozitave të Ligjit për partneritetet publiko private dhe koncesionet në infrastrukturë dhe procedurat për dhënien e tyre.

Koncesioni sipas këtij Ligji lejohet **në parkun kombëtar në zonën e tretë** në harmoni me planin hapësinor të parkut kombëtar.

Në fakt, me koncesionin si mekanizëm sigurohet e drejta për shfrytëzim dhe/ose eksploitim të resurseve në pronësi publike, përfshirë këtu (i) resurset natyrore dhe (ii) infrastrukturën publike e përcakton edhe neni 121 i Kushtetutës së Kosovës.

## 2.10 Ligji për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” dhe për Parkun Kombëtar “Sharri”

Me këto dy ligje (nr. 04/L – 086 dhe nr. 04/L-087) i miratuar në dhjetor 2012 janë përcaktuar kufijtë e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” dhe të Parkut Kombëtar “Sharri” janë përcaktuar tri zonat e këtyre parqeve si dhe zonat e ndikimit (50 metra nga kufiri i Parkut Kombëtar). Regjimi i mbrojtjes për zonat e Parkut Kombëtar është paraparë të përcaktohet me Planin hapësinor të parkut kombëtar përkatës.

Me Planet Hapësinore të Parkut Kombëtar “Sharri” dhe të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” janë përcaktuar kufizimet në zonat e këtyre parqeve dhe këto kufizime përfshijnë ndalesën në zonën e I-rë dhe të II-të të shumë aktiviteteve përfshirë ndërtimet e kapaciteteve gjeneruese energjetike (në zonën e II-të kërkohet që për të gjitha aktivitetet e pashmangshme të zhvillimit dhe ndërtimit në interes kombëtar si p.sh. ndërtimi i rrugëve dhe

instalimi i linjave të shërbimeve siç janë kabllot dhe linjat e energjisë, duhet t'i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe masave për zbutje që janë në pajtim me vlerat dhe objektivat e Parkut Kombëtar).

## 2.11 Ligji për Miniera dhe Minerale

Ky ligj (Ligji Nr. 03/L-163) rregullon hulumtimin dhe shfrytëzimin e resurseve minerale në Republikën e Kosovës.

Me këtë ligj resurset minerale përkufizohen si: “çfarëdo minerali metalik, industrial, ndërtimor, gurë të çmuar ose gjysmë të çmuar, mineral energjetik ose **ujë që ka vlerë potenciale ekonomike.**” Me nenin 4 këtij ligji përcaktohet se ky ligj zbatohet për të gjitha aktivitetet e hulumtimit, shfrytëzimit dhe/ose përpunimit të resurseve minerale në Kosovë.

Në anën tjetër, me nenin 13 të këtij ligji theksohet se poseduesi i licencës së shfrytëzimit të resurseve minerale nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari në ndonjë sipërfaqe e cila është jo më larg se 150 metra prej një lumi. Me këtë dispozitë praktikisht përjashtohet shfrytëzimi i ujërave për gjenerimin e energjisë elektrike.

### III. METODOLOGJIA E PUNËS

Duke pasur parasysh detyrat e përcaktuara për grupin punues me vendimin e Ministrit si dhe natyrën e punës që kërkohet për kryerjen e këtyre detyrave, GP në takimin e vet të I-rë të mbajtur më 19 maj 2021, ishte dakorduar që për detyrat e përcaktuara të veprohet si vijon:

#### Detyra 3.1 e Vendimit: **Identifikimi i të gjitha hidrocentraleve operacional ose në ndërtim**

*Identifikimi i HC-eve që janë duke operuar dhe atyre që janë në ndërtim e sipër, të kryhet nga kryesuesi i GP.*

Identifikimi i këtij informacioni ishte siguruar nga kryesuesi i GP përmes ARPL në takimin e radhës së GP (shih **Shtojcën 2** të këtij raporti).

#### Detyra 3.2 e Vendimit: **Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve administrative të lëshuara për hidrocentrale**

*Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve administrative të bëhet duke u bazuar në formularin e përgatitur për ecurinë e procesit dhe dokumentacionin e nevojshëm për secilin prej akteve.*

Formularët e shqyrtimit ishin përgatitur bazuar në kërkesat ligjore dhe bazuar në modelin e aplikuar nga departamenti i planifikimit hapësinor dhe ndërtimit i Ministrisë për: aktet mjedisore, aktet ujore dhe aktet e ndërtimit (shih **Shtojcën 3** të këtij raporti).

#### Detyra 3.3 e Vendimit: **Identifikimi i ndikimeve në resurse ujore, mjedis dhe në bilancet ekonomike të komunitetit**

*Për kryerjen e punëve sipas pikës 3.3 të vendimit të Ministrit, të angazhohet nëngrupi i GP – ekipi i terrenit.*

Ekipi i terrenit ishte ngarkuar që të hartojë një plan dinamik për punën në terren dhe që punën ta kryejë deri më 5 qershor 2021.

#### Detyra 3.4 e Vendimit: **Identifikimi i kostove të secilit hidrocentral**

*Për identifikimin e kostove të HC-eve të shqyrtohen mundësitë e sigurimit të informacioneve të sakta për koston e investimeve në secilin hidrocentral. Burimet e mundshme të informacionit ndër tjera janë: vlera parallogaritare e projektit, informacioni nga investitori për vlerën totale të investimit, informacioni nga ZRRE. Për këtë qëllim, Kryesuesi i GP do të kërkojë me shkrim informacion nga burimet e mësipërme.*

#### Detyra 3.5 e Vendimit: **Verifikimi i përputhjeve në mes të akteve administrative dhe punimeve dhe zbatimit të projekteve, në rastet kur ato tashmë janë ndërtuar ose janë në ndërtim e sipër**

*Për verifikimin e përputhjeve në mes të akteve administrative dhe punimeve në zbatimin e projekteve të shfrytëzohen gjetjet nga inspektimi në terren nga ekipi i terrenit.*

#### Detyra 3.6 e Vendimit: **Paraqitja e analizave dhe rekomandimeve për Ministrin e MMPHI dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës.**

*Hartimi i raportit me analizat dhe rekomandimet të kryhet bazuar në gjetjet e punës në shqyrtimin e dokumentacionit dhe punës në terren deri në më 30 qershor 2021 sipas afatit të përcaktuar me vendimin e Ministrit.*

## IV. GJETJET

### 4.1 Hidrocentralet e kaskadës së Deçanit – “Deçani”, “Belaja” dhe “Lumbardhi 2”

#### 4.1.1 HYRJE

Në Lumbardhin e Deçanit ka funksionuar hidrocentrali i Lumbardhit (Kozhnjerit) prej vitit 1957 me kapacitet (fuqi instaluese) prej 8.5 MW. Ky hidrocentral pas luftës (në vitin 2004) është dhënë me kontratë lizingu në shfrytëzim kompanisë *Triangle* për periudhë 20 vjeçare. Në ndërkohë, prej vitit 2009, ky hidrocentral ka filluar të operohet nga *Kelkos Energy* sh.p.k. bazuar në marrëveshje në mes të palëve.

Me studimin e para-fizibilitetit të vitit 2006 të financuar nga Ministria e Energjisë dhe Minerave, ishte identifikuar potenciali edhe për 2 HC-e në Lumbardhin e Deçanit: Hidrocentrali Deçan me kapacitet prej 8.3 MW dhe Hidrocentrali Belle (Belaje) me kapacitet 5.2 MW. Vlera paralogaritare për financimin e këtyre dy HC-eve me studim të parafizibilitetit ishte vlerësuar në rreth 11 milion EUR (6.31 milion Deçani dhe 4.97 milion Belaja).

Në vitin 2011, *Kelkos Energy* kishte bërë rivlerësimin e potencialit energjetik të Lumbardhit dhe rivlerësimin e kostove dhe kishte arritur në përfundim se mund të ndërtohen 3 HC-e të reja (**jo dy sa ishte paraparë me studimin e para-fizibilitetit**) me kapacitete dhe kosto si vijon:

- 1) HC ‘Deçan’ - fuqi instaluese 8.4 MW (28 GWh), dhe investimin e vlerësuar prej 19 milion EUR. Me vendim të organeve përgjegjëse (ZRRE dhe MMPH) më vonë ishte aprovuar ndryshimi i kapacitetit të këtij HC-i nga 8.4 MW në 9.8 MW;
- 2) HC ‘Belaje’ - fuqi instaluese 9.2 MW (29.7 GWh), dhe investimin e vlerësuar prej 19 milion EUR. Me vendim të organeve përgjegjëse (ZRRE dhe MMPH), më vonë ishte aprovuar zvogëlimi i kapacitetit të këtij HC-i nga 9.2 MW në 8.06 MW;
- 3) HC ‘Lumbardhi II’ - fuqi instaluese 5.5 MW (11.7 GWh) dhe investimin prej 15 milion EUR. Me vendim të organeve përgjegjëse (ZRRE dhe MMPH), më vonë ishte aprovuar rritja e kapacitetit të këtij HC-i në 6.2 MW.

Si konkluzion, *Kelkos Energy* ka rivlerësuar fuqinë instaluese të HC-eve në Lumbardhin e Deçanit dhe sipas vlerësimit të tyre potenciali energjetik kishte rezultuar dukshëm më i madh krahasuar me studimin e para-fizibilitetit (23.36 MW krahasuar me 13.5 MW sa ishte vlerësuar) të vitit 2006<sup>6</sup>.

#### 4.1.2 SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE ADMINISTRATIVE

##### a) Aktet ujore<sup>7</sup>

<sup>6</sup> Me studimin e para-fizibilitetit ishin paraparë 2 HC (Deçani dhe Belaja) me kapacitet të përgjithshëm 13.5 MW (8.3MW + 5.2MW). Ndërkaq me vlerësimin e Kelkos Energy janë paraparë 3 HC-e (përpos dy të parave edhe Lumbardhi 2), me kapacitet të përgjithshëm 23.1 MW (8.4 MW + 9.2 MW + 5.5MW).

<sup>7</sup> Në përgjigjen e zyrtares për aktet ujore, se a kanë të gjitha HC-të studime Hidrologjike dhe PPE-së qëndron se të gjitha HC-të në dosjet e tyre posedojnë me studimet në fjalë.

GP, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, ka mundur të konstatojë kronologjinë e shqyrtimit të aplikacioneve dhe lëshimit të akteve ujore për HC-et e kaskadës së Deçanit si vijon:

- (i) Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të bashkangjitur nga *Kelkos Energy* për leje ujore për HC-et e kaskadës së Deçanit, më datë 24 janar 2012, MMPH ka hartuar një **Konkluzion** me të cilin janë përcaktuar një numër i konsiderueshëm i kërkesave shtesë për dokumente dhe informacione dhe është përcaktuar afati prej 60 ditësh për dorëzimin e tyre;
- (ii) Më 27 janar 2012 (3 ditë pas nxjerrjes së Konkluzionit), MMPH ka krijuar **një komision 5 anëtarësh** me vendim Nr. 09/2012, i cili komision ishte ngarkuar me shqyrtimin e dokumentacionit dhe me udhëheqjen e procesit të lëshimit të lejeve ujore;
- (iii) Komisioni i formuar me vendimin nr. 09/2012 ka hartuar një **Propozim–Vendim** (nr. 255/2-12) më datë 9 shkurt 2012 me të cilin propozohet aprovimi i kërkesës së *Kelkos Energy* për leje ujore me një listë prej 10 kushtesh.
- (iv) Në ditën e njëjtë kur është hartuar Propozim-Vendimi (më 9 shkurt 2012), MMPH ka nxjerrë **vendimin për lëshimin e lejeve ujore** ashtu siç është rekomanduar me Propozim–Vendimin **për 2 HC-et e Deçanit** (“Deçani”, “Belaja”). Këto leje ujore janë lëshuar për periudhë 15-vjeçare. Në vendimin për lejen ujore (pika 6) konfirmohet dispozita ligjore që ‘e drejta e fituar me leje ujore pushon në rast se në afat prej më shumë se një viti nuk shfrytëzohet.’ Gjithashtu, në vendimin për leje ujore (pika 10) thuhet që ‘validiteti i lejes ujore pushon në rast të mosplotësimit të kushteve të cekura me leje ujore në afatet e parapara kohore’.
- (v) **Vendimi për lejen ujore për HC “Lumbardhi II”** është lëshuar më 19 mars 2013 (vendimi nr. 1839/11-ZSP-229-2013). Për dallim prej lejeve ujore për 2 HC-et tjera, leja ujore për HC “Lumbardhi II” është lëshuar për periudhë 20 vjeçare. Kjo leje ujore ka më shumë kushte se dy lejet tjera (i ka 22 kushte gjithsej, ndërkaq dy tjerat nga 10 kushte) të cilat duhet të përmbushen në afatin e përcaktuar prej 90 ditësh. Është me interes të theksohet se kjo leje ujore nuk e përmban përcaktimin që në rast të mosshfrytëzimit të drejtës ujore për 1 vit, pushon e drejta ujore, por e përmban përcaktimin që nëse nuk përmbushen kushtet e përcaktuara me leje ujore në afatet e përcaktuara, leja ujore pushon.
- (vi) **Nuk ka evidencë që kushtet e përcaktuara me leje ujore janë përmbushur** deri në vitin 2020, kur është ri-lëshuar leja ujore!
- (vii) Në vitin 2016 (24/03/2016) është aprovuar me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së ndryshimi i fuqisë instaluese të HC-eve si vijon: HC “Deçani” nga 8.4 MW në 9.8 MW dhe HC “Belaja” nga 9.3 MW në 9.2 MW.
- (viii) Në vitin 2018 (13/11/2018) me vendim është aprovuar ndryshimi i fuqisë instaluese për HC “Lumbardhi II” nga 5.5 MW në 6.2 MW. Ky vendim është nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPH.
- (ix) Më datë 3 dhe 4 nëntor 2020, MMPH ka lëshuar përsëri leje ujore për dy HC-et e Deçanit (“Belaja” dhe Deçani” respektivisht) të titulluara *Leje Ujore (për aprovimin e plotësimit të kushteve ujore të parapara me lejen ujore paraprake dhe ndryshimin e kapacitetit instalues)*. Edhe pse titulli i vendimit i referohet aprovimit të plotësimit të kushteve të parapara me lejen ujore paraprake, me këtë leje ujore përsëri vendosen kushte të njëjta të cilat ishin përcaktuar në vitin 2012 e që kërkohen të përmbushen nga *Kelkos Energy* (si realizimi i strukturave të monitorimit të prurjeve, hartimi i studimit të Prurjes së Pranueshme Ekologjike etj.). Me këtë leje ujore nuk është përcaktuar që leja



ujore ndërpritet në rast të mospërmbushjes së kushteve të lejes ujore, edhe pse një përcaktim i tillë është në Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 76).

- (x) Në janar të vitit 2021 **është përsëritur leja ujore edhe për HC “Lumbardhi II”** në formën dhe përmbajtjen e njëjtë sikurse për dy HC-et tjera.
- (xi) Të tria lejet ujore të vitit 2020 dhe 2021, janë nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë por vendimi është marrë nga ARPL (siç shihet nga shkresa përcjellëse e vendimit).
- (xii) Arsyetimi i vendimeve për lejet ujore (nga pika ix dhe pika x më sipër) mungon (me gjasë si rezultat i lëshimit teknik, meqenëse teksti pas pikës 12 të dispozitivit është menduar të jetë arsyetimi i vendimit, por i njëjti është i mangët).

#### a.1 Ligjshmëria e akteve ujore

- 1) Dhënia e të drejtës ujore me *leje ujore* e jo me *koncesion* siç ishte përcaktuar me Ligjin për Ujëra nr.2004/24 të vitit 2004 (neni 60, parag. 60.2,a) përbën shkelje të ligjit. Në nenin e njëjtë të këtij ligji është përcaktuar që ‘shuma e realizuar nga kontrata e koncesionit derdhet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.’ Edhe me ligjin e ri për ujëra të miratuar në vitin 2013 (Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës) çështja e shfrytëzimit të ujit për hidroenergjji është rregulluar njësoj – neni 78, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2, e ka sanksionuar qartë dhe njësoj sikurse ligji i vitit 2004 që e drejta ujore për ‘shfrytëzimin e fuqisë së ujit për prodhimin e energjisë elektrike’ fitohet me koncesion.
- 2) Lëshimi i lejes ujore pa u plotësuar kushtet e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ<sup>8</sup> në fuqi për leje ujore i vitit 2005 sa i përket përmbajtjes së aplikacionit mbi bazën e të cilit lëshohet leja ujore (neni 22 i UA) përbën shkelje ligjore. Lëshimi i lejes pa qenë i bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit relevant dhe kërkesa që ky dokumentacion të sigurohet në afat prej 90 ditësh **pas** lëshimit të lejes ujore **përbën shkelje të UA për leje ujore** (neni 22) dhe për më tepër është krejtësisht i pakuptimtë – lëshohet leja për shfrytëzim të ujit pa pasur idenë sa do të jetë sasia e ujit të shfrytëzuar, sa do të jetë prurja ekologjike, si do të matet sasia e ujit të shfrytëzuar dhe prurja ekologjike që duhet të lëshohet në lumë, cili është regjimi i aluvioneve etj.
- 3) Lejet ujore nuk janë revokuar nga Ministria ashtu siç përcaktohet me Ligjin nr. 2004/24 për Ujërat e Kosovës (neni 58), përkundër faktit që afati prej 90 ditësh i përcaktuar për përmbushjen e kushteve të lejes ujore (hartimi i elaboratit për minimumin biologjik, elaborati hidrologjik, analiza e regjimit të aluvioneve etj.) nuk është respektuar nga *Kelkos Energy*.
- 4) Studimi i prurjes së pranueshme ekologjike (PPE) i dorëzuar nga *Kelkos Energy* në vitin 2020 nuk i përmbushë kërkesat e përcaktuara me Rregulloren nr. 02/2016 për Përcaktimin e Prurjes së Pranueshme Ekologjike. Dorëzimi i këtij studimi ka qenë obligim i përcaktuar me leje ujore prej vitit 2012 (Deçani dhe Belaja), 2013 (Lumbardhi II). Vlerësimin për përputhshmërinë e studimit të PPE e ka kryer GP për Hidrocentrale (shih **Shtojcën 7** të raportit).

<sup>8</sup> Udhëzimit Administrativ nr. 63-24/05 Mbi Përmbajtjen, Formën, Kushtet dhe Mënyrat e Lëshuarjes dhe Ruajtjes së Lejes Ujore

## b) Aktet mjedisore

GP, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, ka mundur të konstatojë kronologjinë e shqyrtimit të aplikacioneve dhe lëshimit të pëlqimeve mjedisore për HC-et e kaskadës së Deçanit si vijon:

- (i) Pëlqimi mjedisor për vendosje të gypave, kabllave elektrike dhe fibrave optikë është lëshuar nga MMPH me nr. 11/445/2-ZSP-251/11, datë, 08/12/2011.
- (ii) Pëlqimi mjedisor për të tri HC-et e kaskadës së Deçanit: HC “Lumbardhi II”, HC “Belaja”, HC “Deçan” është lëshuar nga MMPH me nr. 11/445/3-ZSP-41/12, datë, 02/03/2012.
- (iii) Lëshimi i pëlqimit mjedisor për të tri HC-et: “Lumbardhi II”, “Belaja” dhe “Deçani” është në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit të VNM-së.<sup>9</sup>

Sa i përket **lejeve mjedisore**, të njëjtat janë lëshuar si vijon:

- (i) Leja mjedisore për HC “Deçani” dhe pajimet përcjellëse: gypat, kabllot elektrike dhe fibrat optikë e lëshuar me nr. protokolit 5837/19; datë: 06. 11. 2020. Me leje mjedisore është kërkuar që:
  - Të respektohet prurja e pranueshme ekologjike në përputhje me lejet ujore për shfrytëzim të ujit, ligjin e ujërave dhe aktet nënligjore nga ky ligj.
  - Të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike.
- (ii) Leja mjedisore për HC “Belaja” dhe pajimet përcjellëse: gypat, kabllot elektrike dhe fibrat optikë e lëshuar me nr. 5837/19; datë: 06.11.2020. Me leje mjedisore është kërkuar që:
  - Të respektohet prurja e pranueshme ekologjike në përputhje me lejet ujore për shfrytëzim të ujit, ligjin e ujërave dhe aktet nënligjore nga ky ligj.
  - Të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike.
- (iii) Leja mjedisore për HC “Lumbardhi II” nuk është lëshuar ende, meqenëse pas sigurimit të lejes ujore për këtë HC (në janar 2021) dhe certifikatës së përdorimit, komisioni për leje mjedisore nuk ka mundur ta konfirmojë përmbushjen e kushteve për lëshimin e lejes mjedisore që duhet të bëhet pas vizitës në terren. Vizita në terren e realizuar më 25 shkurt 2021, për shkak të borës, nuk ka qenë e mundshme të merret vendimi nga komisioni i cili e ka konstatuar këtë në takimin e mbajtur me 3/03/2021. Pas kërkesës së SP të MMPHI që lejet për HC-e të lëshohen vetëm në pajtim të plotë me ligjin, komisioni për leje mjedisore po pret udhëzime si të veprojë më tutje.

<sup>9</sup> Të 3 HC-at janë trajtuar në mënyra të ndryshme në aktet e ndryshme administrative sipas preferencave të operatorit p.sh. pëlqimi mjedisor është dhënë për të tria bashkë, njëjtë edhe pëlqimi Komunal, kurse lejet ujore janë dhënë ndaras si dhe lejet mjedisore, ndërsa lejet urbanistike janë dhënë për 2 bashkë e 1 për një veçmas. *Sqarim*: bazuar në faktin se ndërtimi i HC-ve sipas Ligjit Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis neni 7, bënë pjesë në Shtojcën II të Ligjit ku përzgjedhja se a duhet hartuar raport i VNM-së bëhet rast për rast, sipas kushteve të përcaktuara me Shtojcën III, si dhe meqë vendimi preliminar i lëshuar nga ZRRE dhe vendimi nga Kuvendi Komunal i Deçanit për HC-et në kaskadën e Lumbardhit janë trajtuar si një projekt, edhe DMM ka ndjek të njëjtën praktikë me rastin e lëshimit të Pëlqimit Mjedisor, duke pas parasysh edhe ndikimin kumulativ të këtij aktiviteti.



- (iv) Konstatimet e komisionit për lëshimin e lejes mjedisore për HC “Deçani” dhe HC “Belaje” se “prurja e pranueshme ekologjike po respektohet” pa verifikuar një gjë të tillë me të dhëna nga stacioni hidrometrik, GP i konsideron si konstatime joprofesionale. Njësoj edhe sa i përket konstatimit të komisionit për leje mjedisore se “shtigjet e peshqve janë funksionale” pa kryer monitorim adekuat për mënyrën e funksionimit të shtigjeve të peshqve, konsiderohet nga anëtarët e GP si joprofesional.
- (v) Afatet për lëshimin e lejes mjedisore për HC-et e Deçanit, në veçanti kjo për HC “Lumbardhi II” janë të tejzgjatura dhe nuk përkojnë me dispozitat e UA për Leje Mjedisore nr. 07/2017.

### c) Aktet ndërtimore

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GP ka konstatuar sa vijon:

- (i) Lejet urbanistike - janë lëshuar dy leje urbanistike për 3 HC-et e kaskadës së Deçanit: (i) një për HC “Deçani” dhe “Belaje” (nr. ZSP-91/2012, datë 16/02/2012) secili prej tyre me kapacitet instalues nën 10 MW, dhe (ii) një tjetër për HC “Lumbardhi II” me kapacitet 5.5 MW dhe Pendën (leja nr. ZSP/474/2013 e datës 28/05/2013).
- (ii) Leja e ndërtimit për HC-et “Deçani” dhe “Belaje” - të dyja me kapacitetin e planifikuar nën 10 MW (“Deçani” 8.2MW ndërkaq Belaja 9.3MW) do të duhej të lëshoheshin nga Komuna (sipas Ligjit për Ndërtim nr. 2004/15). Megjithatë, për këto dy HC-e është lëshuar një leje e ndërtimit nga Ministria (ZSP-321/2012, datë 7/05/2012) me praktikën e njëjtë siç janë lëshuar lejet urbanistike sepse kështu të bashkuara kapaciteti i tyre është nën 20 MW. Arsytimi dhe motivet e lëshimit të një leje për dy HC-et janë të pasqaruara. Megjithatë, bashkimi i dy HC-eve (“Deçani” dhe “Belaje”) në një leje, duke pasur parasysh se secila prej tyre ka kapacitet më të vogël se 10MW, ka mundësuar lëshimin e lejes nga MMPH (pasi që për HC-e nën 10MW lejet i lëshojnë Komunat).
- (iii) Leja e ndërtimit për HC “Lumbardhi II” dhe diga është lëshuar më 9/08/2013 (nr. ZSP-732/13, datë 9/08/2013). Përfshirja e digës në leje të ndërtimit ka mundësuar që leja të lëshohet nga Ministria duke pasur parasysh se kapaciteti i HC-it është nën 10 MW (5.5 MW). Diga nuk është ndërtuar fare! Leja e ndërtimit është lëshuar nga SP, pa rekomandimin e njësisë përkatëse/zyrtari përgjegjës.
- (iv) Leja e ndërtimit për veprat marrëse, tubacionet, kablllo dhe fibrat optikë për HC “Belaje” dhe HC “Deçani” – nuk është lëshuar asnjëherë nga Ministria me justifikimin se në projektin e dorëzuar nuk kanë mundur të identifikohen parcelat kah kalon traseja e tubacioneve. Parashtruesit të kërkesës i është kërkuar që ta evitojë këtë lëshim në mënyrë që të jetë i mundshëm shqyrtimi, por ai nuk e ka bërë një gjë të tillë. Për pasojë, **punimet në ndërtimin e kablllove, tubacioneve janë kryer pa leje të ndërtimit** – në mënyrë të paligjshme!
- (v) Leja e përdorimit për HC “Deçani” dhe “Belaje” – është lëshuar më 20/09/2019 (nr. ZSP-1220/2019). Për lëshimin e lejes së përdorimit ndër tjera janë marrë parasysh: (i) leja e ndërtimit, (ii) raporti i revidimit i datës 21/06/2019, (iii) projekti i objektit të zbatuar, (iv) incizimi gjeodezik për HC-et, (v) raporti i komisionit për kontrollin teknik të punëve të kryera (nr. 5562/19 i datës 11/09/2019). Ky raport në pjesën hidroteknike, e cila edhe pse me mangësi të theksuara, konstaton se “duhet të përcaktohet dhe të përcjellët lëshimi i rrjedhjes minimale biologjike”.
- (vi) Certifikata e përdorimit për HC “Lumbardhi II” (**pa digë**) – është lëshuar me datë 23/08/2019 (nr. ZSP-1072/2019). Certifikata e përdorimit është lëshuar duke marrë

parasysh, ndër të tjera: (a) raportin përfundimtar të inspektoratit (nr. 5173/19) i datës 23/08/2019 (pra data e njëjtë me datën e lëshimit të certifikatës së përdorimit), (b) incizimi gjeodezik i ndërtimit, (c) atestet për materialet e përdorura gjatë ndërtimit, (d) raportet nga inxhinierët mbikëqyrës nga fazat e ndërtimit (këto raporte janë të nënshkruara vetëm nga poseduesi i lejes e jo edhe nga kontraktuesi siç përcaktohet me ligjin për ndërtim.

- (vii) Pranimi teknik dhe lëshimi i certifikatës së përdorimit është bërë pa raport të inspeksionit ndërtimor, meqenëse ky i fundit nuk ka qenë i njoftuar nga investitori për përfundimin e fazave të ndërtimit, ashtu siç kërkohet me Ligjin për Ndërtim (neni 31).
- (viii) Ndryshimet në projekt janë bërë pa pëlqimin e Ministrisë, siç kërkohet me vendimin për leje ndërtimore. Në skicën e gjeodetit të licencuar për projektin e zbatuar mungon numri i parcelave me çka nuk është definuar nëse ndërtimi është realizuar në parcelën P-70505021-8-0. Muret e realizuara të betonit nuk janë të parapara (paraqitura) në projektin kryesor në bazë të cilit është lëshuar leja e ndërtimit.
- (ix) Certifikata e legalizimit për tubacionin, veprën marrëse, kabllon elektrike 35kV dhe kabllon me fibra optikë – është lëshuar nga Ministria më datë 9/10/2020 (protokolluar me date 15/10/2020 me nr. SP-02; 5704-2/19). Numrat e protokollit të lejeve urbanistike për HC-et, të referuar në këtë certifikatë, nuk korrespondojnë me numrat e lejeve urbanistike.
- (x) Pëlqimi dhe kontrata e vazhduar nga Agjencia Pyjore e Kosovës me Kelkos Energy – për dhënien në shfrytëzim të tokës pyjore është bërë në kundërshtim UA(MBPZHR) Nr. 01/2020 i datës 11.06.2020 neni 7 paragrafi 1.9 ku APK për lëshimin e pëlqimit dhe kontratës për shfrytëzim të tokës pyjore në zonat e mbrojtura (park kombëtar) duhet të kërkohet pëlqimi nga ministria përgjegjëse për Ambient, të cilin nuk e kanë siguruar paraprakisht.
- (xi) Leja ndërtimore për dy HC-et (Lumbardhi II dhe Belaje) është lëshuar në pronë ujore në afërsi të drejtpërdrejt të lumit, në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 48) që përcakton distancën prej minimum 30 metra për ndërtimin e objekteve nga vija e plotave (ujërat 100-vjeçare).
- (xii) Ndërtesat e HC “Deçani” dhe HC “Belaje” janë ndërtuar brenda Zonës së Veçantë të Mbrojtur të Manastirit të Deçanit, që është shkelje e Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (neni 5 i Ligjit).

#### **4.1.3 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË RESURSET UJORE, MJEDIS DHE BILANCET EKONOMIKE**

##### **a) Skema e HC “Lumbardhi II”**

- (i) Akumulacioni i paraparë me raportin e VNM-së nuk është ndërtuar fare.
- (ii) Lokacioni “Zalli i Rupës” është degraduar skajshmërisht si rezultat i eksploatimit të zhavorrit nga ana e poseduesit të lejes ndërtimore. Operatori këtu ka operuar në këtë lokacion në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit të VNM-së nr. 03/L-214, dhe neni 31 të Ligjit mbi Mbrojtjen e Mjedisit nr. 03/L-025. Po ashtu, rruga për në këtë lokacion ka shembje të dheut si rezultat i punimeve, gjë që paraqet vështirësi të kalimit në këtë pjesë të rrugës.
- (iii) Lokacioni ku janë zhvilluar punimet ka mbetur i degraduar (shih shtojcën 3 të raportit)
- (iv) Shtegu i peshqve nuk është i zbatuar në mënyrën e duhur.

- (v) Ka hedhje të palejuara të betonit të tepruar në brigjet e lumit.
- (vi) Nuk ka matje të nivelit/prurjeve të ujit as para as pas veprave ujëmarrëse.
- (vii) Traseja e tubacioneve shtrihet nëpër sipërfaqe publike.
- (viii) Strukturat e betonit në veprat ujëmarrëse janë në shpërputhje të plotë me peizazhin.
- (ix) Ndërtesa e hidrocentralit është ndërtuar në pronën ujore.

#### **b) Skema e HC “Belaje”**

- (i) Shtegu i peshqve nuk është i zbatuar në mënyrë të duhur.
- (ii) Traseja e tubacioneve shtrihet nëpër sipërfaqe publike.
- (iii) Strukturat e betonit në veprat ujëmarrëse janë në shpërputhje të plotë me peizazhin.
- (iv) Ndërtesa e hidrocentralit është ndërtuar në pronën ujore.
- (v) Përgjatë rrugës janë vendosur kabllo të tensionit të lartë 35 kV mbi gypat e ujësjellësit, gjë që e vështirëson mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe përbën rrezik për jetën e punëtorëve që punojnë në mirëmbajtjen e këtyre gypave.

#### **c) Skema e HC “Deçani”**

- (i) Shtegu i peshqve nuk është i zbatuar në mënyrë të duhur.
- (ii) Traseja e tubacioneve shtrihet nëpër sipërfaqe publike.
- (iii) Strukturat e betonit në veprat ujëmarrëse janë në shpërputhje të plotë me peizazhin.
- (iv) Ndërtesa e hidrocentralit është ndërtuar në pronën ujore.
- (v) Përgjatë rrugës janë vendosur kabllo të tensionit të lartë 35 kV mbi gypat e ujësjellësit, gjë që e vështirëson mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe përbën rrezik për jetën e punëtorëve.

### **4.1.4 KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR HC-et E DEÇANIT**

#### **4.1.4.1 Konkluzionet**

- 1) Dhënia e të drejtës ujore me *leje ujore* e jo me *koncesion* përbën shkelje të Ligjit për Ujëra nr. 2004/24 të vitit 2004 (neni 60, paragrafi 60.2, a) dhe Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës të vitit 2013 (neni 78, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2).<sup>10</sup>
- 2) Lëshimi i lejeve ujore pa u plotësuar kushtet e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ<sup>11</sup> në fuqi për leje ujore i vitit 2005 sa i përket përmbajtjes së aplikacionit mbi bazën e të cilit lëshohet leja ujore (neni 22 i UA) është në kundërshtim me legjisllacionin.
- 3) Lejet ujore të lëshuara në vitin 2012 dhe në vitin 2013 nuk janë revokuar nga Ministria ashtu siç përcaktohet me Ligjin nr. 2004/24 për Ujërat e Kosovës (neni 58), përkundër faktit që afati prej 90 ditësh i përcaktuar për përmbushjen e kushteve të lejes ujore (hartimi i elaboratit për minimumin biologjik, elaborati hidrologjik, analiza e regjimit të aluvioneve etj.) nuk ishte respektuar nga Kelkos Energy.
- 4) Studimi i prurjes së pranueshme ekologjike (PPE) nuk ishte dorëzuar nga Kelkos Energy deri në vitin 2020 përkundër faktit se dorëzimi i këtij studimi është kusht i domosdoshëm për lëshimin e lejes ujore.

<sup>10</sup> Procesi i dhënies së akteve ujore është zhvilluar gjatë viteve 2007 deri 2021 gjatë së cilës kohë sa i përket të drejtës për shfrytëzim të ujit kanë qenë në fuqi Ligji për Ujërat e Kosovës nr. 2004/24 i vitit 2004 dhe Ligji nr. 04/L-147 i vitit 2013.

<sup>11</sup> Udhëzimit Administrativ nr. 63-24/05 Mbi Përmbajtjen, Formën, Kushtet dhe Mënyrat e Lëshuarjes dhe Ruajtjes së Lejes Ujore.

- 5) Studimi për PPE i dorëzuar nga Kelkos Energy në vitin 2020 për të tri HC-et e kaskadës së Deçanit nuk i përmbushë kërkesat e përcaktuara me UA nr. 02/2016 për Përcaktimin e Prurjes së Pranueshme Ekologjike.
- 6) Lëshimi i akteve administrative është bere me një qasje jo konsistente me ç'rast disa janë lëshuar për hidrocentrale të veçanta dhe disa për tria së bashku.
- 7) Leja e ndërtimit për HC "Lumbardhi II" dhe digën është lëshuar nga Ministria edhe pse HC "Lumbardhi II" është me kapacitet më të vogël se 20 MW. Përfshirja e digës në leje të ndërtimit ka mundësuar që leja të lëshohet nga Ministria. Diga nuk është ndërtuar fare!
- 8) Leja e ndërtimit për HC "Belaja" me kapacitet 9.2 MW dhe hidrocentralin "Deçan" me kapacitet 8.4 MW", është lëshuar nga Ministria në kundërshtim me Ligjin e Ndërtimit 2004/15, për faktin se këto dy HC kanë fuqi instaluese me të vogël se 20 MW.
- 9) Leja e ndërtimit për veprat marrëse, tubacionet, kablo dhe fibrat optikë për HC "Belaje" dhe HC "Deçani" – nuk është lëshuar asnjëherë nga Ministria me justifikimin se në projektin e dorëzuar nuk kanë mundur të identifikohen parcelat kah kalon traseja e tubacioneve. Për pasojë, **punimet në trasenë për vendosjen e kablove, tubacioneve janë kryer pa leje të ndërtimit** – në mënyrë të paligjshme!
- 10) Lëshimi i certifikatës së përdorimit për HC-et e kaskadës së Deçanit është bërë pa raport të inspeksionit ndërtimor, meqenëse ky i fundit nuk ka qenë i njoftuar nga investitori për përfundimin e fazave të ndërtimit, ashtu siç kërkohet me Ligjin për Ndërtim (neni 31).
- 11) Në HC "Lumbardhi II" janë bërë ndryshime në projekt pa pëlqimin e Ministrisë, siç kërkohet me vendimin për leje ndërtimore.
- 12) Pëlqimi dhe kontrata e vazhduar nga Agjencia Pyjore e Kosovës me Kelkos Energy për dhënien në shfrytëzim të tokës pyjore është bërë në kundërshtim me ligj, meqenëse paraprakisht APK është dashur ta sigurojë pëlqimin e MMPH sipas UA(MBPZHR) Nr. 01/2020 i datës 11.06.2020- neni 7 kriteret paragrafi 1.9 për zonat e mbrojtura kërkohet pëlqimi nga ministria përgjegjëse për Ambient.
- 13) Ndërtesat e dy HC (Lumbardhi II dhe Belaja) janë ndërtuar në pronë ujore në afërsi të drejtpërdrejt të lumit, në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 48) që përcakton distancën prej minimum 30 metra për ndërtimin e objekteve nga vija e plotave (ujërat 100-vjeçare).
- 14) Eksploatimi i zhavorrit dhe rërës në lokacioni " Zalli i Rupës" është bërë në kundërshtim me nenin 11 paragrafi 4 dhe neni 128 paragrafi 3 të Ligjit për mbrojtjen e Natyrës në vitin 2010 dhe gjate vazhdimit të procedurave të lëshimit të tjera të akteve administrative nuk është zbatuar neni 10 i UA. Nr. 04/2016 për mbrojtjen e brigjeve të ujërrjedhave.
- 15) Ndërtesat e HC "Deçani" dhe HC "Belaje" janë ndërtuar brenda Zonës së Veçantë të Mbrojtur të Manastirit të Deçanit, që është shkelje e Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (neni 5 i Ligjit).

#### 4.1.4.2 Rekomandimet

Bazuar në konkluzionet nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe gjetjet në terren rekomandohen që të ndërmerren veprimet si vijon:

- 1) **Shfuqizimin/Anulimin e akteve administrative mbi bazën e shkeljeve të ligjeve materiale dhe procedurale** – Ligji për Ujërat e Kosovës dhe akteve nënligjore të miratuara në pajtim me këtë ligj, Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në

Mjedis, Ligji për mbrojtjen e Natyrës, Ligji për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

- 2) Të zbatohet koncesioni si instrument i të drejtës ujore në pajtim me ligjin e ujërave përmes kontratës koncesionare duke marr parasysh gjendjen faktike të krijuar në terren, **dhe të kërkohet nga investitori Kelkos Energy sh.p.k. që:**
- a. **të kushtëzohet lëshimi i lejes mjedisore me ndërtimin e digës në liqenin në lokacionin “Zalli i Rupës”** ashtu siç ishte paraparë me raportin e VNM-së dhe pëlqimin mjedisor si dhe marrëveshjes së investitorit me komunën e Deçanit. Ndërtim i kësaj dige ka rëndësi për mbrojtjen nga prurjet e mëdha të lumit si dhe menaxhimit më të mirë të ujërave në periudhat e prurjeve minimale;
  - b. **ta hartojë dhe dorëzojë në Ministri për aprovim studimin e prurjes së pranueshme ekologjike në pajtim me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm, për faktin se studimi i dërguar në Ministri nuk është konform Rregullores 02/2016 për PPE;**
  - c. **t`i instalojë matësit e prurjes mbi dhe nën profilin e veprave ujëmarrëse për të tri HC-et.** Matësit e prurjes duhet të mundësojnë regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave ashtu që në çdo kohë të mund të verifikohet dhe sigurohet prurja e pranueshme ekologjike në lumë;
  - d. **t`i rishikojë projektimin dhe monitorojë funksionimin e shtigjeve të peshqve dhe regjimit të aluvioneve** në të gjitha veprat ujëmarrëse për të tri HC-et;
  - e. **ta kryejë incizimin gjeodezik të shtratit të lumit dhe të i identifikojë të gjitha ndërhyrjet në regjimin e rrjedhjes së ujit** si rezultat i punimeve në skemat e HC-eve;
  - f. **të përpunojë strukturat e betonit (basenet e dekantimit) në mënyrë adekuate ashtu që të jenë në harmoni me peizazhin e natyrës** ku janë ndërtuar;
  - g. **të sigurojë pëlqim nga Ministria për shfrytëzimin e pronës ujore** ku janë ndërtuar hidrocentralet.

## 4.2 Hidrocentralet e kaskadës së Lepencit – “Sharri”, “Shtërpca”, “Brezovica” dhe “Viça”

### 4.2.1 HYRJE

Me Studimin e Para-fizibilitetit të vitit 2006 të financuar nga Ministria e Energjisë dhe Minierave (paraardhëse e Ministrisë së Ekonomisë) ishte paraparë që në Lumin Lepenc të ndërtohen 2 HC-e: (i) HC “Brezovica” me fuqi instaluese 2.1 MW dhe (ii) HC Lepenci me fuqi 3.5 MW.

Më pastaj, kompania Matkos Group sh.p.k., kishte aplikuar për ndërtimin e 4 HC-ve: HC “Sharri”, HC “Shtërpca”, HC “Brezovica” dhe HC “Viça”.

### 4.2.2 SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE ADMINISTRATIVE

HC “SHARRI”

#### a) Aktet ujore

**a.1 Kushtet Ujore**, lëshuar me aktvendimin nr. 5810/14–ZSP 632/2015, datë 15/06/2015 për Matkos Group sh.p.k. Prishtinë.

- Me kushte ujore është aprovuar kërkesa e palës për kushte ujore për ndërtimin e 3 HC-eve: “Sharri”, “Brezovica” dhe “Shtërpca” dhe i është kërkuar palës të bëhet aplikimi për secilin hidrocentral veç e veç.
- Kushtet ujore kanë përfshirë: (i) dokumentacionin e karakterit formal-juridik dhe pronëso-ro-juridik, (ii) përshkrimin gjeneral të projektit (gjeografik, gjeomorfologjik, hidrografik, meteorologjik, etj.), (iii) studimin hidrologjik, (iv) studimin e prurjes së pranueshme ekologjike, (v) përcaktimin e regjimit koncesional, dhe (vi) analizën e kosto-benefiteve.
- Afati për kompletimin dhe dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar me kushte ujore është përcaktuar 90 ditë. Dokumentacioni është kërkuar të dorëzohet në “3 kopje të forta dhe një kopje soft”.
- **Konkluzion** me nr. 5810-2/14-ZSP-780/2015 i lëshuar me datë 03/07/2015, i nënshkruar nga Sekretar i Përgjithshëm i MMPH në kërkesën e palës për pëlqim ujqor për 3 HC-et: “Sharri”, “Brezovica” dhe “Shtërpca”.
- Me këtë konkluzion i është kërkuar palës t’i plotësojë kushtet e cekura në kushtet ujore të numëruara si në pikën 4.1.1 më sipër. Në këtë konkluzion, theks i veçantë i është vënë pasaktësisë së prurjes mesatare të paraqitur në dokumentacionin e aplikuesit meqenëse të njëjtat dallojnë nga të dhënat e Master Planit për Ujëra të 1983.

**a.2 Pëlqimi ujqor** me nr. 5810-3/15, ZSP-1385/2015 i lëshuar më datë 2/11/2015, nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPH për HC “Brezovicë”.

- Me këtë pëlqim ujqor ‘është aprovuar kërkesa e palës’ për pëlqim ujqor lidhur me ndërtimin e hidrocentralit HC “Sharri” me kapacitet 6.453 MW në **pjesën e sipërme të lumit Lepenc (!)** në komunën e Shtërpces. Në këtë pëlqim ujqor janë përcaktuar nëntë kushte të numëruara në paragrafët 2.1 deri 2.9.
- Pëlqimi ujqor është lëshuar në bazë të “dokumentacionit investivo-teknik i cili **ruhet tek operatori Matkos Group**”.
- Ky pëlqim ujqor është lëshuar **pa i përmbushur asnjë prej kushteve ujore** të përcaktuara me aktvendimin e datës 15/06/2015, kushte këto të përsëritura me aktvendimin (Konkluzionin) e datës 3/07/2015. Mospërmbushja e kërkesave të përcaktuara me kushte ujore dhe me konkluzion është e evidente nga *Arsyetimi i*



*aktvendimit*, ku nuk është përfshirë asnjë prej dokumenteve të kërkuara me **Kushte Ujore** dhe **Konkluzionin** si bazë për lëshimin e **Pëlqimit Ujor** (as studimi hidrologjik, as studimi për prurjen e pranueshme ekologjike as përcaktimi i regjimit koncesional, as analiza e kosto-benefiteve).

- Pëlqimi ujor është lëshuar pas më shumë se 4 muajsh prej lëshimit të kushteve ujore – pra pasi ka tejkaluar afati prej 90 ditësh, i përcaktuar për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar me kushte ujore.

**a.3 Leja ujore** nr. 5475/20 e lëshuar më datë 09/02/2021, për Matkos Group, me rekomandimin e zyrtares përgjegjëse për leje ujore, përmes Sekretarit të Përgjithshëm, drejtorit të ARPL dhe udhëheqëses së Departamentit.

- Me leje ujore është kërkuar të realizohen strukturat e monitorimit kontinual të niveleve dhe prurjeve, mbi dhe poshtë profilin ujëmarrës ‘me të cilin realizohet prurja natyrore dhe prurja e pranueshme ekologjike’.
- Sipas lejes ujore pajisjet ujëmatëse duhet të vendosen me aprovimin e IHMK.
- Sipas lejes ujore, ‘e drejta ujore nuk paraqet të drejtën pronësore për palën apo shfrytëzimin e pronës për destinime tjera.’

Nga shqyrtimi i akteve ujore mund të konstatohet si vijon:

- 1) Nuk është zbatuar procedura e koncesionit për dhënien e të drejtës për shfrytëzim të ujit siç kërkohet me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 78).
- 2) Pëlqimi ujor është lëshuar pa i përmbushur asnjë prej kushteve ujore të përcaktuara me aktvendimin e datës 15/06/2015, kushte këto të përsëritura me aktvendimin (Konkluzionin) e datës 3/07/2015.
- 3) Pëlqimi ujor është lëshuar pasi ka tejkaluar afati prej 90 ditësh, i përcaktuar me aktvendimin për kushtet ujore (pas më shumë se 4 muajsh prej lëshimit të kushteve ujore).
- 4) Në leje ujore nuk ka të dhëna për veprat ujëmarrëse, lokacionin e tyre, tubacionet, prurjet ekologjike për secilën prej profileve ujëmarrëse, etj.
- 5) Leja ndërtimore për HC “Sharri” është lëshuar në pronë ujore, në afërsi të drejtpërdrejt të lumit, në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 48) që përcakton distancën prej minimum 30 metra për ndërtimin e objekteve nga vija e plotave (ujërat 100-vjeçare).
- 6) Në asnjërën prej profileve të veprave ujëmarrëse nuk ka matje të prurjes së ujit, siç kërkohet me kushte ujore dhe me leje ujore.
- 7) Dhënia në shfrytëzim e pronës ujore nga Komuna e Shtërpçës për Matkos Group me Vendim nr. 01-16-1623 i datës 03/06/2013 është në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 109, paragrafi 3).
- 8) Asnjë prej tri veprave ujëmarrëse nuk ka shtigjet e peshqve.

#### **b) Aktet mjedisore**

- (i) Pëlqimi mjedisor është lëshuar nga MMPH me nr. 14/371/1-337/DMM, datë, 09/09/2014 për të 4 HC-et e kaskadës së Lepencit: HC “Sharri”, HC “Brezovica”, HC “Shtërpca” (dhe i është kërkuar Matkos Group që të aplikojë për HC Viça).
- (ii) Traseja e HC Sharri është në zonën e II-të të mbrojtur të Parkut Kombëtar “Sharri” (në kundërshtim me nenin 3, paragrafin 2 të ligjit nr. 04L-087) por nuk posedon leje.
- (iii) Leja mjedisore nuk është lëshuar, por HC është duke operuar!

#### **c) Aktet ndërtimore**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GP ka konstatuar sa vijon:

- (i) **Leja ndërtimore** me nr. 351-6485 e lëshuar më datë 29/09/2015, për Matkos Group, nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Planifikim, Rindërtim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit të komunës së Shtërpcës;
- (ii) **Leja ndërtimore është lëshuar për objektin e Hidrocentralit** me sipërfaqe totale 947 m<sup>2</sup> në ngastrën 2374-0 e cila ngastër i është dhënë në shfrytëzim investitorit nga Komuna e Shtërpcës me datë 03/06/2013.
- (iii) **Certifikata e Përdorimit** me nr. 06-351/02-11207/20 i është lëshuar Matkos Group me datë 27/10/2020 për hidrocentralin me sipërfaqe P=194 m<sup>2</sup> nga Drejtori i Drejtorisë për Planifikimi, Rindërtim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit të komunës së Shtërpcës.

## HC “BREZOVICA”

### a) Aktet ujore

**a.1 Kushtet Ujore**, për Matkos Group sh.p.k. Prishtinë, janë lëshuar me vendimin nr. 5810/14–ZSP 632/2015, datë 15/06/2015 nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPH-së.

- Me kushte ujore është aprovuar kërkesa e palës për kushte ujore për ndërtimin e 3 HC-eve: “Sharri”, “Brezovica” dhe “Shtërpcë” dhe i është kërkuar palës të bëhet aplikimi për secilin hidrocentral veç e veç.
- Kushtet ujore kanë përfshirë: (i) dokumentacionin e karakterit formal-juridik dhe pronëso-ro-juridik, (ii) përshkrimin gjeneral të projektit (gjeografik, gjeomorfologjik, hidrografik, meteorologjik etj., (iii) studimin hidrologjik, (iv) studimin e prurjes së pranueshme ekologjike, (v) përcaktimin e regjimit koncesional, dhe (vi) analizën e kosto-benefiteve.
- Afati për kompletimin dhe dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar me kushte ujore është përcaktuar 90 ditë. Dokumentacioni është kërkuar të dorëzohet në “3 kopje të forta dhe një kopje soft”.
- **Konkluzion** me nr. 5810-2/14-ZSP-780/2015 i lëshuar me datë 03/07/2015, i nënshkruar nga Sekretar i Përgjithshëm i MMPH në kërkesën e palës për pëlqim ujo-r për 3 HC-et: “Sharri”, “Brezovica” dhe “Shtërpcë”.
- Me këtë konkluzion i është kërkuar palës t’i plotësojë kushtet e cekura në kushtet ujore të numëruara si në pikën 4.1.1 më sipër. Në këtë konkluzion, theks i veçantë i është vënë pasaktësisë së prurjes mesatare të paraqitur në dokumentacionin e aplikuesit meqenëse të njëjtat dallojnë nga të dhënat e Master Planit për Ujëra të 1983.

**a.2 Pëlqimi ujo-r** me nr. 5810-3/15, DU/2015 i lëshuar më datë 21/10/2015, i lëshuar më datë 2/11/2015, nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPH për HC “Brezovica”.

- Me këtë pëlqim ujo-r ‘është aprovuar kërkesa e palës’ për pëlqim ujo-r lidhur me ndërtimin e hidrocentralit HC “Brezovica” me kapacitet 2.01 MW në **pjesën e sipërme të lumit Lepenc** (!) në komunën e Shtërpcës. Në këtë pëlqim ujo-r janë përcaktuar nëntë kushte të numëruara në paragrafët 2.1 deri 2.9.
- Pëlqimi ujo-r është lëshuar në bazë të “dokumentacionit investivo-teknik i cili **ruhet tek operatori Matkos Group**”.
- Ky pëlqim ujo-r është lëshuar **pa i përmbushur asnjë prej kushteve ujore** të përcaktuara me aktvendimin e datës 15/06/2015, kushte këto të përsëritura me aktvendimin (Konkluzionin) e datës 3/07/2015. Mospërmbushja e kërkesave të përcaktuara me kushte ujore dhe me konkluzion është e evidente nga *Arsyetimi i aktvendimit*, ku nuk është përfshirë asnjë prej dokumenteve të kërkuara me **Kushte Ujore** dhe **Konkluzionin** si bazë për lëshimin e **Pëlqimit Ujo-r** (as studimi hidrologjik,



as studimi për prurjen e pranueshme ekologjike as përcaktimi i regjimit koncesional, as analiza e kosto-benefiteve).

- Pëlqimi uJOR është lëshuar **pas më shumë se 4 muajsh prej lëshimit të kushteve uJORE** – pra pasi ka tejkaluar afati prej 90 ditësh, i përcaktuar për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar me kushte uJORE.

**a.3 Leja uJORE** nr. 5784/18-ZSP/20 e lëshuar më datë 18/09/2020, për Matkos Group, me rekomandimin e zyrtares përgjegjëse për leje uJORE, përmes Sekretarit të Përgjithshëm, drejtorit të ARPL dhe udhëheqëses së Departamentit.

- Me leje uJORE është kërkuar të realizohen strukturat e monitorimit kontinual të niveleve dhe prurjeve, mbi dhe poshtë profilin ujëmarrës me të cilin realizohet prurja natyrore mbi profilin ujëmarrës dhe prurja e pranueshme ekologjike poshtë profilin ujëmarrës.
- Sipas lejes uJORE pajisjet ujëmatëse duhet të vendosen me aprovimin e IHMK.
- Afati i lejes uJORE është 20 vjet.
- Sipas lejes uJORE, e drejta uJORE nuk paraqet të drejtën pronësore për palën apo shfrytëzimin e pronës për destinime tjera.

Nga shqyrtimi i akteve uJORE mund të konstatohet si vijon:

- 1) Nuk është zbatuar procedura e koncesionit për dhënien e të drejtës për shfrytëzim të ujit siç kërkohet me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 78).
- 2) Pëlqimi uJOR është lëshuar pa i përmbushur asnjë prej kushteve uJORE të përcaktuara me aktvendimin e datës 15/06/2015, kushte këto të përsëritura me aktvendimin (Konkluzionin) e datës 3/07/2015.
- 3) Pëlqimi uJOR është lëshuar pasi ka tejkaluar afati prej 90 ditësh, i përcaktuar me aktvendimin për kushtet uJORE (pas më shumë se 4 muajsh prej lëshimit të kushteve uJORE).
- 4) Në leje uJORE nuk ka të dhëna për veprat ujëmarrëse, lokacionin e tyre, tubacionet, prurjet ekologjike për secilën prej profileve ujëmarrëse, etj.
- 5) Leja ndërtimore për HC "Brezovica" është lëshuar në pronë uJORE, në afërsi të drejtpërdrejt të lumit, në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 48) që përcakton distancën prej minimum 30 metra për ndërtimin e objekteve nga vija e plotave (ujërat 100-vjeçare).
- 6) Në asnjërën prej profileve të veprave ujëmarrëse nuk ka matje të prurjes së ujit, siç kërkohet me kushte uJORE dhe me leje uJORE.
- 7) Dhënia në shfrytëzim e pronës uJORE nga Komuna e Shtërpcës për Matkos Group me Vendim nr. 01-16-1623 i datës 03/06/2013 është në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 109, paragrafi 3).

#### **b) Aktet mjedisore**

- (i) Pëlqimi mjedisor është lëshuar nga MMPH me nr. 14/371/1-337/DMM, datë, 09/09/2014 për të 4 HC-et e kaskadës së Lepencit: HC "Sharri", HC "Brezovica", HC "Shtërpce" dhe HC "Viça" (kjo e fundit me plotësim të vendimit për pëlqim mjedisor).
- (ii) Pëlqimi mjedisor është lëshuar për ndërtimin e HC-ve gjeneruese përgjatë Lumit Lepenc Komuna e Shtërpcës pa i specifikuar ngastrat kadastrale.
- (iii) Edhe pse leja mjedisore nuk është lëshuar, HC është duke operuar!

#### **c) Aktet ndërtimore**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GP ka konstatuar sa vijon:

- (i) **Leja ndërtimore** me nr. 06-351-6483 e lëshuar më datë 29/07/2015, për Matkos Group, nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Planifikim, Rindërtim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit i komunës së Shtërpcës.
- (ii) Veprat marrëse për HC Shtërpca janë në zonën e II-të të mbrojtur të Parkut Kombëtar “Sharri” dhe janë **në kundërshtim me nenin 3, paragrafi 2 të ligjit 04L-087**.
- (iii) **Certifikata e përdorimit** me nr. 352-1957 i është lëshuar Matkos Group me datë 19/04/2017 për objektin e hidrocentralit në parcelën kadastrale që është pronë ujore me Nr. 6919-0, nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Planifikimi, Rindërtim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit të komunës së Shtërpcës.

## HC “SHTËRPCA”

### a) Aktet ujore

**a.1 Kushtet Ujore**, lëshuar me aktvendimin nr. lëshuar me aktvendimin nr. 5810/14–ZSP 632/2015, datë 15/06/2015 nga Sekretari i Përgjithshëm për Matkos Group sh.p.k. Prishtinë.

- Me kushte ujore është aprovuar kërkesa e palës për kushte ujore për ndërtimin e 3 HC-eve: “Sharri”, “Brezovica” dhe “Shtërpcë” dhe i është kërkuar palës të bëhet aplikimi për secilin hidrocentral veç e veç
- Kushtet ujore kanë përfshirë: (i) dokumentacionin e karakterit formal-juridik dhe pronëso-ro-juridik, (ii) përshkrimin gjeneral të projektit (gjeografik, gjeomorfologjik, hidrografik, meteorologjik etj.), (iii) studimin hidrologjik, (iv) studimin e prurjes së pranueshme ekologjike, (v) përcaktimin e regjimit koncesional, dhe (vi) analizën e kosto-benefiteve.
- Afati për kompletimin dhe dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar me kushte ujore është përcaktuar 90 ditë. Dokumentacioni është kërkuar të dorëzohet në “3 kopje të forta dhe një kopje soft”.
- **Konkluzion** me nr. 5810-2/14-ZSP-780/2015 i lëshuar me datë 03/07/2015, i nënshkruar nga Sekretar i Përgjithshëm i MMPH në kërkesën e palës për pëlqim ujur për 3 HC-et: “Sharri”, “Brezovica” dhe “Shtërpcë”.
- Me këtë konkluzion i është kërkuar palës t’i plotësojë kushtet e cekura në kushtet ujore të numëruara si në pikën 4.1.1 më sipër. Në këtë konkluzion, theks i veçantë i është vënë pasaktësisë së prurjes mesatare të paraqitur në dokumentacionin e aplikuesit meqenëse të njëjtat dallojnë nga të dhënat e Master Planit për Ujëra të 1983.

**a.2 Pëlqimi ujur** me nr. 5810-3/15, ZSP-1384/2015 i lëshuar më datë 2/11/2015, nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPH për HC “Shtërpca”.

- Me këtë pëlqim ujur ‘është aprovuar kërkesa e palës’ për pëlqim ujur lidhur me ndërtimin e hidrocentralit HC “Shtërpca” me kapacitet 5.031 MW në **pjesën e sipërme të lumit Lepenc** (!) në komunën e Shtërpcës. Në këtë pëlqim ujur janë përcaktuar nëntë kushte të numëruara në paragrafët 2.1 deri 2.9.
- Pëlqimi ujur është lëshuar në bazë të “dokumentacionit investivo-teknik i cili **ruhet tek operatori Matkos Group**”.
- Ky pëlqim ujur është lëshuar **pa i përmbushur asnjë prej kushteve ujore** të përcaktuara me aktvendimin e datës 15/06/2015, kushte këto të përsëritura me aktvendimin (Konkluzionin) e datës 3/07/2015. Mospërmbushja e kërkesave të përcaktuara me kushte ujore dhe me konkluzion është evidente nga *Arsyetimi i*

*aktvendimit*, ku nuk është përfshirë asnjë prej dokumenteve të kërkuara me **Kushte Ujore** dhe **Konkluzionin** si bazë për lëshimin e **Pëlqimit Ujor** (as studimi hidrologjik, as studimi për prurjen e pranueshme ekologjike as përcaktimi i regjimit koncesional, as analiza e kosto-benefiteve).

- Pëlqimi ujor është lëshuar **pas më shumë se 4 muajsh prej lëshimit të kushteve ujore** – pra pasi ka tejkaluar afati prej 90 ditësh, i përcaktuar për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar me kushte ujore.

**a.3 Leja ujore** nr. 102-2/21 e lëshuar më datë 9/02/2021, për Matkos Group, me rekomandimin e zyrtares përgjegjëse për leje ujore, përmes Sekretarit të Përgjithshëm, drejtorit të ARPL dhe udhëheqëses së Departamentit.

- Me leje ujore është kërkuar të realizohen strukturat e monitorimit kontinual të niveleve dhe prurjeve, mbi dhe poshtë profilin ujëmarrës me të cilin realizohet prurja natyrore mbi profilin ujëmarrës dhe prurja e pranueshme ekologjike poshtë profilin ujëmarrës’.
- Sipas lejes ujore pajisjet ujëmatëse duhet të vendosen me aprovimin e IHMK.
- Afati i lejes ujore është 20 vjet.
- Sipas lejes ujore, ‘e drejta ujore nuk paraqet të drejtën pronësore për palën apo shfrytëzimin e pronës për destinime tjera.

Nga shqyrtimi i akteve ujore mund të konstatohet si vijon:

- 1) Nuk është zbatuar procedura e koncesionit për dhënien e të drejtës për shfrytëzim të ujit siç kërkohet me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 78).
- 2) Pëlqimi ujor është lëshuar pa i përmbushur asnjë prej kushteve ujore të përcaktuara me aktvendimin e datës 15/06/2015, kushte këto të përsëritura me aktvendimin (Konkluzionin) e datës 3/07/2015.
- 3) Pëlqimi ujor është lëshuar pasi ka tejkaluar afati prej 90 ditësh, i përcaktuar me aktvendimin për kushtet ujore (pas më shumë se 4 muajsh prej lëshimit të kushteve ujore).
- 4) Në leje ujore nuk ka të dhëna për veprat ujëmarrëse, lokacionin e tyre, tubacionet, prurjet ekologjike për secilën prej profileve ujëmarrëse, etj.
- 5) Leja ndërtimore për HC “Shtërpca” është lëshuar në pronë ujore, në afërsi të drejtpërdrejt të lumit, në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 48) që përcakton distancën prej minimum 30 metra për ndërtimin e objekteve nga vija e plotave (ujërat 100-vjeçare).
- 6) Në asnjërën prej profileve të veprave ujëmarrëse nuk ka matje të prurjes së ujit, siç kërkohet me kushte ujore dhe me leje ujore.
- 7) Dhënia në shfrytëzim e pronës ujore në ngastrën nr. 6922-0 nga ana e komunës së Shtërpçës për Matkos Group me Vendim nr. 01-16-1623 i datës 03/06/2013 është në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 109, paragrafi 3).

#### **b) Aktet mjedisore**

- (i) Pëlqimi mjedisor është lëshuar nga MMPH me nr. 14/371/1-337/DMM, datë, 09/09/2014 për të 4 HC-et e kaskadës së Lepencit: HC “Sharri”, HC “Brezovica”, HC “Shtërpçe” dhe HC “Viça” (kjo e fundit me plotësim të vendimit për pëlqim mjedisor).
- (ii) Leja mjedisore nuk është lëshuar ende por HC është duke operuar!

#### **c) Aktet ndërtimore**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GP ka konstatuar sa vijon:

- (i) **Leja e ndërtimit** me nr. 06-351-6482 e lëshuar më datë 29/07/2015, për Matkos Group, nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Planifikim, Rindërtim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit i komunës së Shtërpçës për ndërtimin e hidrocentralit në ngastrën kadastrale 6922-0 e cila është pronë ujore.
- (ii) Veprat marrëse për HC Shtërpca janë në zonën e II-të të mbrojtur të parkut Kombëtar “Sharri” dhe janë **në kundërshtim me nenin 3, paragrafi 2 të ligjit 04L-087**.
- (iii) **Aneks leja e ndërtimit** nr. 06/351-02 – 12754/20 e lëshuar me 24/10/2020,
- (iv) **Certifikata e përdorimit** me nr. 06/351/02 – 13924/20 i është lëshuar për Matkos Group me datë 11/12/2020 për objektin e hidrocentralit në parcelën kadastrale që është pronë ujore me Nr. 6922-0, nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Planifikimi, Rindërtim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

#### HC “VIÇA”

##### a) Aktet ujore

**a.1 Kushtet Ujore** nuk janë lëshuar për HC “Viça”.

**a.2 Pëlqimi uxor**, me nr. lëshuar me aktvendimin nr. lëshuar me aktvendimin nr. 732-3/14-ZSP-335/216 i lëshuar më datë 07/03/2016 nga Sekretari i Përgjithshëm për Matkos Group sh.p.k. Prishtinë.

- Me këtë pëlqim uxor është aprovuar plotësimi i kushteve të “NDRYSHIM-VENDIMI-PËLQIM UJOR, Nr. 3449-2/14-ZSP-1178, datë 28.10.2014” dhe të Konkluzionit Nr. 732-4/14-ZSP-1175, datë 25.09.2015 lidhur me ndërtimin e HC “VIÇA” me kapacitet N=4.6 MW.
- Pëlqimi uxor është lëshuar në bazë të “dokumentacionit investivo-teknik i cili ruhet tek operatori Matkos Group”.
- Pëlqimi uxor ka përcaktuar (në pikën 4) se validiteti i tij pushon në rast të mosplotësimit të kushteve të përcaktuara me te. Plotësimi i këtyre kushteve nuk është afatizuar e as që është verifikuar ndonjëherë. Disa prej këtyre kushteve, p.sh. realizimi i strukturave të monitorimit kontinual të niveleve dhe prurjeve të ujit, janë kërkuar edhe pas 5 vitesh (me 2021) kur është lëshuar leja ujore, dhe nuk është përmbushur deri më sot (në datën e inspektimit).

**a.3 Leja ujore** nr. nr. 732-4/16 e lëshuar më datë 9/02/2021, për Matkos Group, me rekomandimin e zyrtares përgjegjëse për leje ujore, përmes Sekretarit të Përgjithshëm, drejtorit të ARPL dhe udhëheqëses së Departamentit.

- Me leje ujore është kërkuar të realizohen strukturat e monitorimit kontinual të niveleve dhe prurjeve, mbi dhe poshtë profilit ujëmarrës’ me të cilin realizohet prurja natyrore mbi profilin ujëmarrës dhe prurja e pranueshme ekologjike poshtë profilit ujëmarrës’.
- Sipas lejes ujore pajisjet ujëmatëse duhet të vendosen me aprovimin e IHMK.
- Afati i lejes ujore është 20 vjet.
- Sipas lejes ujore, ‘e drejta ujore nuk paraqet të drejtën pronësore për palën apo shfrytëzimin e pronës për destinime tjera.
- Shumica e formulimeve të lejes ujore janë të njëjta me ato të pëlqimit uxor: pika 1, pika 4, dhe pika 10.

- Në Arsyetimin e aktvendimit të lejes ujore thuhet se janë plotësuar kushtet e përcaktuara me pëlqim uJOR, gjë që NUK ËSHTË E SAKTË, në së paku dy pika: (i) matja e prurjes së ujit mbi dhe nën profilin e veprës ujëmarrëse nuk është realizuar ende, dhe (ii) nuk ka informacion se studimi i prurjes së pranueshme ekologjike është kompletuar dhe dorëzuar.

Nga shqyrtimi i akteve ujore mund të konstatohet si vijon:

- 1) Nuk është zbatuar procedura e koncesionit për dhënien e të drejtës për shfrytëzim të ujit siç kërkohet me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 78).
- 2) Pëlqimi uJOR është lëshuar pa i përmbushur asnjë prej kushteve ujore të përcaktuara me aktvendimin e datës 15/06/2015, kushte këto të përsëritura me aktvendimin (Konkluzionin) e datës 3/07/2015.
- 3) Pëlqimi uJOR është lëshuar pasi ka tejkaluar afati prej 90 ditësh, i përcaktuar me aktvendimin për kushtet ujore (pas më shumë se 4 muajsh prej lëshimit të kushteve ujore).
- 4) Në leje ujore nuk ka të dhëna për veprat ujëmarrëse, lokacionin e tyre, tubacionet, prurjet ekologjike për secilën prej profileve ujëmarrëse, etj.
- 5) Leja ndërtimore për HC “Viça” është lëshuar në pronë ujore, në afërsi të drejtpërdrejt të lumit, në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 48) që përcakton distancën prej minimum 30 metra për ndërtimin e objekteve nga vija e plotave (ujërat 100-vjeçare).
- 6) Në asnjërën prej profileve të veprave ujëmarrëse nuk ka matje të prurjes së ujit, siç kërkohet me kushte ujore dhe me leje ujore.
- 7) Dhënia në shfrytëzim e pronës ujore në ngastrën nr. 1373-0 nga Komuna e Shtërpçës për Matkos Group me Vendim nr. 06-351-2425 e lëshuar më datë 17/04/2014 është në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 109, paragrafi 3).
- 8) Duhet të verifikohet nëse ndërtesa e hidrocentralit Viça dhe objektet përcjellëse janë në zonën e paraparë për akumulacionin e Firajës që është pjesë e hidrosistemit Lepenci.

#### **b) Aktet mjedisore**

- (i) Pëlqimi mjedisor është lëshuar nga MMPH me nr. 14/371/1-337/DMM, datë, 09/09/2014 për të 4 HC-et e kaskadës së Lepencit: HC “Sharri”, HC “Brezovica”, HC “Shtërpçe” dhe HC “Viça” (kjo e fundit me plotësim të vendimit për pëlqim mjedisor).
- (ii) Leja mjedisore nuk është lëshuar ende por HC është duke operuar!

#### **c) Aktet ndërtimore**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GP ka konstatuar sa vijon:

- (i) Leja e ndërtimit me nr. 06-351-2425 e lëshuar më datë 17/04/2014, për Matkos Group, nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Planifikim, Rindërtim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit të komunës së Shtërpçës.
- (ii) Aneks leja e ndërtimit nr. 06/351/01 – 5510/20 e lëshuar me 24/10/2020.
- (iii) Certifikata e përdorimit me nr. 06/351/02–3340/20 i është lëshuar për Matkos Group me datë 11/03/2020 për objektin e hidrocentralit në parcelën kadastrale që është pronë ujore me Nr. 1373-0, nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Planifikim, Rindërtim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

### 4.2.3 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË RESURSET UJORE, MJEDIS DHE BILANCET EKONOMIKE

#### a) Skema e HC “Sharri”

- (i) Nuk ka shteg të peshqve në asnjërën prej veprave marrëse;
- (ii) Nuk ka matje të nivelit/prurjeve të ujit as para as pas veprave ujëmarrëse;
- (iii) Investitori nuk ka informacion se sa është prurja ekologjike që duhet të lëshohet në lumë;
- (iv) Traseja e tubacioneve shtrihet nëpër sipërfaqe publike;
- (v) Kalimi i tubacionit të ujit nëpër shtratin e lumit është realizuar në kundërshtim me normat teknike dhe paraqet barrierë për ujërat e mëdha;
- (vi) Strukturat e betonit në veprat ujëmarrëse janë në shpërputhje të plotë me peizazhin;
- (vii) Ndërtesa e hidrocentralit është në afërsi të drejtpërdrejtë të lumit – në pronën ujore.

#### b) Skema e HC “Shtërpce”

- (i) Shtigjet e peshqve janë punuar me improvizim në mënyrë joadekuate.
- (ii) Nuk ka matje të nivelit/prurjeve të ujit as para as pas veprave ujëmarrëse.
- (iii) Investitori nuk ka informacion se sa është prurja ekologjike që duhet të lëshohet në lumë.
- (iv) Traseja e tubacioneve shtrihet nëpër sipërfaqe publike.
- (v) Strukturat e betonit në veprat ujëmarrëse janë në shpërputhje të plotë me peizazhin.
- (vi) Ndërtesa e hidrocentralit është në afërsi të drejtpërdrejtë të lumit – në pronën ujore.

#### c) Skema e HC “Brezovica”

- (i) Nuk ka shteg të peshqve në asnjërën prej veprave marrëse.
- (ii) Traseja e tubacioneve shtrihet nëpër sipërfaqe publike.
- (iii) Nuk ka matje të nivelit/prurjeve të ujit as para as pas veprave ujëmarrëse.
- (iv) Investitori nuk ka informacion se sa është prurja ekologjike që duhet të lëshohet në lumë.
- (v) Strukturat e betonit në veprat ujëmarrëse janë në shpërputhje të plotë me peizazhin.
- (vi) Ndërtesa e hidrocentralit është në afërsi të drejtpërdrejtë të lumit – në pronën ujore.

#### d) Skema e HC “Viça”

- (i) Shtegu i peshqve jo në formë të plotë i definuar.
- (ii) Galeria prej veprës ujëmarrëse deri të baseni i dekantimit shtrihet në shtratin e lumit.
- (iii) Baseni i dekantimit nuk është i përfunduar ende.
- (iv) Ndërtesa e hidrocentralit është në afërsi të drejtpërdrejtë të lumit – në pronën ujore.



## 4.2.4 KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR HC-ET E KASKADËS SË LEPENCIT

### 4.2.4.1 Konkluzionet

- 1) Dhënia e të drejtës ujore me *leje ujore* e jo me *koncesion* përbën shkelje të Ligjit për Ujëra Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës të vitit 2-13 (neni 78, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2).
- 2) Pëlqimi uhor është lëshuar pa i përmbushur asnjë prej kushteve ujore të përcaktuara me aktvendimin e datës 15/06/2015 për kushte ujore, kushte këto të përsëritura me aktvendimin (Konkluzionin) e datës 3/07/2015.
- 3) Pëlqimi uhor është lëshuar pasi ka tejkaluar afati prej 90 ditësh, i përcaktuar me aktvendimin për kushtet ujore (pas më shumë se 4 muajsh prej lëshimit të kushteve ujore).
- 4) Në leje ujore nuk ka të dhëna për veprat ujëmarrëse, lokacionin e tyre, tubacionet, prurjet ekologjike për secilën prej profileve ujëmarrëse, etj.
- 5) Në asnjërën prej profileve të veprave ujëmarrëse nuk ka matje të prurjes së ujit, siç kërkohet me kushte ujore dhe me leje ujore.
- 6) Dhënia në shfrytëzim e pronës ujore në ngastrën nr. 6922-0 nga ana e komunës së Shtërpçës për Matkos Group me Vendim nr. 01-16-1623 i datës 03/06/2013 është në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 109, paragrafi 3).
- 7) Studimi i prurjes së pranueshme ekologjike (PPE) nuk ishte dorëzuar nga Matkos Group përkundër faktit se dorëzimi i këtij studimi është kusht i domosdoshëm për lëshimin e lejes ujore.
- 8) Lëshimi i vetëm një pëlqimi mjedisor për të katër HC-et: “Sharri”, “Shtërpca”, “Brezovica” dhe “Viça”, është në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit të VNM-së.
- 9) Ndërtesat e të katër HC-ve janë ndërtuar në pronë ujore në afërsi të drejtpërdrejt të lumit, në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 48) që përcakton distancën prej minimum 30 metra për ndërtimin e objekteve nga vija e plotave (ujërat 100-vjeçare).
- 10) Për asnjërin prej katër HC-eve nuk janë lëshuar lejet mjedisore por megjithatë të 4-tat janë në operim.

### 4.2.4.2 Rekomandimet

Bazuar në konkluzionet nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe gjetjet në terren rekomandohen që të ndërmerren veprimet si vijon:

- 1) **Shfuqizimin/Anulimin e** akteve administrative mbi bazën e shkeljeve të ligjeve materiale dhe procedurale – Ligji për Ujërat e Kosovës dhe akteve nënligjore të miratuara në pajtim me këtë ligj, Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligji për mbrojtjen e Natyrës, Ligji për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
- 2) Të zbatohet koncesioni si instrument i të drejtës ujore në pajtim me ligjin e ujërave përmes kontratës koncesionare duke marr parasysh gjendjen faktike të krijuar në terren, dhe të kërkohet nga investitori Matkos Group sh.p.k. që:
  - a. **ta hartojë studimin e prurjes së pranueshme ekologjike në pajtim me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm.** Studimi i prurjes së pranueshme ekologjike duhet të shqyrtohet dhe miratohet nga Ministria;
  - b. **t`i instalojë matësit e prurjes mbi dhe nën profilin e veprave ujëmarrëse për të tri HC-et.** Matësit e prurjes duhet të mundësojnë regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave ashtu që në çdo kohë të mund të verifikohet dhe sigurohet prurja e pranueshme ekologjike në lumë;

- c. **ta kompletojë projektimin dhe zbatimin e shtigjeve të peshqve dhe regjimit të aluvioneve** në të gjitha veprat ujëmarrëse për të tri HC-et;
- d. **ta kryejë incizimin gjeodezik të shtratit të lumit dhe të i identifikojë të gjitha ndërhyrjet në regjimin e rrjedhjes së ujit** si rezultat i punimeve në skemat e HC-eve;
- e. **të përpunojë strukturat e betonit (basenet e dekantimit) në mënyrë adekuate** ashtu që të jenë në harmoni me peizazhin e natyrës ku janë ndërtuar.
- f. **të sigurojë pëlqim nga Ministria për shfrytëzimin e pronës ujore** ku janë ndërtuar hidrocentralet.



## 4.3 Hidrocentralet e Brodit dhe Restelicës – “Restelica 1&2”, “Restelica 3”, “Brodi 1”, “Brodi 2”, dhe “Brodi 3”

### 4.3.1 SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE ADMINISTRATIVE

HC “RESTELICA 1 dhe 2”

#### a) Aktet ujore

**a.1 Leja ujore nr. 1782-2/11-ZSP-484/2013 e lëshuar më datë 20/06/2013, për HC “Restelica 1” me fuqi instaluese 1.2 MW për EUOKOS JH & Loreto Consult AG, përmes Sekretarit të Përgjithshëm.**

- **Leja ujore nr. 1782-2/11-ZSP-123/2012 për HC “Restelica 2” për EUOKOS JH & Loreto Consult AG, me fuqi instaluese 1.2 MW, është lëshuar pa u përmbushur kërkesat e kërkuara me UA për Leje Ujore siç janë: studimi hidrologjik, studimi i prurjes së pranueshme ekologjike, plani i veprimit etj., vetëm duke u bazuar në projektin kryesor!**
- Këto dy leje ujore janë identike në përmbajtje.
- Me leje ujore është kërkuar të realizohen strukturat e monitorimit kontinual të niveleve dhe prurjeve, mbi dhe poshtë profilin ujëmarrës ‘me të cilin realizohet prurja natyrore dhe prurja e pranueshme ekologjike’.
- Sipas lejes ujore të udhëhiqet ditari i punës mbi manipulimet, vrotimet etj.
- Sipas lejes ujore, ‘e drejta ujore nuk paraqet të drejtën pronësore për palën apo shfrytëzimin e pronës për destinime tjera.’

Nga shqyrtimi i akteve ujore mund të konstatohet si vijon:

- 1) Nuk është zbatuar procedura e koncesionit për dhënie të drejtës për shfrytëzim të ujit siç kërkohet me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 78).
- 2) Leja ujore për është lëshuar pa u përmbushur kërkesat e përcaktuara me UA për Leje Ujore i vitit 2005 (studimi hidrologjik, studimi i prurjes së pranueshme ekologjike, regjimi koncesional, etj.).
- 3) Në leje ujore nuk ka të dhëna për veprat ujëmarrëse, lokacionin e tyre, tubacionet, prurjet ekologjike për secilën prej profileve ujëmarrëse, etj.
- 4) Ndërtesa e hidrocentralit është ndërtuar në afërsi të drejtpërdrejt të lumit, që është në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 48 që përcakton distancën prej 30 metrash).
- 5) Në asnjërën prej profileve të veprave ujëmarrëse nuk ka matje të prurjes së ujit, siç kërkohet me kushte ujore dhe me leje ujore.
- 6) Dhënia në shfrytëzim e pronës ujore nga Komuna e Shtërpçës për EUOKOS JH & Loreto Consult AG, me Vendim nr. 01-16-1623 i datës 03/06/2013 është në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 109, paragrafi 3).
- 7) Asnjë prej veprave tri ujëmarrëse nuk ka shtigjet e peshqve.
- 8) Tubacionet (DN 1200mm) janë të vendosura në breg të lumit në gjatësi rreth (3500m), që bie në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit për Ujërat e Kosovës nr. 04/L-147.

#### b) Aktet mjedisore

- (i) Pëlqimi mjedisor është lëshuar nga MMPH me nr.1764/12 të datës: 26.06.2012.
- (ii) Në konkluzion nr. 859-2/2016 të datës: 22.03.2016 nuk janë cekur (tubacionet, veprat marrëse, etj.).

- (iii) PM është lëshuar për ndërtimin e HC-ve gjeneruese përgjatë Lumit Restelica Komuna e Dragashit pa i specifikuar ngastrat kadastrale.
- (iv) Sa i përket **lejes mjedisore**, e njëjta nuk është lëshuar ende – përkundër kësaj hidrocentrali operon që është në kundërshtim me nenin 31 të *Ligjit për Mbrojtje të Mjedisit* nr. 03/L-025.

**c) Aktet ndërtimore**

- (i) Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GP ka konstatuar Lejet ndërtimore dhe certifikatat e përdorimit i ka lëshuar Komuna e Dragashit në pajtim me Ligjin për Ndërtim.
- (ii) Traseja shtrihet përgjatë kufirit të zonës së I-rë dhe zonës së II-të, kurse vepra marrëse është në zonën e II-të të Parkut Kombëtar “Sharri” në kundërshtim me ligjin 04L-087, nenin 3, paragrafin 2

HC “RESTELICA 3”

**a) Aktet ujore**

**a.1 Leja ujore** nr. 1782-2/11-ZSP-486/2013 e lëshuar më datë 20/06/2013, për EUKOKOS JH, përmes Sekretarit të Përgjithshëm.

- Leja ujore për HC “Restelica” 3 me fuqi instaluese 1.498 MW, është lëshuar pa u përmbushur kërkesat e përcaktuara me kushtet ujore (studimi hidrologjik, studimi i prurjes së pranueshme ekologjike, regjimi koncesional, etj.), por vetëm bazuar në projektin kryesor!
- Leja ujore ka përmbajtjen standarde të aktvendimit të tillë të lëshuar gjatë viteve 2012-2013.
- Me leje ujore është kërkuar të realizohen strukturat e monitorimit kontinual të niveleve dhe prurjeve, mbi dhe poshtë profilin ujëmarrës me të cilin realizohet prurja natyrore mbi profilin ujëmarrës dhe prurja e pranueshme ekologjike poshtë profilin ujëmarrës’.
- Sipas lejes ujore pajisjet ujëmatëse duhet të vendosen me aprovimin e IHMK.
- Afati i lejes ujore është 20 vjet.
- Sipas lejes ujore, ‘e drejta ujore nuk paraqet të drejtën pronësore për palën apo shfrytëzimin e pronës për destinime tjera.

Nga shqyrtimi i akteve ujore mund të konstatohet si vijon:

- 1) Nuk është zbatuar procedura e koncesionit për dhënien e të drejtës për shfrytëzim të ujit siç kërkohet me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 78).
- 2) Leja ujore për është lëshuar pa u përmbushur kërkesat e përcaktuara me udhëzimin administrativ (studimi hidrologjik, studimi i prurjes së pranueshme ekologjike, regjimi koncesional, etj.).
- 3) Në leje ujore nuk ka të dhëna për veprat ujëmarrëse, lokacionin e tyre, tubacionet, prurjet ekologjike për secilën prej profileve ujëmarrëse, etj.
- 4) Ndërtesa e HC është ndërtuar në afërsi të drejtpërdrejt të lumit, që është në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 48 që përcakton distancën prej 30 metrash).

- 5) Në asnjërën prej profileve të veprave ujëmarrëse nuk ka matje të prurjes së ujit, siç kërkohet me kushte ujore dhe me leje ujore.

**b) Aktet mjedisore**

- (i) Pëlqimi mjedisor është lëshuar nga MMPH me nr. nr. 16/828/1-123/DMM, datë 20/04/2016 për të HC "Restelica 3". Në pëlqim mjedisor nuk janë cekur veprat ujëmarrëse dhe tubacionet.
- (ii) Sa i përket **lejes mjedisore**, e njëjta nuk është lëshuar ende – përkundër kësaj hidrocentrali operon që është në kundërshtim me nenin 31 të *Ligjit për Mbrojtje të Mjedisit* nr. 03/L-025.
- (iii) Njësia gjeneruese HC "Restelica 3" është në zonë e II-të të mbrojtur të Parkut Kombëtar "Sharr" në kundërshtim me ligjin 04L-087, nenin 3, paragrafin 2.

**c) Aktet ndërtimore**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GP ka konstatuar sa vijon:

- (i) **Leja ndërtimore** me nr. 351-23552 e lëshuar më datë 30/12/2016, për "EUROKOS J.H" vepra marrjes në ngastrat: 1145-1 Z.K Krushevë, tubacionet -1145-1; 385; Z.K Krushevë; 2812; 2283-1; 1205; 1206; 1210-1-Z.K Gllloboqicë-Elektrana Z.K 1304 Z.K Gllloboqicë - Dragash, nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër i komunës Dragash.
- (ii) **Certifikata e përdorimit** me nr. 350/04-1400/21i është lëshuar EUROKOS J.H me datë 29/01/2021, nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër i komunës Dragash.

HC "BRODI 1"

**a) Aktet ujore**

**a.1 Leja ujore** nr. 1782-2/11; më datë: 23.08.2012, për "Eurokos JH" me rekomandimin e zyrtares përgjegjëse për leje ujore, përmes Sekretarit të Përgjithshëm, drejtorit të Departamentit të Ujërave.

- Leja ujore për HC "Brodi 1" me kapacitet 1.06 MW, është lëshuar pa u përmbushur kërkesat e përcaktuara me kushtet ujore (studimi hidrologjik, studimi i prurjes së pranueshme ekologjike, regjimi koncesional, etj.), por vetëm bazuar në projektin kryesor!
- Me leje ujore është kërkuar të realizohen strukturat e monitorimit kontinual të niveleve dhe prurjeve, mbi dhe poshtë profilit ujëmarrës' me të cilin realizohet prurja natyrore mbi profilin ujëmarrës dhe prurja e pranueshme ekologjike poshtë profilit ujëmarrës'.
- Afati i lejes ujore është 20 vjet.
- Sipas lejes ujore, 'e drejta ujore nuk paraqet të drejtën pronësore për palën apo shfrytëzimin e pronës për destinime tjera.

Nga shqyrtimi i akteve ujore mund të konstatohet si vijon:

- 1) Dhënia e të drejtës ujore me leje ujore e jo me koncesion siç ishte përcaktuar me Ligjin për Ujëra nr. 2004/24 të vitit 2004 (neni 60, parag. 60.2, a) përbën shkelje të ligjit. Në nenin e njëjtë të këtij ligji është përcaktuar që 'shuma e realizuar nga kontrata e koncesionit derdhet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.'
- 2) Lëshimi i lejes ujore pa u plotësuar kushtet e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ në fuqi për leje ujore i vitit 2005 sa i përket përmbajtjes së aplikacionit mbi bazën e të cilit lëshohet leja ujore (neni 22 i UA) përbën shkelje ligjore. Lëshimi i lejes pa qenë i bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit relevant dhe kërkesa që ky dokumentacion të sigurohet në afat prej 90 ditësh PAS lëshimit të lejes ujore përbën

shkelje të UA për leje ujore (neni 22) dhe për më tepër është krejtësisht i pakuptimtë – lëshohet leja për shfrytëzim të ujit pa pasur idenë sa do të jetë sasia e ujit të shfrytëzuar, sa do të jetë prurja ekologjike, si do të matet sasia e ujit të shfrytëzuar dhe prurja ekologjike që duhet të lëshohet në lumë, cili është regjimi i aluvioneve etj.

- 3) Në leje ujore nuk ka të dhëna për veprat ujëmarrëse, lokacionin e tyre, tubacionet, prurjet ekologjike për secilën prej profileve ujëmarrëse, etj.
- 4) Ndërtesa e HC “Brodi 1” është ndërtuar në afërsi të drejtpërdrejt të lumit, që është në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 48 që përcakton distancën prej 30 metrash).
- 5) Në asnjërën prej profileve të veprave ujëmarrëse nuk ka matje të prurjes së ujit, siç kërkohet me kushte ujore dhe me leje ujore.

#### b) Aktet mjedisore

- (i) **Pëlqimi mjedisor** është lëshuar nga MMPH me nr. 11/1765.2-ZSP-128/12, datë, 26/06/2012 për HC- Brodi 1, përmes Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH.
- (ii) **Pëlqim mjedisor** është lëshuar nga MMPH me nr. 15/2302/1-255/DMM, datë: 18.08.2015 për HC-et Brodi 1; Brodi 3 dhe HC-Restelica 3, theksuar: për vazhdimin e vlefshmërisë të vendimeve të pëlqimeve mjedisore për HC-et: Brod 1, Brod 3, dhe Restelica 3.
- (iii) **Pëlqim mjedisor** është lëshuar nga MMPH me nr. 16/829/1-126/DMM, datë: 20/04/2016 për HC-et- Brodi 1 dhe Brodi 3, ku operatorit i jepet e drejta e operimit sipas përshkrimit të arsyeshmërisë (tekstit).
- (iv) Pëlqimi mjedisor është lëshuar për ndërtimin e HC-ve gjeneruese përgjatë Lumit Restelica Komuna e Dragashit **pa i specifikuar ngastrat kadastrale**.
- (v) Sa i përket **lejes mjedisore**, e njëjta nuk është lëshuar ende – përkundër kësaj hidrocentrali operon që është në kundërshtim me nenin 31 të Ligjit për Mbrojtje të Mjedisit nr. 03/L-025.

#### c) Aktet ndërtimore

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GP ka konstatuar sa vijon:

- (i) **Leja ndërtimore** me nr. 351-23553 e lëshuar më datë 30.12.2016, për “Eurokos JH”, nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit.
- (ii) Vepra marrës për HC “Brodi 1” është në zonë e II-të të mbrojtur të **Parkut Kombëtar “Sharri”** në kundërshtim me ligjin 04L-087, nenin 3, paragrafin 2.
- (iii) **Certifikata e përdorimit** me nr. 350/04-1257/20 i është lëshuar “Eurokos JH” me datë: 29/01/2021 për objektin e hidrocentralit në parcelat kadastrale -01360-0; 02118-0; 01360-0; 02109-1; 00546-0; 00553-0; 00556-0; 00555-0; 01340-0; 01337-0; 01341-0; 1339-0 Z.K Brod-K. Dragash, nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë, Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit.

#### HC “BRODI 2”

##### a) Aktet ujore

**a.1 Leja ujore** nr. 1782-2/11/DU/12; datë: 23.08.2012, për “Eurokos JH”, e lëshuar për HE-Brodi 2 përmes Sekretarit të Përgjithshëm nga drejtori i Departamentit të Ujërave.

- Leja ujore për HC “Brodi 2” në lumin Brod me kapacitet 1.25 MW, është lëshuar pa u përmbushur kërkesat e përcaktuara me kushtet ujore (studimi hidrologjik, studimi i prurjes së pranueshme ekologjike, regjimi koncesional, etj.), por vetëm bazuar në projektin kryesor!

- Me leje ujore është kërkuar të realizohen strukturat e monitorimit kontinual të niveleve dhe prurjeve, mbi dhe poshtë profilit ujëmarrës' me të cilin realizohet prurja natyrore mbi profilin ujëmarrës dhe prurja e pranueshme ekologjike poshtë profilit ujëmarrës'.
- Me leje ujore është kërkuar që 'me projekt kryesor të përcaktohet shtegu i migracionit të peshqve' në profilin ujëmarrës dhe strukturat e tij përcjellëse në harmoni me referencat për HC-et e vogla nga ESHA;
- Me leje ujore është kërkuar që para fillimit të punës të dorëzohet në Ministri Rregullorja e operimit dhe mirëmbajtjes së hidrocentralit si dhe plani i veprimit të hidrocentralit.
- Afati i lejes ujore është 20 vjet.
- Sipas lejes ujore, 'e drejta ujore nuk paraqet të drejtën pronësore për palën apo shfrytëzimin e pronës për destinime tjera.

Nga shqyrtimi i akteve ujore mund të konstatohet si vijon:

- 1) Dhënia e të drejtës ujore me leje ujore e jo me koncesion siç ishte përcaktuar me Ligjin për Ujëra nr. 2004/24 (neni 60, parag. 60.2, a) përbën shkelje të ligjit.
- 2) Lëshimi i lejes ujore pa u plotësuar kushtet e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ në fuqi për leje ujore i vitit 2005 sa i përket përmbytjes së aplikacionit mbi bazën e të cilit lëshohet leja ujore (neni 22 i UA) përbën shkelje ligjore. Lëshimi i lejes pa qenë i bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit relevant dhe kërkesa që ky dokumentacion të sigurohet në afat prej 90 ditësh PAS lëshimit të lejes ujore përbën shkelje të UA për leje ujore (neni 22) dhe për më tepër është krejtësisht i pakuptimtë – lëshohet leja për shfrytëzim të ujit pa pasur idenë sa do të jetë sasia e ujit të shfrytëzuar, sa do të jetë prurja ekologjike, si do të matet sasia e ujit të shfrytëzuar dhe prurja ekologjike që duhet të lëshohet në lumë, cili është regjimi i aluvioneve etj.
- 3) Në leje ujore nuk ka të dhëna për veprat ujëmarrëse, lokacionin e tyre, tubacionet, prurjet ekologjike për secilën prej profileve ujëmarrëse, etj.
- 4) Ndërtesa e HC "Brodi 2" është ndërtuar në afërsi të drejtpërdrejt të lumit, që është në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 48 që përcakton distancën prej 30 metrash).

#### b) Aktet mjedisore

- (i) Pëlqimi mjedisor është lëshuar nga MMPH me nr. 11/1765.2-ZSP-128/12, datë, 26/06/2012 për HC "Brodi 1", HC "Brodi 2" dhe HC "Brodi 3" përmes Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH.
- (ii) Lëshimi i një pëlqimi mjedisor për 3 HC-e është në kundërshtim me Ligjin për Vlerësim të Ndikimit në Mjedis.
- (iii) Sa i përket **lejes mjedisore**, e njëjta nuk është lëshuar ende - përkundër kësaj hidrocentrali operon në kundërshtim me nenin 31 të Ligjit për Mbrojtje të Mjedisit nr. 03/L-025.

#### c) Aktet ndërtimore

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GP ka konstatuar sa vijon:

- (i) **Leja ndërtimore** me nr. 351-1554 e lëshuar më datë 16.10.2013, për "Eurokos JH", nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit.
- (ii) **Certifikata e përdorimit** me nr. 400-2344 i është lëshuar "Eurokos JH" me datë: 30/07/2016 për objektin e hidrocentralit në parcelat kadastrale: 1235; 1217; 258 Z,K Dikance, dhe 1729; 1226; 1145; 738; 1145; 714 Z.K Mlikë, dhe 368 Z.K Baqke-

K.Dragash, nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë, Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit.

- (iii) **Aktvendim për vendosje të largpërçuesit** energjetik 35kw nga lokacioni i hidrocentralit Restelica 1 dhe 2, dhe vazhdon deri të lokacioni i hidrocentralit Brodi-2, lëshuar me nr. 351-5909, datë: 28.04.2015- nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit.

HC "BRODI 3"

**a) Aktet ujore**

**a.1 Leja ujore** nr. 1782-2/11/DU/12; date: 23.08.2012, për "Eurokos JH", e lëshuar për HC "Brodi 3" përmes Sekretarit të Përgjithshëm nga drejtori i Departamentit të Ujërave.

- Leja ujore për HC "Brodi 2" në lumin Brod me kapacitet 3.12 MW, është lëshuar pa u përmbushur kërkesat e përcaktuara me kushtet ujore (studimi hidrologjik, studimi i prurjes së pranueshme ekologjike, regjimi koncesional, etj.), por vetëm bazuar në projektin kryesor!
- Me leje ujore është kërkuar të realizohen strukturat e monitorimit kontinual të niveleve dhe prurjeve, mbi dhe poshtë profilin ujëmarrës me të cilin realizohet prurja natyrore mbi profilin ujëmarrës dhe prurja e pranueshme ekologjike poshtë profilin ujëmarrës'.
- Me leje ujore është kërkuar që 'me projekt kryesor të përcaktohet shtegu i migracionit të peshqve' në profilin ujëmarrës dhe strukturat e tij përcjellëse në harmoni me referencat për HC-et e vogla nga ESHA.
- Me leje ujore është kërkuar që para fillimit të punës të dorëzohet në Ministri Rregullorja e operimit dhe mirëmbajtjes së hidrocentralit si dhe plani i veprimit të hidrocentralit.
- Afati i lejes ujore është 20 vjet.
- Sipas lejes ujore, 'e drejta ujore nuk paraqet të drejtën pronësore për palën apo shfrytëzimin e pronës për destinime tjera.

**a.2. Ndryshim vendimi** me nr. 1782-2/11-ZSP-622, datë: 23/08/2012, për rritjen e fuqisë instaluese të HC nga N=3.12 MW në N=4.7 MW.

Nga shqyrtimi i akteve ujore mund të konstatohet si vijon:

- 1) Dhënia e të drejtës ujore me leje ujore e jo me koncesion siç ishte përcaktuar me Ligjin për Ujëra nr. 2004/24 të vitit 2004 (neni 60, paragrafi 60.2, a) përbën shkelje të ligjit. Në nenin e njëjtë të këtij ligji është përcaktuar që 'shuma e realizuar nga kontrata e koncesionit derdhet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.'
- 2) Lëshimi i lejes ujore pa u plotësuar kushtet e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ në fuqi për leje ujore i vitit 2005 sa i përket përmbytjes së aplikacionit mbi bazën e të cilit lëshohet leja ujore (neni 22 i UA) përbën shkelje ligjore. Lëshimi i lejes pa qenë i bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit relevant dhe kërkesa që ky dokumentacion të sigurohet në afat prej 90 ditësh PAS lëshimit të lejes ujore përbën shkelje të UA për leje ujore (neni 22) dhe për më tepër është krejtësisht i pakuptimtë – lëshohet leja për shfrytëzim të ujit pa pasur idenë sa do të jetë sasia e ujit të shfrytëzuar, sa do të jetë prurja ekologjike, si do të matet sasia e ujit të shfrytëzuar dhe prurja ekologjike që duhet të lëshohet në lumë, cili është regjimi i aluvioneve etj.
- 3) Në leje ujore nuk ka të dhëna për veprat ujëmarrëse, lokacionin e tyre, tubacionet, prurjet ekologjike për secilën prej profileve ujëmarrëse, etj.
- 4) Ndërtesa e HC "Brodi 3" është ndërtuar në afërsi të drejtpërdrejt të lumit, që është në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 48 që përcakton distancën prej 30 metrash).



**b) Aktet mjedisore**

- (i) Pëlqimi mjedisor është lëshuar nga MMPH me nr. 11/1765.2-ZSP-128/12, datë, 26/06/2012 për HC “Brodi 1”, HC “Brodi 2” dhe HC “Brodi 3” përmes Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH.
- (ii) Lëshimi i një pëlqimi mjedisor për 3 HC-e është në kundërshtim me Ligjin për Vlerësim të Ndikimit në Mjedis.
- (iii) Sa i përket **lejes mjedisore**, e njëjta nuk është lëshuar ende - përkundër kësaj hidrocentrali operon në kundërshtim me nenin 31 të Ligjit për Mbrojtje të Mjedisit nr. 03/L-025.

**c) Aktet ndërtimore**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GP ka konstatuar sa vijon:

- (i) **Leja ndërtimore** me nr. 351-19966 e lëshuar më datë 21.10.2016, për “Eurokos JH”, me ngastra nga Z.K Vraniq, dhe Z.K Ukujan, Komuna Dragash, nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit, Dragash.
- (ii) **Certifikata e përdorimit** me nr. 350/04-6323 i është lëshuar “Eurokos JH” me datë: 06/05/2019 me ngastra nga Z.K Vraniq, dhe Z.K Ukujan - Komuna Dragash, nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit.

#### 4.3.2 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË RESURSET UJORE, MJEDIS DHE BILANCET EKONOMIKE

**a) Skema e HC “Restelica 1 dhe 2”**

- (i) Nuk ka shteg të peshqve në asnjërën prej veprave marrëse.
- (ii) Nuk ka matje të nivelit/prurjeve të ujit as para as pas veprave ujëmarrëse.
- (iii) Investitori nuk ka informacion se sa është prurja ekologjike që duhet të lëshohet në lumë.
- (iv) Traseja e tubacioneve shtrihet nëpër sipërfaqe publike.
- (v) Kalimi i tubacionit të ujit nëpër shtratin e lumit është realizuar në kundërshtim me normat teknike dhe paraqet barrierë për ujërat e mëdha.
- (vi) Strukturat e betonit në veprat ujëmarrëse janë në shpërputhje të plotë me peizazhin.
- (vii) Ndërtesa e hidrocentralit është në afërsi të drejtpërdrejtë të lumit – në pronën ujore.
- (viii) Tek vepra marrëse e ujit ka mbeturina, zona nuk mirëmbahet si duhet, që bie në kundërshtim me kushtet e raportit të VNM-së.

**b) Skema e HC “Restelica 3”**

- (i) Shtigjet e peshqve janë punuar me improvizim në mënyrë joadekuate.
- (ii) Nuk ka matje të nivelit/prurjeve të ujit as para as pas veprave ujëmarrëse.
- (iii) Investitori nuk ka informacion se sa është prurja ekologjike që duhet të lëshohet në lumë.
- (iv) Traseja e tubacioneve shtrihet nëpër sipërfaqe publike.
- (v) Strukturat e betonit në veprat ujëmarrëse janë në shpërputhje të plotë me peizazhin.
- (vi) Ndërtesa e hidrocentralit është në afërsi të drejtpërdrejtë të lumit – në pronën ujore.



**c) Skema e HC “Brodi 1”**

- (i) Shtigjet e peshqve janë punuar me improvizim në mënyrë joadekuate.
- (ii) Nuk ka matje të nivelit/prurjeve të ujit as para as pas veprave ujëmarrëse.
- (iii) Investitori nuk ka informacion se sa është prurja ekologjike që duhet të lëshohet në lumë.
- (iv) Traseja e tubacioneve shtrihet nëpër sipërfaqe publike.
- (v) Strukturat e betonit në veprat ujëmarrëse janë në shpërputhje të plotë me peizazhin.
- (vi) Ndërtesa e hidrocentralit është në afërsi të drejtpërdrejtë të lumit – në pronën ujore.

**d) Skema e HC “Brodi 2”**

- (i) Shtigjet e peshqve janë punuar me improvizim në mënyrë joadekuate.
- (ii) Nuk ka matje të nivelit/prurjeve të ujit as para as pas veprave ujëmarrëse.
- (iii) Investitori nuk ka informacion se sa është prurja ekologjike që duhet të lëshohet në lumë.
- (iv) Traseja e tubacioneve shtrihet nëpër sipërfaqe publike.
- (v) Strukturat e betonit në veprat ujëmarrëse janë në shpërputhje të plotë me peizazhin.
- (vi) Ndërtesa e hidrocentralit është në afërsi të drejtpërdrejtë të lumit – në pronën ujore.

**e) Skema e HC “Brodi 3”**

- (i) Shtigjet e peshqve janë punuar me improvizim në mënyrë joadekuate.
- (ii) Nuk ka matje të nivelit/prurjeve të ujit as para as pas veprave ujëmarrëse.
- (iii) Investitori nuk ka informacion se sa është prurja ekologjike që duhet të lëshohet në lumë.
- (iv) Traseja e tubacioneve shtrihet nëpër sipërfaqe publike.
- (v) Strukturat e betonit në veprat ujëmarrëse janë në shpërputhje të plotë me peizazhin.
- (vi) Ndërtesa e hidrocentralit është në afërsi të drejtpërdrejtë të lumit – në pronën ujore.

**4.3.3 KONKLuzionet dhe Rekomandimet për HC-et e Eurokos JH****4.3.3.1 Konkluzionet**

- 1) Dhënia e të drejtës ujore me *leje ujore* e jo me *koncesion* përbën shkelje të Ligjit për Ujëra Nr. 2004/24 për Ujërat e Kosovës të vitit 2004 (neni 60).
- 2) Lëshimi i lejeve ujore pa u plotësuar kushtet e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ në fuqi për leje ujore i vitit 2005 sa i përket përmbajtjes së aplikacionit mbi bazën e të cilit lëshohet leja ujore (neni 22 i UA) përbën shkelje ligjore.
- 3) Në leje ujore nuk ka të dhëna për veprat ujëmarrëse, lokacionin e tyre, tubacionet, prurjet ekologjike për secilën prej profileve ujëmarrëse, etj.
- 4) Ndërtesat e HC-ve janë ndërtuar në afërsi të drejtpërdrejtë të lumit, që është në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 48) që përcakton distancën prej 30 metrash.
- 5) Në asnjërën prej profileve të veprave ujëmarrëse nuk ka matje të prurjes së ujit, siç kërkohet me kushte ujore dhe me leje ujore.
- 6) Dhënia në shfrytëzim e pronës ujore në ngastrën nr. 6922-0 nga ana e komunës së është në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 109, paragrafi 3).

- 7) Lëshimi i vetëm një pëlqimi mjedisor për 3 HC-et: “Brodi 1”, “Brodi 2”, dhe “Brodi 3” është në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit të VNM-së.
- 8) Për asnjërin prej katër HC-eve nuk janë lëshuar lejet mjedisore.

#### 4.3.3.2 Rekomandimet

Bazuar në konkluzionet nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe gjetjet në terren rekomandohen që të ndërmerren veprimet si vijon:

- 1) **Shfuqizimin/Anulimin e** akteve administrative mbi bazën e shkeljeve të ligjeve materiale dhe procedurale – Ligji për Ujërat e Kosovës dhe akteve nënligjore të miratuara në pajtim me këtë ligj, Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligji për mbrojtjen e Natyrës, Ligji për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
- 2) Të zbatohet koncesioni si instrument i të drejtës ujore në pajtim me ligjin e ujërave përmes kontratës koncesionare duke marr parasysh gjendjen faktike të krijuar në terren dhe **të kërkohet nga investitori EUOKOS JH që:**
  - a. **ta hartojë studimin e prurjes së pranueshme ekologjike në pajtim me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm.** Studimi i prurjes së pranueshme ekologjike duhet të shqyrtohet dhe miratohet nga Ministria;
  - b. **t`i instalojë matësit e prurjes mbi dhe nën profilin e veprave ujëmarrëse për të gjitha pesë HC-et.** Matësit e prurjes duhet të mundësojnë regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave ashtu që në çdo kohë të mund të verifikohet dhe sigurohet prurja e pranueshme ekologjike në lumë;
  - c. **ta kompletojë projektimin dhe zbatimin e shtigjeve të peshqve dhe regjimit të aluvioneve** në të gjitha veprat ujëmarrëse për të tri HC-et;
  - d. **ta kryejë incizimin gjeodezik të shtratit të lumit dhe të i identifikojë të gjitha ndërhyrjet në regjimin e rrjedhjes së ujit** si rezultat i punimeve në skemat e HC-eve;
  - e. **të përpunojë strukturat e betonit (basenet e dekantimit) në mënyrë adekuate** ashtu që të jenë në harmoni me peizazhin e natyrës ku janë ndërtuar.
  - f. **të sigurojë pëlqim nga Ministria për shfrytëzimin e pronës ujore** ku janë ndërtuar hidrocentralet.

## 4.4 Hidrocentralet e Lumit Plavë dhe Lumit Radeshë – “Orçusha” dhe “Dragash”

### 4.4.1 SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE ADMINISTRATIVE

HC “ORQUSHA”

#### a) Aktet ujore

**a.1 Kushtet Ujore**, lëshuar me aktvendimin nr. 2298-2/15, datë 14/09/2015 (data e protokolit 22.09.2015) për Renelual Tahiri sh.p.k. Prishtinë.

- Me kushte ujore i është kërkuar palës sigurimi dhe sjellja e pëlqimit mjedisor dhe sigurim dhe sjellja e vendimit për autorizimin nga kapaciteti 2.2 MW në 4 MW, me datë 14.06.2016.

**a.2 Pëlqimi ujqor** me nr. 2298-2/16 i lëshuar më datë 03/06/2016, nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPH për HC “Orçushë”.

- Me këtë pëlqim ujqor është aprovuar kërkesa e palës për pëlqim ujqor lidhur me ndërtimin e hidrocentralit HC “Orçusha” me kapacitet **4.0 MW** në lumin Plava në komunën e Dragashit.
- Në këtë pëlqim ujqor janë përcaktuar nëntë kushte të numëruara në paragrafët 2.1 deri 2.9.
- Pëlqimi ujqor është lëshuar në bazë të “dokumentacionit investivo-teknik i cili ruhet tek operatori “Renelual Tahiri”.

**a.3 Leja ujore** nr. 6113/19-ZSP-2020 e lëshuar më datë 17.09.2020, për HC “Orçushë”, me rekomandimin e zyrtares përgjegjëse për leje ujore, përmes Sekretarit të Përgjithshëm si dhe drejtorit të ARPL dhe udhëheqëses së DMRU.

- Me leje ujore është kërkuar të realizohen strukturat e monitorimit kontinual të niveleve dhe prurjeve, mbi dhe poshtë profilit ujëmarrës ‘me të cilin realizohet prurja natyrore dhe prurja e pranueshme ekologjike’.
- Sipas lejes ujore të udhëhiqet ditari i punës mbi manipulimet, vrojtimet etj.
- Sipas lejes ujore, ‘e drejta ujore nuk paraqet të drejtën pronësore për palën apo shfrytëzimin e pronës për destinime tjera.’

Nga shqyrtimi i akteve ujore mund të konstatohet si vijon:

- 1) Nuk është zbatuar procedura e koncesionit për dhënien e të drejtës për shfrytëzim të ujit siç kërkohet me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 78).
- 2) Pëlqimi ujqor është lëshuar pa i përmbushur asnjë prej kushteve ujore të përcaktuara me aktvendimin e datës 15/06/2015, kushte këto të përsëritura me aktvendimin
- 3) Në leje ujore nuk ka të dhëna për veprat ujëmarrëse, lokacionin e tyre, tubacionet, prurjet ekologjike për secilën prej profileve ujëmarrëse, etj.
- 4) Ndërtesa e HC “Orçusha” është ndërtuar në afërsi të drejtpërdrejt të lumit, që është në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 48 që përcakton distancën prej 30 metrash).
- 5) Në asnjërën prej profileve të veprave ujëmarrëse nuk ka matje të prurjes së ujit, siç kërkohet me kushte ujore dhe me leje ujore.

**b) Aktet mjedisore**

- (i) **Refuzim i Pëlqimit mjedisor** nr. 6093/16, datë: 05.02.2016 është lëshuar për operatorin NPN "Renelual Tahiri" sh.p.k. – për ndërtimin e HC "Orçushë" dhe "Rapçë" nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPH.
- (ii) **Pëlqim mjedisor** nr. 16/898/1-ZSP-69/16 datë 20.04.2016, i lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPH. Ky pëlqim mjedisor është pa ngastra.
- (iii) **Korrigjimi i vendimit të pëlqimit mjedisor** nr. protokollit 6830-2/19 të datës: 29.11.2019 duke u bazuar në vendimin e pëlqimit mjedisor 16/898/1-ZSP-69/16 të datës: 20.04.2016 për ndërtimin e HC "Orçusha" në lumin e Plavës, Komuna e Dragashit. Në këtë vendim janë përfshirë ngastrat kadastrale nr. P-70604030-00832-0 traseja ngastra kadastrale nr. P-70604030-00832-0, ndërtesa e hidrocentralit ngastra kadastrale nr. P-70604030-00832-0.
- (iv) HC "Orçusha" **nuk ka leje mjedisore** – por megjithatë operon pa të në kundërshtim me nenin 31 të Ligjit për Mbrojtje të Mjedisit nr. 03/L-025.

**c) Aktet ndërtimore**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GP ka konstatuar sa vijon:

- (i) **Leja ndërtimore** me nr. 351/01-14000 e lëshuar më datë 10/02/2017, për "Renelual Tahiri" sh.p.k. për HC "Orçushë", nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër, Komuna Dragash.
- (ii) **Leja ndërtimore** është lëshuar për objektin e HC "Orçusha", Komuna Dragash me gjatësi të tubacionit në ngastrat: 00012-0; 00832-0; 00010-0, vepra e marrjes në ngastrat: 0001-1; 00832-0 Z.K Orçushë; objekti hidrocentrali në ngastrat: 00012-0; 00013-0 Z.K Orçushë-Dragash, shkarkimi i ujit në ngastrat: 00012-0; 00013-0; 00832-0.
- (iii) **Certifikata e përdorimit** me nr. 350/04-3700; datë: 13.12.2016 është lëshuar për "Renelual Tahiri" SH.P.K për HC "Orçusha" nga Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër, Komuna Dragash.

## HC "DRAGASH"

**a) Aktet ujore**

**a.1 Kushtet Ujore**, lëshuar me aktvendimin nr. 2297/15-ZSP-1143/15 datë 14/09/2015.

**a.2 Pëlqimi ujqor** me nr. 2297-2/16 i lëshuar më datë 03/06/2016, nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPH për HC "Dragash".

- Me këtë pëlqim ujqor është aprovuar kërkesa e palës për pëlqim ujqor lidhur me ndërtimin e hidrocentralit HC "Dragash" me kapacitet 3.425 MW në lumin Plava dhe Radesha në Komunën e Dragashit.
- Në këtë pëlqim ujqor janë përcaktuar nëntë kushte të numëruara në paragrafët 2.1 deri 2.9.
- Pëlqimi ujqor është lëshuar në bazë të "dokumentacionit investivo-teknik i cili ruhet tek operatori "Renelual Tahiri".

**a.3 Leja ujore** me nr. protok. 572-2.2021 datë 18.03.2021 për HC "Dragash" me fuqi instaluese **3.5 MW**.

Nga shqyrtimi i akteve ujore mund të konstatohet si vijon:

- 1) Nuk është zbatuar procedura e koncesionit për dhënien e të drejtës për shfrytëzim të ujit siç kërkohet me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 78).

- 2) Ndërtesa e HC "Dragashi" është ndërtuar në afërsi të drejtpërdrejt të lumit, që është në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 48 që përcakton distancën prej 30 metrash).
- 3) Në asnjërën prej profileve të veprave ujëmarrëse nuk ka matje të prurjes së ujit, siç kërkohet me kushte ujore dhe me leje ujore.

**b) Aktet mjedisore**

- (i) **Pëlqimi mjedisor** është lëshuar nga MMPH me nr. 15/5773/1-608/DMM datë 21.12.2015, përmes Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH, me të cilin është aprovuar kërkesa e kompanisë "Renelual Tahiri" sh.p.k. për pëlqim mjedisor për ndërtimin e HC "Dragashi" në lumin e Plavës dhe Radeshit, Komuna e Dragashit.
- (ii) Leja mjedisore për HC "Dragashi" nuk është lëshuar ende – përkundër kësaj, ky HC tashmë është në operim në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit.

**c) Aktet ndërtimore**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GP ka konstatuar sa vijon:

- (i) **Leja ndërtimore** me nr. 06 351/1-8217 e lëshuar më datë 30/06/2017, për Renelual Tahiri sh.p.k. e nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Planifikim, Rindërtim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit i Komunës së Dragashit.
- (ii) **Certifikata e përdorimit** me nr. 350/04-1615, datë: 16/02/2021 me datë për objektin e hidrocentralit nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Planifikim, Rindërtim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit të Komunës së Dragashit.

#### 4.4.2 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË RESURSET UJORE, MJEDIS DHE BILANCET EKONOMIKE

**a) Skema e HC "Orçusha"**

- (i) Nuk ka matje të nivelit/prurjeve të ujit as para as pas veprave ujëmarrëse.
- (ii) Investitori nuk ka informacion se sa është PPE që duhet të lëshohet në lumë.
- (iii) Traseja e tubacioneve shtrihet nëpër sipërfaqe publike.
- (iv) Strukturat e betonit në veprat ujëmarrëse janë në shpërputhje të plotë me peizazhin.
- (v) Ndërtesa e hidrocentralit është në afërsi të drejtpërdrejtë të lumit – në pronën ujore.

**b) Skema e HC "Dragash"**

- (i) Nuk ka matje të nivelit/prurjeve të ujit as para as pas veprave ujëmarrëse.
- (ii) Investitori nuk ka informacion sa është PPE që duhet të lëshohet në lumë.
- (iii) Traseja e tubacioneve shtrihet nëpër sipërfaqe publike.
- (iv) Strukturat e betonit në veprat ujëmarrëse janë në shpërputhje të plotë me peizazhin.
- (v) Ndërtesa e hidrocentralit është në afërsi të drejtpërdrejtë të lumit – në pronën ujore.

#### 4.4.3 KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR HC-ET E KASKADËS SË LEPENCIT

**4.4.3.1 Konkluzionet**

- 1) Dhënia e të drejtës ujore me *leje ujore* e jo me *koncesion* përbën shkelje të Ligjit për Ujëra Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës të vitit 2-13 (neni 78, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2).

- 2) Në leje ujore nuk ka të dhëna për veprat ujëmarrëse, lokacionin e tyre, tubacionet, prurjet ekologjike për secilën prej profileve ujëmarrëse, etj.
- 3) Leja ndërtimore për HC-et është lëshuar në pronë ujore, në afërsi të drejtpërdrejt të lumit, në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 48) që përcakton distancën prej minimum 30 metra për ndërtimin e objekteve nga vija e plotave (ujërat 100-vjeçare).
- 4) Në projekte dhe raporte profesionale për leje ujore nuk janë dhënë të dhënat për hartuesin e projektit.
- 5) Për asnjërin prej katër HC-eve nuk janë lëshuar lejet mjedisore, por HC-të janë duke operuar.

#### 4.4.3.2 Rekomandimet

Bazuar në konkluzionet nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe gjetjet në terren rekomandohen që të ndërmerren veprimet si vijon:

- 1) **Shfuqizimin/Anulimin e** akteve administrative mbi bazën e shkeljeve të ligjeve materiale dhe procedurale – Ligji për Ujërat e Kosovës dhe akteve nënligjore të miratuara në pajtim me këtë ligj, Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligji për mbrojtjen e Natyrës, Ligji për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
- 2) Të zbatohet koncesioni si instrument i të drejtës ujore në pajtim me ligjin e ujërave përmes kontratës koncesionare duke marr parasysh gjendjen faktike të krijuar në terren, dhe **të kërkohet nga investitori Renelual Tahiri sh.p.k. që:**
  - a. **t`i instalojë matësit e prurjes mbi dhe nën profilin e veprave ujëmarrëse për të dy HC-et.** Matësit e prurjes duhet të mundësojnë regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave ashtu që në çdo kohë të mund të verifikohet dhe sigurohet prurja e pranueshme ekologjike në lumë;
  - b. **ta kompletojë projektimin dhe zbatimin e shtigjeve të peshqve dhe regjimit të aluvioneve** në të gjitha veprat ujëmarrëse për të dy HC-et;
  - c. **ta kryejë incizimin gjeodezik të shtratit të lumit dhe të i identifikojë të gjitha ndërhyrjet në regjimin e rrjedhjes së ujit** si rezultat i punimeve në skemat e HC-eve;
  - d. **të përpunojë strukturat e betonit (basenet e dekantimit) në mënyrë adekuate** ashtu që të jenë në harmoni me peizazhin e natyrës ku janë ndërtuar.
  - e. **të sigurojë pëlqim nga Ministria për shfrytëzimin e pronës ujore** ku janë ndërtuar hidrocentralet.

## 4.5 Hidrocentralet në Lumin Bistricë – “Albanik 2”, “Albanik 3”, dhe “Albanik 4”

### 4.5.1 SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE ADMINISTRATIVE

HC “ALBANIKU 1”

#### a) Aktet ujore

**a.1 Leja ujore** nr. 1326/13-ZSP-DU/2013 e lëshuar më datë 02.10.2013, për HC “Albaniku 2” për operatorin Hydro Line, përmes Sekretarit të Përgjithshëm, me rekomandim të drejtorit të Departamentit të Ujërave.

- Me leje ujore është kërkuar të realizohen strukturat e monitorimit kontinual të niveleve dhe prurjeve, mbi dhe poshtë profilin ujëmarrës ‘me të cilin realizohet prurja natyrore dhe prurja e pranueshme ekologjike’.
- Sipas lejes ujore të udhëhiqet ditari i punës mbi manipulimet, vrotimet etj.
- Sipas lejes ujore, ‘e drejta ujore nuk paraqet të drejtën pronësore për palën apo shfrytëzimin e pronës për destinime tjera.

Nga shqyrtimi i akteve ujore mund të konstatohet si vijon:

- 1) Nuk është zbatuar procedura e koncesionit për dhënien e të drejtës për shfrytëzim të ujit siç kërkohet me Ligjin për Ujërat e Kosovës.
- 2) Në leje ujore nuk ka të dhëna për veprat ujëmarrëse, lokacionin e tyre, tubacionet, prurjet ekologjike për secilën prej profileve ujëmarrëse, etj.
- 3) Leja ndërtimore për HC “Albaniku 2” është lëshuar në pronë ujore, në afërsi të drejtpërdrejt të lumit, në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 48) që përcakton distancën prej minimum 30 metra për ndërtimin e objekteve nga vija e plotave (ujërat 100-vjeçare).
- 4) Në asnjërën prej profileve të veprave ujëmarrëse nuk ka matje të prurjes së ujit, siç kërkohet me kushte ujore dhe me leje ujore.

#### b) Aktet mjedisore

- (i) **Pëlqimit mjedisor** nr. 13/1284/2-164/DMM datë: 19/08/2013 është lëshuar për operatorin “Hydro Line” SH.P.K, për ndërtimin e hidrocentraleve përgjatë lumit Bistricë në Komunën e Mitrovicë nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPH.
- (ii) Pëlqimi mjedisor është lëshuar për të gjitha HC-et duke qenë kështu në kundërshtim me Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
- (iii) **Leja mjedisore** nuk është lëshuar ende – përkundër kësaj, HC është në funksion në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtje të Mjedisit (nenin 31).

#### c) Aktet ndërtimore

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GP ka konstatuar sa vijon:

- (i) **Leja ndërtimore** me nr. 08-351-86288 e lëshuar më datë 08/10/2015, për “Hydro-Line” sh.p.k., për HC “Albaniku 2”, përmes drejtorit të Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm, Komuna Mitrovicë. Leja ndërtimore është lëshuar për objektin e HC “Albaniku 2” në ngastrën kadastrale 010-0.
- (ii) **Certifikata e përdorimit** me nr. 08-351/02-0111619/19; datë: 16/01/2020, është lëshuar për: “Hydro Line” sh.p.k. për HC “Albaniku 2” përmes drejtorit të Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm, Komuna Mitrovicë.



## HC "ALBANIKU 3"

**a) Aktet ujore**

**a.1 Leja ujore** nr. 3986/20-ZSP-2020 e lëshuar më datë 13/11/2020, për HC "Albaniku 3", nga zyrtarja për leje ujore e Ministrisë, përmes Sekretarit të Përgjithshëm, Drejtorit të ARPL-së, dhe Udhëheqëses së Departamentit.

- Me leje ujore është kërkuar të realizohen strukturat e monitorimit kontinual të niveleve dhe prurjeve, mbi dhe poshtë profilin ujëmarrës 'me të cilin realizohet prurja natyrore dhe prurja e pranueshme ekologjike'.
- Leja Ujore lëshohet në periudhë kohore 20 (njëzet) vjet.
- Sipas lejes ujore, 'e drejta ujore nuk paraqet të drejtën pronësore për palën apo shfrytëzimin e pronës për destinime tjera.'

Nga shqyrtimi i akteve ujore mund të konstatohet si vijon:

- 1) Nuk është zbatuar procedura e koncesionit për dhënien e të drejtës për shfrytëzim të ujit siç kërkohet me Ligjin për Ujërat e Kosovës.
- 2) Në leje ujore nuk ka të dhëna për veprat ujëmarrëse, lokacionin e tyre, tubacionet, prurjet ekologjike për secilën prej profileve ujëmarrëse, etj.
- 3) Ndërtesa e HC "Albaniku 3" është ndërtuar në afërsi të drejtpërdrejt të lumit, që është në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës nr. 04/L-147 (neni 48 që përcakton distancën prej 30 metrash).
- 4) Në asnjërën prej profileve të veprave ujëmarrëse nuk ka matje të prurjes së ujit, siç kërkohet me kushte ujore dhe me leje ujore.

**b) Aktet mjedisore**

- (i) **Pëlqimi mjedisor** nr. 13/1284/2-164/DMM datë: 19/08/2013 është lëshuar për operatorin "Hydro Line" SH.P.K, për ndërtimin e hidrocentraleve përgjatë lumit Bistricë në komunën e Mitrovicë nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPH. Pëlqimi mjedisor është lëshuar për të gjitha HC-et duke qenë kështu në kundërshtim me Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
- (ii) **Leja mjedisore** me nr.20/822/MEA, lëshuar më datë 10/03/2021, nga Sekretar i Përgjithshëm i MEA-së (paraardhëse e MMPHI). Kjo leje është lëshuar me kushtet:
  - Të respektohet prurja e pranueshme ekologjike në përputhje me lejen ujore për shfrytëzim të ujit, si dhe aktet nënligjore nga Ligji për Ujërat.
  - T'i përmbahet të dhënave të përshkruara në aplikacionin e ri-plotësuar, të ketë personin e profilin inxhinierik.
  - Pas përfundimit të veprimtarisë, operatori është i obliguar ta kthej lokacionin në gjendje të mëparshme.

**c) Aktet ndërtimore**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GP ka konstatuar sa vijon:

- (i) **Leja ndërtimore** me nr. 08-351-26423 e lëshuar më datë 17/10/2013, për "Hydro-Line" sh.p.k., për HC "Albaniku 3", përmes drejtorit të Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm, Komuna Mitrovicë.
- (ii) **Leja ndërtimore** është lëshuar për objektin e HC "Albaniku 3" në ngastrën kadastrale 127-0.
- (iii) **Certifikata e përdorimit** me nr. 08-351/01-0009706/17; datë: 13.02.2017 është lëshuar për objektin ekonomik, nga drejtori i Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm, Komuna e Mitrovicës.

## HC "ALBANIKU 4"

**a) Aktet ujore**

**a.1 Leja ujore** nr. 4950/20-ZSP-2020 e lëshuar më datë 13/11/2020, për HC "Albaniku 4", nga zyrtarja për leje ujore e Ministrisë, përmes Sekretarit të Përgjithshëm, Drejtorit të ARPL-së, dhe Udhëheqëses së Departamentit.

- Me leje ujore është kërkuar të realizohen strukturat e monitorimit kontinual të niveleve dhe prurjeve, mbi dhe poshtë profilin ujëmarrës 'me të cilin realizohet prurja natyrore dhe prurja e pranueshme ekologjike'.
- Leja Ujore është lëshuar për periudhë kohore 20 (njëzet) vjet.
- Sipas lejes ujore, 'e drejta ujore nuk paraqet të drejtën pronësore për palën apo shfrytëzimin e pronës për destinime tjera.'

Nga shqyrtimi i akteve ujore mund të konstatohet si vijon:

- 1) Nuk është zbatuar procedura e koncesionit për dhënien e të drejtës për shfrytëzim të ujit siç kërkohet me Ligjin për Ujërat e Kosovës.
- 2) Në leje ujore nuk ka të dhëna për veprat ujëmarrëse, lokacionin e tyre, tubacionet, prurjet ekologjike për secilën prej profileve ujëmarrëse, etj.
- 3) Ndërtesa e HC "Albaniku 4" është ndërtuar në afërsi të drejtpërdrejt të lumit, që është në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 48 që përcakton distancën prej 30 metrash).
- 4) Në asnjërën prej profileve të veprave ujëmarrëse nuk ka matje të prurjes së ujit, siç kërkohet me kushte ujore dhe me leje ujore.

**b) Aktet mjedisore**

- (i) **Pëlqimit mjedisor** nr. 13/1284/2-164/DMM datë: 19/08/2013 është lëshuar për operatorin "Hydro Line" sh.p.k. për ndërtimin e hidrocentraleve përgjatë lumit Bistricë në komunën e Mitrovicë nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPH. Pëlqimi mjedisor është lëshuar për të gjitha HC-et duke qenë kështu në kundërshtim me Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
- (ii) **Leja mjedisore** nuk është lëshuar ende. Megjithatë, operatori e ka lëshuar në funksion HC "Albaniku 4" duke qenë kështu në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit (neni 31).

**c) Aktet ndërtimore**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GP ka konstatuar sa vijon:

- (i) **Leja ndërtimore** me nr. 08-351/02-0111645/19 e lëshuar më datë 26.02.2020 për "Hydro-Line" sh.p.k., për HC "Albaniku 3", përmes drejtorit të Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm, Komuna Mitrovicë.
- (ii) **Leja ndërtimore** është lëshuar për objektin e HC "Albaniku 4" në ngastrën kadastrale 00217-0.
- (iii) **Certifikata e përdorimit** me nr. 08-350/02-0071734/20; datë: 23/11/2020 është lëshuar për objektin ekonomik, nga drejtori i Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm, Komuna e Mitrovicës.

#### 4.5.2 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË RESURSET UJORE, MJEDIS DHE BILANCET EKONOMIKE

**a) Skema e HC "Albaniku 2"**

- (i) Traseja e tubacioneve shtrihet nëpër sipërfaqe publike.

- (ii) Strukturat e betonit në veprat ujëmarrëse janë në shpërputhje të plotë me peizazhin.
- (iii) Ndërtesa e hidrocentralit është në afërsi të drejtpërdrejtë të lumit – në pronën ujore.

#### **b) Skema e HC “Albaniku 3”**

- (i) Traseja e tubacioneve shtrihet nëpër sipërfaqe publike.
- (ii) Strukturat e betonit në veprat ujëmarrëse janë në shpërputhje të plotë me peizazhin.
- (iii) Ndërtesa e hidrocentralit është në afërsi të drejtpërdrejtë të lumit – në pronën ujore.

#### **c) Skema e HC “Albaniku 4”**

- (i) Traseja e tubacioneve shtrihet nëpër sipërfaqe publike.
- (ii) Strukturat e betonit në veprat ujëmarrëse janë në shpërputhje të plotë me peizazhin.
- (iii) Ndërtesa e hidrocentralit është në afërsi të drejtpërdrejtë të lumit – në pronën ujore.

### **4.5.3 KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR HC-ET E KASKADËS SË LEPENCIT**

#### **4.5.3.1 Konkluzionet**

- 1) Dhënia e të drejtës ujore me *leje ujore* e jo me *koncesion* përbën shkelje të Ligjit për Ujëra Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës të vitit 2-13 (neni 78, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2).
- 2) Në leje ujore nuk ka të dhëna për veprat ujëmarrëse, lokacionin e tyre, tubacionet, prurjet ekologjike për secilën prej profileve ujëmarrëse, etj.
- 3) Leja ndërtimore për HC-et është lëshuar në pronë ujore, në afërsi të drejtpërdrejtë të lumit, në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 48) që përcakton distancën prej minimum 30 metra për ndërtimin e objekteve nga vija e plotave (ujërat 100-vjeçare).
- 4) Në projekte dhe raporte profesionale për leje ujore nuk janë dhënë të dhënat për hartuesin e projektit.
- 5) Edhe pse për dy prej tri HC-eve nuk janë lëshuar lejet mjedisore – të tri HC-et janë në operim.
- 6) Gjatë punimeve ka pas ndërhyrje në shtratin e lumit, pa autorizim.
- 7) Veprat marrëse për HC “Albaniku 2” janë të shtrira në territor të Komunës së Leposaviqit, pa pëlqim nga komuna.

#### **4.5.3.2 Rekomandimet**

Bazuar në konkluzionet nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe gjetjet në terren rekomandohen që të ndërmerren veprimet si vijon:

- 1) **Shfuqizimin/Anulimin e** akteve administrative mbi bazën e shkeljeve të ligjeve materiale dhe procedurale – Ligji për Ujërat e Kosovës dhe akteve nënligjore të miratuara në pajtim me këtë ligj, Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligji për mbrojtjen e Natyrës, Ligji për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
- 2) Të zbatohet koncesioni si instrument i të drejtës ujore në pajtim me ligjin e ujërave përmes kontratës koncesionare duke marr parasysh gjendjen faktike të krijuar në terren, **dhe të kërkohet nga investitori Hydro Line sh.p.k. që:**

- a. **t`i instalojë matësit e prurjes mbi dhe nën profilin e veprave ujëmarrëse për të tri HC-et.** Matësit e prurjes duhet të mundësojnë regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave ashtu që në çdo kohë të mund të verifikohet dhe sigurohet prurja e pranueshme ekologjike në lumë;
- b. **ta rishikojë projektimin dhe zbatimin e shtigjeve të peshqve dhe regjimit të aluvioneve** në të gjitha veprat ujëmarrëse për të tri HC-et;
- c. **ta kryejë incizimin gjeodezik të shtratit të lumit dhe të i identifikojë të gjitha ndërhyrjet në regjimin e rrjedhjes së ujit** si rezultat i punimeve në skemat e HC-eve;
- d. **të përpunojë strukturat e betonit (basenet e dekantimit) në mënyrë adekuate** ashtu që të jenë në harmoni me peizazhin e natyrës ku janë ndërtuar.
- e. **të sigurojë pëlqim nga Ministria për shfrytëzimin e pronës ujore** ku janë ndërtuar hidrocentralet.
- f. **të sigurojë lejet mjedisore për HC-et “Albaniku 2” dhe “Albaniku 4”.**

## 4.6 Hidrocentrali “Lepenci 3” në komunën e Kaçanikut

### 4.6.1 SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE ADMINISTRATIVE

#### a) Aktet ujore

**a.1 Leja ujore** për HC “Lepenci 3” me nr. 06/2936/1-DU-60/07-ZSP-1216 të datës 23/01/2007 ishte vazhduar në vitin 2013, më 17/01/2013 me vendimin tjetër nr. 3684/12-ZSP-70/13 me afat prej 20 vitesh për Hidroenergji sh.p.k.

- **Leja ujore ishte vazhduar** me kapacitet 8.5MW me kushte të njëjta sikurse edhe leja fillestare e vitit 2007.
- Me leje ujore ishin përcaktuar kushtet tipike të tekstit të lejeve ujore të asaj kohe, si vijon:
  - (i) që brenda 60 ditësh të dorëzohet në MMPH studimi hidrologjik, ekologjik dhe energjetik sipas kushteve të përcaktuara me *Kushtet Themelore Ujore për Hidrocentralet* si dokument punues në Departamentin e Ujërave të MMPH,
  - (ii) që manipulimi i pajisjeve hidroteknike të hidrocentralit tu përgjigjet kushteve koncesionare,
  - (iii) që me projekt kryesor të përcaktohet shtegu i migracionit të peshqve në profilin ujëmarrës si dhe strukturat përcjellëse të tij në harmoni me referencat e ESHA,
  - (iv) para fillimit të punës së hidrocentralit të hartohet dhe dorëzohet në Ministri Rregullorja e operimit dhe mirëmbajtjes së hidrocentralit,
  - (v) që të realizohen strukturat e monitorimit kontinual të niveleve dhe prurjeve të ujit mbi dhe poshtë profilin ujëmarrës,
  - (vi) që para fillimit të punës së hidrocentralit të hartohet dhe të dorëzohet në Ministri plani i veprimtimit të hidrocentralit,
  - (vii) që të udhëhiqet ditari mbi të gjitha manipulimet dhe vrojtimit dhe fenomenet të cilat paraqiten në objektet dhe brigjet e lumit përgjatë trasesë së tubacionit të hidrocentralit,
  - (viii) të raportohet çdo 3 muaj për sasinë e prodhimit të energjisë,
  - (ix) në rastet kur mungesa e ujit rrezikon në masë të madhe shfrytëzuesit e ujit në rajon të caktuar, lëshuesi i lejes ujore mund ta përkufizoj përkohësisht ose ta ndaloj shfrytëzimin e ujit për bartësin e lejes ujore,
  - (x) e drejta ujore nuk paraqet të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit të tokës respektivisht objekteve dhe pajisjeve të cilat nuk janë në pronësi të bartësit të drejtës ujore,
  - (xi) që në rast të mosplotësimit të kushteve të lartcekura pushon validiteti i lejes ujore.
- **Me vendim nr. 3753-3/16 DU/2017**, i datës 26/04/2017, ishte aprovuar ndryshimi/rritja e fuqisë instaluese të HC “Lepenci 3” nga 8.5 MW në 9.998 MW.

**a.2 Pëlqimi ujqor** nr. 1890/13-ZSP-428/2013 i lëshuar më datë 06/06/2013 nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPH për HC “Lepenci-3”.

- Me këtë pëlqim ujqor është aprovuar kërkesa e palës për pëlqim ujqor lidhur me ndërtimin e HC “Lepenci 3”, pa u cekë kapaciteti në MW, dhe duke u bazuar nga leja ujore për HC “Lepenci 3” nr.06/2936/1-DU-69/07-ZSP-1216 të datës: 23.01.2007
- Në këtë pëlqim ujqor janë përcaktuar kushtet e numëruara në paragrafët 3.1 deri 3.3 të këtij aktvendimi.

- Pëlqimi u dorëzuar në bazë të kushteve të përcaktuara nga leja ujqore paraprake nr.06/2936/1-DU-69/07-ZSP-1216 të datës: 23/01/2007, dhe vazhdimin të lejes ujqore nr.3684-ZSP-70/13; datë: 17/01/2013
- Vendosja planimetricke e objekteve përcaktohet me projektet e ndërtimit që duhen të jenë në harmoni me lëshimin e lejes ujqore.
- Analiza hidraulike e plotës duhet të jetë në periudhën 100 vjeçare sipas lejes ujqore.
- Arsyetimi i aktvendimit të pëlqimit ujqore jep të kuptohet se ky pëlqim ujqore nuk është për të drejtën ujqore po për "dhënien e pëlqimit për vendosjen e tubacionit përbri lumit Lepenc nga vepra e marrjes nga koordinata (Y7507824.5, X 4680394) e deri ku vendoset HC "Lepenci 3" në koordinatat (Y7514705, X 4680795). Sipas këtij arsyetimi shfrytëzimi i hapësirës fizike të pronave ujqore për vendosjen e infrastrukturës ujqore të HC-ve është në harmoni me nenin 13 dhe 79.3 të Ligjit për Ujërat e Kosovës nr. 2004/24.

**a.3 Leja ujqore nr. 6724-2/19-ZSP/20 e lëshuar më datë 05/06/2020, për Hidroenergjii, me rekomandimin e Drejtorit të ARPL.**

- Leja ujqore për HC Lepenci 3 me kapacitet 9.998 MW, edhe pse është emërtuar si dokument - për aprovimin e plotësimit të kushteve ujqore të parapara me lejen paraprake ujqore – ka përcaktuar kushte të njëjta siç kanë qenë të përcaktuara me lejen ujqore të vitit 2007 dhe 2013, si p.sh. instalimi i strukturave për monitorimin kontinual të niveleve dhe prurjeve të ujit mbi dhe poshtë profilin ujëmarrës, hartimi dhe dorëzimi i planit të veprimit të hidrocentralit, shtegu i migracionit të peshqve, obligimi që të raportohet çdo 3 muaj për energjinë e prodhuar, obligimi për pagesën e kompensimit për shfrytëzimin e ujit etj.
- Sipas lejes ujqore pajisjet ujëmatëse duhet të vendosen me aprovimin e IHMK.
- Afati i lejes ujqore është 20 vjet.
- Sipas lejes ujqore, 'e drejta ujqore nuk paraqet të drejtën pronësore për palën apo shfrytëzimin e pronës për destinime tjera.
- Me leje ujqore është kërkuar të realizohen strukturat e monitorimit kontinual të niveleve dhe prurjeve, mbi dhe poshtë profilin ujëmarrës 'me të cilin realizohet prurja natyrore dhe prurja e pranueshme ekologjike'.
- Sipas lejes ujqore, 'e drejta ujqore nuk paraqet të drejtën pronësore për palën apo shfrytëzimin e pronës për destinime tjera.
- Në *Arsyetimin* e vendimit për leje ujqore nuk është konfirmuar plotësimi i kushteve të lejes paraprake ujqore si: instalimi i pajisjeve të monitorimit të niveleve dhe prurjeve, dorëzimi i planit të veprimit, etj. Është konfirmuar vetë dorëzimi i përlllogaritjes së PPE e cila është dashur të kryhet në afat prej 60 ditësh nga data e lëshimit të lejes ujqore në janar të vitit 2013!
- Nuk ka një vendim për aprovimin ndryshimit të fuqisë instaluese të HC "Lepenci 3" prej 8.5 MW në 9.998 MW.

Nga shqyrtimi i akteve ujqore mund të konstatohet si vijon:

- 1) Nuk është zbatuar procedura e koncesionit për dhënien e të drejtës për shfrytëzim të ujit siç kërkohet me Ligjin për Ujërat e Kosovës.
- 2) Në leje ujqore nuk ka të dhëna për veprat ujëmarrëse, lokacionin e tyre, tubacionet, prurjet ekologjike për secilën prej profileve ujëmarrëse, etj.
- 3) Në *Arsyetimin* e vendimit për leje ujqore nuk është konfirmuar plotësimi i kushteve të lejes paraprake ujqore si: instalimi i pajisjeve të monitorimit të niveleve dhe prurjeve, dorëzimi i planit të veprimit etj. Është konfirmuar vetë dorëzimi i përlllogaritjes së PPE e cila është dashur të kryhet në afat prej 60 ditësh nga data e lëshimit të lejes ujqore në janar të vitit 2013!

- 4) Elaborati për prurjen e pranueshme ekologjike nuk ka autor.

**b) Aktet mjedisore**

- (i) **Pëlqimi mjedisor** nr. 06/3019/1-ZSP-1221 datë: 17/01/2007 është lëshuar për operatorin Hidroenergji nga Sekretari i Përhershëm i
- (ii) **Leja mjedisore** me nr. 20/822/ZSP/21 më datë 10/03/2021 me kushtet vijuese për Hidroenergji sh.p.k.:
- Të bëj monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, përmbushjen e kërkesave teknike;
  - Të respektohet prurja e pranueshme ekologjike në përputhje me Lejen Ujore për shfrytëzim të ujit;
  - Të respektohet hierarkia ujore në bazë të Ligjit për Ujëra, gjatë operimit nëse ka prishje teknike e që mund të këtë ndikim mjedisor apo në shëndetin e popullatës, apo ndonjë aksident mjedisor ta njoftoj MMPHI-ne.
  - Për menaxhim mjedisor ta këtë personin e profilit inxhinierik që është përgjegjës në mjedis.

**c) Aktet ndërtimore**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GP ka konstatuar sa vijon:

- (i) **Leja ndërtimore** me nr. 351/06-7564/17 e lëshuar më datë 06/03/2018, për Hidroenergji sh.p.k., për HC “Lepenci 3”, përmes drejtorit të Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm, Komuna Shtërpçë.
- (ii) **Vendim-Komuna e Kaçanikut** me nr. 06nr.351/02-5707/19 i është lëshuar për Hidroenergji SH.P.K me datë: 19/03/2019 për nderimin e lokacionit të ndërtimit të objektit të Hidrocentralit “Lepenci 3” nga ngastra kadastrale 1845-0 zona kadastrale Sllatine në ngastrën kadastrale 564-0 zona kadastrale Sllatine, nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Planifikimi, Rindërtim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.
- (iii) **Dhënia në shfrytëzim e pronës ujore nga Komuna e Shtërpçës për Hidroenergji** me Vendim nr. 02-16-2226 i datës 02/08/2013 është në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 109, paragrafi 3).
- (iv) **Rekomandimi me nr. prot. 3182/13** të datës: 06/09/2013, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë, thekson se “operatorit SH.P.K “Hidroenergji”- HC “Lepenci 3” i jepet e drejta e shfrytëzimit të ujit dhe pronave të sipërfaqeve ujore me të drejtë të garantuar 20 vjet, dhe administrativisht pa mundësi kontestimi” e që është në kundërshtim me nenin 9 dhe nenin 110-pika 3 e Ligjit për Mbrojtje të Ujërave nr. 04/L-147.

#### 4.6.2 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË RESURSET UJORE, MJEDIS DHE BILANCET EKONOMIKE

**a) Skema e HC “Lepenci 3”**

- (i) Traseja e tubacioneve shtrihet nëpër sipërfaqe publike.
- (ii) Strukturat e betonit në veprat ujëmarrëse janë në shpërputhje të plotë me peizazhin.
- (iii) Ndërtesa e hidrocentralit është në afërsi të drejtpërdrejtë të lumit – në pronën ujore.
- (iv) Nuk ka matje të prurjeve para dhe pas profilit të veprës ujëmarrëse;
- (v) Ka mbeturina në tërë sipërfaqen e veprës marrëse gjë që bie në kundërshtim me kushtet e raportit të VNM-së.



### 4.6.3 KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR HC-ET E KASKADËS SË LEPENCIT

#### 4.6.3.1 Konkluzionet

- 1) Dhënia e të drejtës ujore me *leje ujore* e jo me *koncesion* përbën shkelje të Ligjit për Ujëra nr. 2004/24 i vitit 2004 dhe Ligjit për Ujërat e Kosovës nr. 04/L-147 të vitit 2013 (neni 78, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2).
- 2) Leja ujore e lëshuar në vitin 2007, është vazhduar në vitin 2013 dhe është ri-lëshuar në vitin 2020;
- 3) Kushtet ujore të vendosura me lejen ujore të vitit 2007 janë përsëritur në vitin 2013 dhe pastaj përsëri në vitin 2020 (matja e prurjeve, dorëzimi i planit të veprimit etj.).
- 4) Në leje ujore nuk ka të dhëna për veprat ujëmarrëse, lokacionin e tyre, tubacionet, prurjet ekologjike për secilën prej profileve ujëmarrëse, etj.
- 5) Ndërtesa e HC-it është ndërtuar në pronë ujore në afërsi të drejtpërdrejt të lumit, në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 48) që përcakton distancën prej minimum 30 metra për ndërtimin e objekteve nga vija e plotave (ujërat 100-vjeçare).
- 6) Në projekte dhe raporte profesionale për leje ujore nuk janë dhënë të dhënat për hartuesin e projektit.
- 7) Pëlqimi ujqor është lëshuar në vitin 2013 për ndërtimin e tubacioneve përbri lumit Lepenc, nga vepra marrëse deri të hidrocentrali;
- 8) Në lejet ujore të lëshuara ka konfuzion dhe deklarime arbitrare sa i përket shfrytëzimit të pronave ujore; madje edhe brenda të njëjtit vendim ka kundërthënie: njëherë thuhet se e drejta ujore nuk paraqet të drejtën për pronësi apo për shfrytëzim të pronës ujore, ndërkaq në rastet tjera thuhet se e drejta ujore nënkupton të drejtën për shfrytëzim të pronës ujore.
- 9) **Dhënia në shfrytëzim e pronës ujore nga Komuna e Shtërpcës për Hidroenergji** me Vendim nr. 02-16-2226 i datës 02/08/2013 është në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 109, paragrafi 3).
- 10) **Rekomandimi me nr. prot. 3182/13** të datës: 06/09/2013, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nga Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë, thekson se “operatorit SH.P.K “Hidroenergji”- HC “Lepenci 3” i jepet e drejta e shfrytëzimit të ujit dhe pronave të sipërfaqeve ujore me të drejtë të garantuar 20 vjet, dhe administrativisht pa mundësi kontestimi” e që është në kundërshtim me nenin 9 dhe nenin 110-pika 3 e Ligjit për Mbrojtje të Ujërave nr.04/L-147.

#### 4.6.3.2 Rekomandimet

Bazuar në konkluzionet nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe gjetjet në terren rekomandohen që të ndërmerren veprimet si vijon:

- 1) **Shfuqizimin/Anulimin e** akteve administrative mbi bazën e shkeljeve të ligjeve materiale dhe procedurale – Ligji për Ujërat e Kosovës dhe akteve nënligjore të miratuara në pajtim me këtë ligj, Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligji për mbrojtjen e Natyrës, Ligji për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
- 2) Të zbatohet koncesioni si instrument i të drejtës ujore në pajtim me ligjin e ujërave përmes kontratës koncesionare duke marr parasysh gjendjen faktike të krijuar në terren, **dhe të kërkohet nga investitori Hidroenergji sh.p.k. që:**
  - a. **t’i instalojë matësit e prurjes mbi dhe nën profilin e veprave ujëmarrëse.** Matësit e prurjes duhet të mundësojnë regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave ashtu që në

çdo kohë të mund të verifikohet dhe sigurohet prurja e pranueshme ekologjike në lumë;

- b. **ta rishikojë projektimin dhe zbatimin e shtigjeve të peshqve dhe regjimit të aluvioneve** në veprat ujëmarrëse;
- c. **ta kryejë incizimin gjeodezik të shtratit të lumit dhe të i identifikojë të gjitha ndërhyrjet në regjimin e rrjedhjes së ujit** si rezultat i punimeve në ndërtimin e HC-it;
- d. **të përpunojë strukturat e betonit (basenet e dekantimit) në mënyrë adekuate** ashtu që të jenë në harmoni me peizazhin e natyrës ku janë ndërtuar.
- e. **të sigurojë pëlqim nga Ministria për shfrytëzimin e pronës ujore** ku janë ndërtuar hidrocentralet.

## 4.7 Hidrocentrali “Bresanë” në komunën e Dragashit

### 4.7.1 SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE ADMINISTRATIVE

#### a) Aktet ujore

**a.1 Pëlqimi ujqor** nr. 1664/16-ZSP-649/2016 i lëshuar më datë 31/05/2016, nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPH për HC “Bresanë”.

- a) Me këtë pëlqim ujqor është aprovuar kërkesa e palës për pëlqim ujqor lidhur me ndërtimin e hidrocentralit HC “Bresanë” me kapacitet 0.31 MW në lumin *Shehu i Madh* në komunën e Dragashit. Në këtë pëlqim ujqor janë përcaktuar nëntë kushte të numëruara në paragrafët 2.1 deri 2.9.
- b) Pëlqimi ujqor është lëshuar në bazë të “dokumentacionit investivo-teknik i cili ruhet tek operatori “Dilli-Com”.

**a.2 Leja ujore** nr. 4694/20-ZSP-2020 e lëshuar më datë 24.12.2020, për HC “Bresanë”, me rekomandimin e zyrtares përgjegjëse për Leje Ujore, përmes Sekretarit të Përgjithshëm, Drejtorit të ARPL, dhe udhëheqëses së DMRU.

- c) Me leje ujore është kërkuar të realizohen strukturat e monitorimit kontinual të niveleve dhe prurjeve, mbi dhe poshtë profilit ujëmarrës ‘me të cilin realizohet prurja natyrore dhe prurja e pranueshme ekologjike’.
- d) Sipas lejes ujore të udhëhiqet ditari i punës mbi manipulimet, vrojtimit etj.
- e) Afati i lëshimit të lejes ujore është 20 vite, që nga fillimi i periudhës kohore prodhuese, me mundësi vazhdimi.
- f) Sipas lejes ujore, e drejta ujore nuk paraqet të drejtën pronësore për palën apo shfrytëzimin e pronës për destinime tjera.’

Nga shqyrtimi i akteve ujore mund të konstatohet si vijon:

- 1) Nuk është zbatuar procedura e koncesionit për dhënien e të drejtës për shfrytëzim të ujit siç kërkohet me Ligjin për Ujërat e Kosovës.
- 2) Në leje ujore nuk ka të dhëna për veprat ujëmarrëse, lokacionin e tyre, tubacionet, prurjet ekologjike për secilën prej profileve ujëmarrëse, etj.
- 3) Ndërtesa e HC “Bresanë” është ndërtuar në afërsi të drejtpërdrejt të lumit, që është në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 48 që përcakton distancën prej 30 metrash).
- 4) Në *Arsyetimin* e vendimit për leje ujore nuk është konfirmuar plotësimi i kushteve të lejes paraprake ujore si: instalimi i pajisjeve të monitorimit të niveleve dhe prurjeve, dorëzimi i planit të veprimit, etj.

#### b) Aktet mjedisore

- (i) **Pëlqimi mjedisor** nr. 15/3649/1-379/DMM; datë: 16.10.2015 nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPH-së, për kompaninë NN “Dilli-Com”, Bresanë, Komuna Dragash.
- (ii) **Leja mjedisore** nuk është lëshuar ende por HC-ja është duke operuar.

#### c) Aktet ndërtimore

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GP ka konstatuar sa vijon:

- (i) **Leja ndërtimore** me nr. 351/14099 e lëshuar më datë 18/11/2016, për N.N “Dilli-Com” HC “Bresanë”, nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër, Komuna Dragash. Leja ndërtimore është lëshuar për objektin e HC “Bresanë”,

Komuna Dragash me ngastrat kadastrale nr. 2752; 1880; 1881 Z.K Bresanë – Komuna Dragash

- (ii) Certifikata e përdorimit me nr. 350/04-30799; datë: 05.12.2019 është lëshuar për: N.N “Dilli-Com” për HC Bresanë nga Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër, Komuna Dragash.

#### 4.7.2 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË RESURSET UJORE, MJEDIS DHE BILANCET EKONOMIKE

##### a) Skema e HC “Bresanë”

- (i) Ka shteg të peshqve në formë natyrale.
- (ii) Traseja e tubacioneve shtrihet nëpër shtratin e lumit.
- (iii) Strukturat e betonit në veprat ujëmarrëse janë në shpërputhje me peizazhin.
- (iv) Ndërtesa e hidrocentralit është në afërsi të drejtpërdrejtë të lumit – në pronën private.
- (v) Nuk ka matje të prurjeve para dhe pas profilit të veprës ujëmarrëse;

#### 4.7.3 KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR HC-in e BRESANËS

##### 4.7.3.1 Konkluzionet

- 1) Dhënia e të drejtës ujore me *leje ujore* e jo me *koncesion* përbën shkelje të Ligjit për Ujëra nr. 04/L-147 të vitit 2013 (neni 78, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2).
- 2) Pëlqimi ujqor është lëshuar në vitin 2016 ndërkaq leja ujore në vitin 2020.
- 3) Ndërtesa e HC-it është ndërtuar në pronë ujore në afërsi të drejtpërdrejtë të lumit, në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 48) që përcakton distancën prej minimum 30 metra për ndërtimin e objekteve nga vija e plotave (ujërat 100-vjeçare).
- 4) Në lejet ujore të lëshuara ka konfuzion dhe deklarime arbitrare sa i përket shfrytëzimit të pronave ujore; madje edhe brenda të njëjtit vendim ka kundërthënie: njëherë thuhet se e drejta ujore nuk paraqet të drejtën për pronësi apo për shfrytëzim të pronës ujore, ndërkaq në rastet tjera thuhet se e drejta ujore nënkupton të drejtën për shfrytëzim të pronës ujore.
- 5) HC “Bresanë” është nuk ka leje mjedisore por është në operim.

##### 4.7.3.2 Rekomandimet

Bazuar në konkluzionet nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe gjetjet në terren rekomandohen që të ndërmerren veprimet si vijon:

- 1) **Shfuqizimin/Anulimin e** akteve administrative mbi bazën e shkeljeve të ligjeve materiale dhe procedurale – Ligji për Ujërat e Kosovës dhe akteve nënligjore të miratuara në pajtim me këtë ligj, Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligji për mbrojtjen e Natyrës, Ligji për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
- 2) Të zbatohet koncesioni si instrument i të drejtës ujore në pajtim me ligjin e ujërave përmes kontratës koncesionare duke marr parasysh gjendjen faktike të krijuar në terren, dhe të kërkohet nga investitori “Dilli-Com” që:
  - a. t’i instalojë matësit e prurjes mbi dhe nën profilin e veprave ujëmarrëse. Matësit e prurjes duhet të mundësojnë regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave ashtu që në

çdo kohë të mund të verifikohet dhe sigurohet prurja e pranueshme ekologjike në lumë;

- b. **ta rishikojë projektimin dhe zbatimin e shtigjeve të peshqve dhe regjimit të aluvioneve** në veprat ujëmarrëse;
- c. **ta kryejë incizimin gjeodezik të shtratit të lumit dhe të i identifikojë të gjitha ndërhyrjet në regjimin e rrjedhjes së ujit** si rezultat i punimeve në ndërtimin e HC-it;
- d. **të përpunojë strukturat e betonit (basenet e dekantimit) në mënyrë adekuate** ashtu që të jenë në harmoni me peizazhin e natyrës ku janë ndërtuar.
- e. **të sigurojë pëlqim nga Ministria për shfrytëzimin e pronës ujore** ku janë ndërtuar hidrocentralet.
- f. **të pajiset me leje mjedisore.**
- g. **t`i përmbushi të gjitha kushtet e përcaktuara me leje ujore.**

## 4.8 Hidrocentrali “Binça” në komunën e Vitisë

### 4.8.1 SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE ADMINISTRATIVE

#### a) Aktet ujore

**a.1 Pëlqimi ujq** nr. nr. 382/15-ZSP/2015 i lëshuar më datë 27/04/2015 nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPH për HC “Binça”.

- g) Me këtë pëlqim ujq është aprovuar kërkesa e palës për pëlqim ujq lidhur me ndërtimin e HC “Binça” me kapacitet 0.6 MW në pjesën e sipërme të lumit Morava e Binçës, në komunën e Vitisë. Në këtë pëlqim ujq janë përcaktuar nëntë kushte të numëruara në paragrafët 4.1 deri 4.9.
- h) Pëlqimi ujq është lëshuar në bazë të “dokumentacionit investivo-teknik i cili ruhet tek operatori “Eko-Energji”.
- i) Të realizohet struktura e monitorimit kontinual të niveleve dhe prurjeve të ujit, mbi dhe poshtë profilit ujëmarrës.
- j) Të udhëhiqet ditari gjatë procesit të ndërtimit të hidrocentralit, si dhe të gjitha ecuritë tjera të përcjellën nga ana e operatorit si: manipulimet, fenomenet etj.
- k) Pëlqimi ujq nuk paraqet të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit të tokës, respektivisht objekteve dhe pajisjeve të cilat nuk janë në pronësi të bartësit të pëlqimit ujq.
- l) Validiteti i pëlqimit ujq pushon në rast të mos plotësimit të kushteve të këtij pëlqimi-vendimi.

**a.2 Konkluzion nr. 1883/16/DU/2016;** datë: 20/05/2016 lëshohet mbi plotësimin e dokumentacionit investivo-teknik shtesë si:

- Studimi hidroenergjetik të hidrocentralit në harmoni me rezultatet e studimit paraprak.
- m) Paraqitja grafike e analitike koncesional të shfrytëzimit të ujit, dhe prodhimit të energjisë në muaj, dhe mesatares shumëvjeçare.
- n) Afati i plotësimit dhe përmirësimit të dokumentacionit të lartpërmendur është 60 ditë nga dita e pranimit të këtij konkluzioni.

**a.3 Leja ujore** nuk është lëshuar.

Nga shqyrtimi i akteve ujore mund të konstatohet si vijon:

- 1) Nuk është zbatuar procedura e koncesionit për dhënien e të drejtës për shfrytëzim të ujit siç kërkohet me Ligjin për Ujërat e Kosovës.

#### b) Aktet mjedisore

- (i) **Pëlqimit mjedisor** nr. 16/2467/1-413/DMM, i lëshuar më datë: 15.07.2015 nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPH-së, për SH.P.K “Eko-Energji” nga fshati Pozharan, i komunës Viti për HC “Binçe” me kapacitet 0.6 MW përgjatë lumit Moravë e Binçës, Komuna e Vitisë.
- (ii) **Leja mjedisore** nuk është lëshuar ende.

#### c) Aktet ndërtimore

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GP ka konstatuar sa vijon:

- (i) **Leja ndërtimore** me nr. 11-016/48235, datë 19/01/2017 për operatorin SH.P.K. “Eko-Energji” të ndërtimit të HC “Binçe” me kapacitet 0.6 MW, në parcelat nr. 1792-2 zona kadastrale Binçe, dhe parcela nr. 1845-0 Zona Kadastrale Binçe nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis.

- (ii) **Vendim vazhdimi të lejes ndërtimore** me nr. 11-320/04-22934 e lëshuar më datë 07/06/2018, për SH.P.K “Eko-Energji” për HC “Binçë” është e lëshuar vazhdimi i lejes ndërtimore pa kapacitet dhe pa ngastra-parcela, nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis.
- (iii) **Certifikata e përdorimit** me nr. 11-320/04-56879; datë: 14.02.2020 është lëshuar për SH.P.K “Eko-Energji” për HC “Binçë” me kapacitet 1 MW, nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis.

#### 4.8.2 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË RESURSET UJORE, MJEDIS DHE BILANCET EKONOMIKE

##### a) Skema e HC “Binça”

- (i) Traseja e tubacioneve shtrihet nëpër shtratin e lumit.
- (ii) Strukturat e betonit në veprat ujëmarrëse janë në shpërputhje me peizazhin.
- (iii) Ndërtesa e hidrocentralit është në afërsi të drejtpërdrejtë të lumit – në pronën ujore.
- (iv) Nuk ka matje të prurjeve para dhe pas profilit të veprës ujëmarrëse;

#### 4.8.3 KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR HC-in e BINÇËS

##### 4.8.3.1 Konkluzionet

- 1) Dhënia e të drejtës ujore me *leje ujore* e jo me *koncesion* përbën shkelje të Ligjit për Ujëra nr. 04/L-147 të vitit 2013 (neni 78, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2).
- 2) Pëlqimi ujqor është lëshuar në vitin 2016 ndërkaq leja ujore nuk është lëshuar fare.
- 3) Ndërtesa e HC-it është ndërtuar në pronë ujore në afërsi të drejtpërdrejtë të lumit, në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës (neni 48) që përcakton distancën prej minimum 30 metra për ndërtimin e objekteve nga vija e plotave (ujërat 100-vjeçare).
- 4) HC “Binçë” operon pa leje ujore në kundërshtim me nenin 97 , paragrafi 2, nënparagrafi 2.4 të Ligjit për Ujërat e Kosovës si dhe pa leje mjedisore, në kundërshtim me nenin 31 të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit 03/L-025.

##### 4.8.3.2 Rekomandimet

Bazuar në konkluzionet nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe gjetjet në terren rekomandohen që të ndërmerren veprimet si vijon:

- 1) **Shfuqizimin/Anulimin e** akteve administrative mbi bazën e shkeljeve të ligjeve materiale dhe procedurale – Ligji për Ujërat e Kosovës dhe akteve nënligjore të miratuara në pajtim me këtë ligj, Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligji për mbrojtjen e Natyrës, Ligji për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
- 2) Të zbatohet koncesioni si instrument i të drejtës ujore në pajtim me ligjin e ujërave përmes kontratës koncesionare duke marr parasysh gjendjen faktike të krijuar në terren, **dhe të kërkohet nga investitori sh.p.k. “Eko-energji” që:**
  - a. **t`i përmbushë të gjitha kushtet e përcaktuara me pëlqim ujqor;**
  - b. **të pajiset me leje ujore;**
  - c. **t`i instalojë matësit e prurjes mbi dhe nën profilin e veprave ujëmarrëse.** Matësit e prurjes duhet të mundësojnë regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave ashtu që në çdo kohë të mund të verifikohet dhe sigurohet prurja e pranueshme ekologjike në lumë;



- d. **ta rishikojë projektimin dhe zbatimin e shtigjeve të peshqve dhe regjimit të aluvioneve** në veprat ujëmarrëse;
- e. **ta kryejë incizimin gjeodezik të shtratit të lumit dhe të i identifikojë të gjitha ndërhyrjet në regjimin e rrjedhjes së ujit** si rezultat i punimeve në ndërtimin e HC-it;
- f. **të përpunojë strukturat e betonit (basenet e dekantimit) në mënyrë adekuate** ashtu që të jenë në harmoni me peizazhin e natyrës ku janë ndërtuar.
- g. **të sigurojë pëlqim nga Ministria për shfrytëzimin e pronës ujore** ku janë ndërtuar hidrocentralet.
- h. **të pajiset me leje mjedisore.**

## V. KONKLuzionet dhe Rekomandimet

### 5.1 Konkluzionet

#### 5.1.1 Aktet administrative

- a) Aktet administrative për HC-e të lëshuara nga Ministria **nuk janë në përputhje** me nenet 47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative
- b) **Mungon transparenca** e organeve kompetente për procedurat e dhënies së lejeve ujore, pëlqimeve mjedisore për organizimin e dëgjimeve publike dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, sipas kërkesave ligjore të Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës (Neni 84 paragrafi 10), UA.nr.03/2018 për Procedurat për Leje Ujore (neni 25), Ligjit për Mbrojtje të Mjedisit (Neni 57), si dhe Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (neni 20).
- c) **Nuk ka unifikim të procedurave në Ministri sa i përket nënshkrimit të akteve administrative** dhe delegimit të kompetencës brenda njësive organizative, sipas ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (nenet 26 dhe 27).

#### 5.1.2 Aktet ujore

- a) E drejta ujore është dhënë me *leje ujore* e jo me *koncesion* që është **në kundërshtim** me ligj – *Ligjin për Ujëra nr. 2004/24* të vitit 2004 (neni 60, paragrafi 2 nënparagrafi a) dhe *Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës* të vitit 2013 (neni 78, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2).<sup>12</sup>
- b) Lejet ujore 2012 dhe 2013 janë lëshuar **pa u plotësuar kushtet** e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ<sup>13</sup> në fuqi për leje ujore sa i përket përmbajtjes së aplikacionit mbi bazën e të cilit lëshohet leja ujore (neni 22 i UA) gjë që është në kundërshtim me legjislacionin e zbatueshëm. Lejet ujore të lëshuara gjatë kësaj periudhe nuk janë revokuar nga Ministria ashtu siç përcaktohet me *Ligjin nr. 2004/24 për Ujërat e Kosovës* (neni 58), përkundër faktit që afati prej 90 ditësh i përcaktuar për përmbushjen e kushteve të lejes ujore nuk ishte respektuar nga investitorët.
- c) Në shumë raste (rasti i Kelkos, etj.) leja ujore është lëshuar **pa studim adekuat të prurjes së pranueshme ekologjike** që do të duhej të hartohej në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm (Rregulloren 02/2016).
- d) Lejet ujore janë lëshuar **pa instalimin e pajisjeve matëse** mbi dhe nën profilin e veprës ujëmarrëse (që është obligim i investitorit) dhe për pasojë pa pasur mundësi të verifikimit të prurjes së pranueshme ekologjike.
- e) Aktet ujore janë lëshuar gjatë periudhës 2012-2021 me një ndërprerje gjatë viteve 2017-2019. **Numri më i madh i akteve ujore janë lëshuar në vitet 2020-2021**, gjithsej 17 leje ujore (përfshirë këtu përtëritjen/ri-lëshimin e lejeve ujore për *Kelkos Energy* dhe operatorë tjerë).
- f) Ligjit për Ujërat e Kosovës i **mungon dispozita kalimtare për rregullimin e zbatimit të dispozitave të akteve nënligjore** ekzistuese të cilat kanë qenë të nxjerra me ligjin paraprak.

<sup>12</sup> Procesi i dhënies së akteve ujore është zhvilluar gjatë viteve 2007 deri 2021 gjatë së cilës kohë sa i përket të drejtës për shfrytëzim të ujit kanë qenë në fuqi *Ligji për Ujërat e Kosovës nr. 2004/24* i vitit 2004 dhe *Ligji nr. 04/L-147* i vitit 2013.

<sup>13</sup> *Udhëzimit Administrativ nr. 63-24/05 Mbi Përmbajtjen, Formën, Kushtet dhe Mënyrat e Lëshuarjes dhe Ruajtjes së Lejes Ujore.*

- g) Aktet ujore në aspektin përmbajtjesor (*dispozitivi dhe arsyetimi*) **nuk janë në përputhje** esenciale me kriteret e *Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative* dhe aktet ekuivalente ujore të regjionit.
- h) Edhe pse e drejta e ujit në shtratin e lumit dhe e drejta shtratit dallojnë, e drejta pronësore e shtratit të lumit dhe bregut të lumit nuk është zbatuar. **Obligimet ligjore lidhur me pronat ujore janë neglizhuar** që nga viti 2004.
- i) Në shumë raste ka pasur **riciklim të kushteve të akteve paraprake ujore** në aktet pasuese, pa justifikim në përmbajtjen e këtyre të fundit.
- j) Edhe pse hidrocentrale konsiderohen objekte të ndërlikuara (UA për Leje Ujore), **nuk është shfrytëzuar e drejta rregullative për angazhim të eksperteve** të jashtëm nga organi kompetent në procedurat e shqyrtimit të akteve ujore, me gjithë konstatimet e projekteve mbështesë ndërkombëtare për nivelin e ulët të stafit të Ministrisë në vlerësimin e komponentës teknike të kërkesave për shfrytëzim të ujërave.
- k) Operatorët e HC-ve në zonat e mbrojtura **nuk kanë zbatuar dispozitat e Rregullores 02/2016 PPE** (nenin 11), derisa organi ka lëshuar Leje Ujore pa kriterin në fjalë - Vlerësimin e Veçantë të PPE.
- l) Regjimi i ujërrjedhës në kapërderdhësit e PPE nuk është autonom në raport me regjimin hidraulik të veprës ujëmarrëse. **Pragu i kapërderdhësit të PPE do të duhej të pamundësojë konstruktivisht manipulimin** e regjimit të PPE.
- m) **Ministria ka aprovuar shtimin e numrit të HC-ve** (p.sh. Kelkos nga dy në tre) krahasuar me studimet e para-fizibilitetit, si dhe rritjen e kapaciteteve (fuqinë instaluese) të HC-ve të veçanta në krahasim me projektet fillestare.
- n) Aktet ujore janë lëshuar në **mungesë të dokumenteve planifikuese nga fusha e ujërave** - Planet për Menaxhimin e Pellgjeve Ujore që kërkohet të miratohen sipas Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës (nenet 30 dhe 32).

### 5.1.3 Aktet mjedisore

- a) Pëlqimet mjedisore, ndryshe nga aktet tjera administrative (lejet ujore, lejet e ndërtimit), janë lëshuar në të shumtën e rasteve duke i **trajtuar kaskadat prej 3-4 hidrocentraleve si një projekt** gjë që nga GP konsiderohet problematike sa i përket interpretimit të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (neni 7).
- b) Nga 20 HC-e në operim, **vetëm 4 prej tyre posedojnë leje mjedisore**, ndërsa 16 të tjera operojnë në mënyrë ilegale, pa leje mjedisore, në kundërshtim me ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit nr. 03/L-025 (neni 31).
- c) **Pëlqimet dhe lejet mjedisore janë lëshuar edhe për ndërtimet në zonat e mbrojtura** (Parku Kombëtar “Sharri” dhe Zona e Veçantë e Mbrojtur Manastiri i Deçanit), gjë që është në kundërshtim me legjislacionin e zbatueshëm, ligjin për Parkun Kombëtar Sharri nr. 04/L-087 (neni 3, paragrafi 2), ligjin për Zonat e Veçanta Nr. 03/L-039 (neni 5, paragrafi a) si dhe ligjin për Mbrojtjen e natyrës 03/L-233 (neni 11, paragrafi 4).
- d) Diskutimi publik për vlerësimin e ndikimit në mjedis është zhvilluar formalisht **pa transparencën dhe informacionet e duhura** si dhe me pjesëmarrje minimale (ose pa pjesëmarrje) të publikut.
- e) Procesi i hartimit dhe vlerësimit të raporteve të VNM-së përgjithësisht **nuk e përmbush funksionin që ka** – cilësia e raporteve si dhe cilësia e shqyrtimit dhe vlerësimit të tyre është e dobët.

- f) **Ka vonesa në shqyrtimin dhe nxjerrjen e akteve administrative** brenda afatit ligjor, në kundërshtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, (neni 48 paragrafi 2) dhe U.A Nr. 07/2017 për Leje Mjedisore (Neni 10).
- g) Është konstatuar se **përmbajta e pëlqimeve mjedisore të caktuara është me të meta të tilla** (dispozitivi në kundërthënie me arsyetimin) të cilat pamundësojnë vlerësimin ligjor (sipas referencës në aktvendime të Gjykatës Themelore të Prishtinës).
- h) Dispozita të caktuara në përmbajtjen e Pëlqimit Mjedisor lidhur me përcaktimin e statusit të pronave ujore **janë në kundërshtim me UA Nr.08/2012** për Dokumentacion Aplikues për Pëlqim Mjedisor.

#### 5.1.4 Aktet e ndërtimit

- a) Leja urbanistike e cila paraprinë lejen e ndërtimit për HC “Deçan” dhe HC “Belaje” **janë lëshuar nga Ministria në kundërshtim me Ligjin e Planifikimit Hapësinor** nr. 2003/14 dhe Ligjin për Ndërtim nr. 2004/15. Leja e ndërtimit për HC “Lumbardhi II” dhe Diga janë dhënë nga Ministria por diga nuk është ndërtuar fare.
- b) **Ministria ka legalizuar ndërtimin pa leje** të tubacioneve, kablove dhe fibrave optikë për HC “Belaje” dhe HC “Deçani” në bazë të Ligjit Nr. 06/L-024 për Trajtimin e ndërtimeve pa leje.
- c) Ministria ka lëshuar leje të përdorimit për HC “Lumbardhi II” përkundër faktit se në këtë objekt **janë bërë ndryshime në projekt pa pëlqim të Ministrisë.**
- d) Ministria ka lëshuar lejen e ndërtimit për HC “Deçani” dhe HC “Belaje” që janë në zonën e veçantë të mbrojtur të Manastirit të Deçanit, **në kundërshtim me ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura**, si dhe për HC “Lumbardhi II” në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtje të Natyrës.
- e) Lejet e ndërtimit janë lëshuar nga komunat **në zonat e mbrojtura në kundërshtim me legjislacionin** e zbatueshëm – Ligjin për Parkun Kombëtar “Sharri”.
- f) Çështja e pranimeve teknike të fazave të objekteve pa pjesëmarrjen e inspektoratit edhe pse në aspektin formal është e lejueshme, **ka rezultuar me pazbatueshmëri efektive të legjislacionit në fuqi** dhe të rregullave profesionale të fushës së ndërtimit.
- g) **Mungon baza ligjore për shfuqizimin / anulimin e Certifikatës së Përdorimit të Objektivit.**
- h) Në Raportin e Pranimit Teknik të HC-ve në Deçan, është kërkuar rivlerësimi i PPE.

#### 5.1.5 Pronat ujore

- a) Shumica dërrmuese e tubacioneve dhe **hidrocentraleve janë ndërtuar në pronat ujore.**
- b) Dhënia në shfrytëzim e pronës ujore nga komunat dhe Agjencia Pyjore e Kosovës është **në kundërshtim me Ligjin për Ujërat e Kosovës** (neni 109, paragrafi 3).
- c) Ministria ka zbatuar qasje arbitrare sa i përket pronave ujore:
  - i. në disa raste ka theksuar që leja ujore nuk paraqet të drejtën e pronësisë dhe shfrytëzimit të pronës ujore,
  - ii. në raste tjera ka konstatuar se jepet e drejta e shfrytëzimit të ujit dhe pronave të sipërfaqeve ujore me të drejtë të garantuar 20 vjet, dhe administrativisht pa mundësi

kontestimi” (kjo e fundit në kundërshtim me nenin 9 dhe nenin 110 të Ligjit për Ujërat nr. 04/L-147).

### 5.1.6 Mbikëqyrja inspektuese

- a) Nuk ka pasur mbikëqyrje efektive inspektuese sipas ligjeve në fuqi, p.sh. Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës (neni 94), Ligji për Mbrojtje të Mjedisit (neni 81), Ligji për Mbrojtjen e Natyrës (neni 162), Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (neni 34) si dhe Ligjit nr. 04/L-125 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit (nenet 7, 8 dhe 22).
- b) Si rezultat i mungesës së mbikëqyrjes inspektuese, veprimet kundërligjore nuk janë ndaluar duke shkaktuar dëme mjedisore.

### 5.1.7 Çështjet tjera

- a) **Vlera totale e kostove të investimeve** sipas deklarimeve të operatorëve në ZRRE për hidrocentralet e kompletuara që janë në operim është: **121,846,366.00 EUR** (shënim: informatë afariste, të mos publikohet).
- b) **Shumica e hidrocentraleve operojnë pa leje mjedisore** që është në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisin (neni 31). Nuk ka informacion që inspektorati mjedisor të këtë ndërmarr ndonjë veprim.
- c) Sipas ZRRE, me legjislacionin e ZRRE është paraparë që për fitimin e autorizimit të sigurohet leja ujore e jo koncesioni si instrument i të drejtës ujore ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Ujëra, pasi që Ministria e ka filluar ta zbatojë lejen ujore.
- d) Operatori gjatë ndërtimit të HC “Lumëbardhi II” **ka eksploatuar ilegalisht inertet në lokacionin Zalli i Rupës** në sasi të konsiderueshme (sipas vlerësimit të grupit), derisa Ministria ka neglizhuar zbatimin e detyrueshëm të dispozitave materiale.
- e) **Nuk janë zbatuar detyrimet nga ana e investitorit** sipas marrëveshjes kontraktuese me komunën (në rastin e HC-eve të Deçanit), për ndërtimin e digës mbi HC “Lumëbardhi II”

## 5.2 Rekomandimet

1. **Të shfuqizohen/anulohen të gjitha aktet administrative** të lëshuara në kundërshtim me ligj (Ligji për Ujërat e Kosovës dhe akteve nënligjore të miratuara në pajtim me këtë ligj, Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, Ligji për Parkun Kombëtar “Sharri”, Ligji për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative).
2. **Ministria/Qeveria të nxjerr vendim për moratorium për procedurat e ndërtimit të HC-ve të tipit me derivacion** (tub ose kanal) deri në miratimin e planeve të menaxhimit të pëllgjeve lumore si dhe kompletimin e legjislacionit për dhënien e koncesionit për shfrytëzimin e ujit.
3. **Tu ndërpritet operimi nga organi kompetent të gjitha HC-ve që operojnë pa leje mjedisore.**
4. Si alternativë e shfuqizimit (rekomandimi 1), për HC-e të cilat nuk janë në zonat e mbrojtura **të konsiderohet opsioni i ri-negocimit me investitorët për koncesion si instrument i të drejtës ujore në pajtim me ligjin e ujërave përmes kontratës koncesionare** ose kontratës administrative (sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative) duke marr parasysh gjendjen faktike të krijuar në terren, dhe të kërkohet nga investitori që:
  - t`i përmbushë të gjitha kushtet e përcaktuara me pëlqim ujq;
  - t`i instalojë matësit e prurjes mbi dhe nën profilin e veprave ujëmarrëse. Matësit e prurjes duhet të mundësojnë regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave ashtu që në çdo kohë të mund të verifikohet dhe sigurohet prurja e pranueshme ekologjike në lumë;
  - t`i rehabilitojë të gjitha dëmet e shkaktuara gjatë ndërtimit të HC-eve;
  - ta rishikojë projektimin dhe zbatimin e shtigjeve të peshqve dhe regjimit të aluvioneve në veprat ujëmarrëse;
  - ta kryejë incizimin gjeodezik të shtratit të lumit dhe të i identifikojë të gjitha ndërhyrjet në regjimin e rrjedhjes së ujit si rezultat i punimeve në ndërtimin e HC-it;
  - të përpunojë strukturat e betonit (basenet e dekantimit) në mënyrë adekuate ashtu që të jenë në harmoni me peizazhin e natyrës ku janë ndërtuar;
  - të sigurojë pëlqim nga Ministria për shfrytëzimin e pronës ujore ku janë ndërtuar hidrocentralet;
  - të pajset me leje mjedisore.
5. **Të zhvillohen kapacitetet për lëshimin e akteve ujore dhe mjedisore** (rritja e numrit të stafit, trajnimi i stafit, hartimi i udhëzuesve, etj.) dhe **për zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese.**
6. **Të shqyrtohet përgjegjësia për shkeljet ligjore të zyrtarëve përgjegjës** në lëshimin dhe zbatimin e akteve administrative.
7. **Të harmonizohet legjislacioni në fushën e ujërave, mjedisit dhe ndërtimit sa i përket** ecurisë së procesit (hierarkisë) së akteve administrative: Pëlqim Mjedisor, Kushtet Ujqore,

Pëlqim Ujor, Leje Ndërtimore, Leje Ujore/Koncesion, Leje Mjedisore, Certifikatë e Përdorimit.

8. **Të respektohen afatet ligjore lidhur me procedurat e dhënies së lejeve** ujore, mjedisore dhe ndërtimore.
9. **Të rritet transparenca e institucionit dhe organeve përgjegjëse** për procedurat e dhënies së pëlqimeve, lejeve mjedisore, lejeve ujore përmes pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje. Përveç Njoftimit publik në gazetë ditore dhe ueb faqe të bëhen njoftimet publike edhe në mediat elektronike, radio dhe televizion.



